Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2024

Prishtinë, gusht 2025

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Auditores së Përgjithshme

Përmbledhja ekzekutive

KAPITULLI I: AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2024 7

1.Opinioni i auditimit 9

2.Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit 10

3.Deficiti buxhetor 13

4.Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore 15

5.Analiza e buxhetit të shtetit 23

5.1. Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike 25

5.2. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike 28

5.3. Analiza e shpenzimeve sipas funksionit 34

5.4.Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike 35

5.5.Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit 37

6.Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve 39

7.Pasuritë jo financiare kapitale, jokapitale dhe stoqet 40

8.Llogaritë e arkëtueshme 43

9.Detyrimet e papaguara dhe kontingjente 46

10.Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore 50

11.Të dhënat e punësimit 52

Kapitulli II :A UDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË 55

Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve 57

1.Niveli Qendror 59

1.1.Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre 59

1.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 61

1.3.Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë 62

1.4.Rekomandimet e dhëna 64

2.Niveli Lokal 64

2.1.Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre 64

2.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 66

2.3.Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë 68

2.4.Rekomandimet e dhëna 70

3.Ndërmarrjet Publike 71
3.1.Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre 72
3.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 73
3.3.Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar 74
3.4.Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë 76
3.5.Rekomandimet e dhëna 78
4.Sistemi i auditimit të brendshëm 79
Kapitulli III: AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PAJTUESHMËRISË 81
1.Auditimet e Performances, TI-së dhe Pajtueshmerisë 83
1.1.Auditimet e Performancës 85
1.2.Auditimet e Teknologjisë së Informacionit 93
1.3.Auditimet e Pajtueshmërisë 98
Kapitulli IV: REKOMANDIMET E AUDITIMIT 101
Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve 103
1.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2023 103
2.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2023 104
3.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës 106
4.Ndikimi i auditimit 106
SHTOJCAT
Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2023 111
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit 114
Shtojca III: Llojet e opinioneve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit 116
Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA 120
Shtojca V: Letër Konfirmimi 123
Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 124

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ARC	Agjenicia e Regjistrimit Civil
AME	Agjencia për Menagjimin e Emergjenave
ANZH	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BZHKE	Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës
DK	Doganat e Kosovës
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
INTOSAI/ ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minierale
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurim Publik
LIVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MAPL	Ministria e Administratës Publike
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Tekonoligjisë dhe Inovacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brenshëm
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NP	Ndërmarrjet Publike
OB	Organizata Buxhetore
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SISH	Sisitemi Informativ Shëndetësor
SGJC	Sistemi i Gjendjes Civile
TVSH	Tatimi në Vleren e Shtuar
TI	Teknologjia e Informacionit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



Fjala e Auditores së Përgjithshme

Të nderuar,

Auditimi është një mjet kyç për të ruajtur transparencën, llogaridhënien dhe besimin e qytetarëve tek institucionet, në veçanti në shpenzimin e parasë publike. Qytetarët presin që çdo taksë e paguar nga puna e tyre të përdoret me ndershmëri dhe efektivitet, prandaj është detyrë të sigurohemi që paratë publike të menaxhohen drejt, efikas dhe në dobi të mirëqenies së tyre.

Auditimi nuk është një proces teknik i trajtimit të numrave apo vetëm një standard a rregull e rishikimit të prezantimit të tyre, por është një çelës sigurie që tregon se paraja publike po menaxhohet si duhet. Shërben si një mjet kontrolli që ndihmon në identifikimin e dobësive dhe përmirësimin e menaxhimit financiar, forcon besimin publik ndaj institucioneve shtetërore, dhe ofron mundësi për përmirësimin e politikave publike dhe qeverisjes në tërësi për të siguruar që kundërvlera për paranë e shpenzuar të arrihet maksimalisht.

Si Auditore e Përgjithshme e Republikës se Kosovës, përmes Zyrës Kombëtare të Auditimit kam mandatin dhe përgjegjësinë e nivelit më të lartë të kontrollit ekonomiko financiar që përmes auditimeve të kryera të ofroj sigurinë e theksuar më lartë para qytetarëve dhe Kuvendit të Republikës se Kosovës.

Për të arritur këtë, gjatë këtij sezoni, Zyra Kombëtare e Auditimit ka përmbushur mandatin e saj kushtetues dhe ligjor duke kryer **127 auditime** në institucione publike, ndërmarrje dhe projekte të rëndësishme. Sezoni u përmbyll me auditimin e **Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë**, rezultatet e të cilit janë pasqyruar në **Raportin Vjetor të Auditimit 2024**.

Kemi vazhduar të kemi në fokus të veçantë të auditimit ndërmarrjet publike në fusha me interes të lartë, si: Trepça, KEK-u, KOSTT-i, Telekomi dhe Ndërmarrje të tjera me rëndësi strategjike për shtetin. Marrë parasysh rëndësinë e projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përqendrim i veçantë i është kushtuar auditimeve të performancës. Përmes tyre kemi vlerësuar fushën e arsimit parashkollor, të mbrojtjes së mjedisit, të drejtave të konsumatorëve, lejet e ndërtimit, infrastrukturën hekurudhore, shëndetësinë, energjinë, menaxhimin dhe sigurinë e sistemeve të TI-së dhe informacioneve.

Rezultatet tregojnë se ende ekzistojnë sfida, qoftë në cilësinë e raportimit financiar ashtu edhe në fusha të tjera të përmbushjes se objektivave në drejtim të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Një numër i konsiderueshëm i institucioneve publike kanë nevojë të përmirësojnë kontrollet e brendshme për sa i përket përmbushjes së standardeve dhe rregullave të raportimit. Sfidë edhe më tutje, mbetet kryerja e transaksioneve dhe aktiviteteve në përputhje me kornizën ligjore, klasifikimi adekuat i shpenzimeve, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, detyrimeve të pa paguara, dhe rritja e llogarive të

arkëtueshme. Hyrja në marrëveshje kontraktuale për projekte kapitale në mungesë të fondeve, apo pa u miratuar e kërcënon dëmtimin e buxhetit të shtetit nga kosto shtesë të pa planifikuara, ndërsa mungesa e kontrolleve mbi to mund të rezultojë edhe në keq menaxhim të tyre. Prokurimi publik dhe menaxhimi i kontratave vazhdon të mbetët sfidë për institucionet publike. Forcimi i kontrolleve të brendshme është më se i nevojshëm në menaxhimin e projekteve infrastrukturore për të siguruar që ato udhëhiqen në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Është inkurajuese menaxhimi dhe zvogëlimi i humbjeve tek ndërmarrjet publike, si dhe përmirësimi i shumë proceseve, mirëpo sfidë mbetet ende forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrolleve në Ndërmarrjen Publike Trepça.

Në anën tjetër, gjithashtu ka nevojë të përmirësohen procese të ndryshme brenda institucioneve publike, si: ai i lëshimit të lejeve të ndërtimeve të larta dhe certifikimit të përdorimit të tyre. Menaxhimi i pyjeve shoqërohet me prerje ilegale, uzurpime dhe dëmtime në zonat e mbrojtura duke sjellë humbje ekonomike dhe mjedisore. Ka mos efikasitet për përdorimin e fondeve të ndara për projektin hekurudhor, derisa, në fushën e energjisë, është evidentuar mos efikasitet në shitblerjen e energjisë së ripërtëritshme. Ndërsa në atë te menaxhimit të teknologjisë së informacionit, sistemi i tatimit në pronë, platforma e-Kosova dhe sistemi i informacionit në doganën e Kosovës, janë disa nga sistemet e TI-së tek të cilat janë gjetur mangësi dhe kërkojnë vëmendje nga bartësit e institucioneve.

Këtë sezon, dukshëm e kemi zgjeruar fushëveprimin në auditimet e pajtueshmërisë, të cilat tregojnë se: vëmendje më e theksuar kërkohet në menaxhimin e pronave publike lokale, përkatësisht dhënies së tyre me qira, për të cilat auditori ka vënë në pah parregullsi. Edhe në këtë sezonë kemi identifikuar raste të ndryshme të dyshimeve potenciale për mashtrim, të cilat në vazhdimësi janë adresuar në prokurorinë e shtetit.

Për adresimin e këtyre mangësive, gjatë vitit 2024 kemi dhënë **945 rekomandime**. Por, shqetësues mbetet fakti se nga rekomandimet e vitit 2023 janë zbatuar vetëm **37%** të tyre, që tregon për rënie të zbatueshmërisë.

Si Auditore e Përgjithshme, dua të theksoj mungesën e veprimeve të mjaftueshme përmirësuese nga krerët e institucioneve. Prandaj, ftojë krerët e institucioneve publike të rrisin përgjegjshmërinë dhe kujdesin në administrimin e parasë dhe pasurisë publike më qëllim që kundërvlera e tyre t'i kthehet qytetarëve në rritjen e mirëqenies së tyre. Ndërsa, inkurajojë Kuvendin e Republikës së Kosovës që të luaj një rol më proaktiv duke shfrytëzuar rezultatet tona të auditimit për t'i mbajtur llogaridhënës administruesit e parasë publike.

Auditorja e Përgjithshme,

Vlora Spanca Prishtinë, Gusht 2025

Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës

Opinioni i kualifikuar

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	**35,254,641€**
Pasuritë mbivlerësim i pasurive prej	**27,090,159€**
Llogaritë e arkëtueshme nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej	**894,773€**
Detyrimet e papaguara nënvlerësim i detyrimeve prej	**2,045,528€**
Detyrimet e kontigjente mbivlerësim i detyrimeve kontigjente për	**4,229,574€**

Deficiti
i përllogaritur sipas buxhetit

-211,316,000€
apo **-2%**

Suficiti
pas realizimit të buxhetit - 2024

52,836,000€
apo **0.5%**

Të hyrat/pranimet buxhetore

Planifikimi **3,436,472,000€**
Realizimi **3,234,089,000€** apo **94%**

Krahasuar me realizimin e vitit 2023 pranimet janë rritur për **368,449,000€** apo **13%.**

Buxheti/Shpenzimet

Buxheti final **3,620,293,000€**
Realizimi **3,195,579,000€** apo **88%**

Krahasuar me vitin 2023 kishte rritje të shpenzimeve për **269,581,000€** apo **9%.**



Borxhi shtetëror
1,736,960,000€
apo **16.9%** e BPV-së

Borxhi i jashtëm
774,760,000€

Borxhi i brendshëm
962,200,000€

Auditimet e kryera 2024/2025

127 auditime

- **87** auditime financiare dhe të pajtueshmërisë për organizata buxhetore
- **9** auditime të ndërmarrjeve publike
- **7** auditime të projekteve të Bankës Botërore
- **12** auditime të performancës
- **12** auditime të pajtueshmërisë


87
Opinione të Pasqyrave Financiare të Organizatave Buxhetore
41 Opinione të pamodifikuara
46 Opinione të kualifikuara
Niveli Qendror 34
Niveli Lokal 7
15 Niveli Qendror
31 Niveli Lokal


9
Opinione të Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjeve Publike
1 Opinion i pamodifikuar
4 Opinione të kualifikuara
4 Opinione të kundërta

Auditimet e Performancës dhe Teknologjisë së Informacionit



Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore



Auditimi përcjellës i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2019



Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore



Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë



Efikasiteti dhe Efektiviteti në Procesin e Ndërtimeve të Larta në Komunën e Prishtinës



Efikasiteti në Realizimin e Projektit “Rehabilitimi i Linjës 10 Hekurudhore Hani i Elezit – Leshak”



Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë



Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë



Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World



Platforma e shërbimeve online e-Kosova



Sistemi i Tatimit në Pronë



Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Deponisë së Shënimeve dhe Implementimi i Inteligjencës së Biznesit

Auditimet e Pajtueshmërisë



Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Për Komunat :

- Komuna e Prishtinës,
- Komuna e Prizrenit,
- Komuna e Pejës,
- Komuna e Gjilanit,
- Komuna e Podujevës,
- Komuna e Suharekës,
- Komuna e Fushë Kosovës, dhe
- Komuna e Vushtrrisë.



Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit” në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së)



Auditimet e Pajtueshmërisë me informata të klasifikuara (Niveli i kufizuar) për:

- Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Ministrinë e Mbrojtjes, dhe
- Ministrinë e Drejtësisë.

Rekomandimet për vitin 2024

Raporti Vjetor i Auditimit 2024
20 Rekomandime

Auditimet individuale në total
945 Rekomandime

- **205** Niveli Qendror
- **413** Niveli Lokal
- **153** Ndërmarrjet Publike
- **58** Auditimet e Pajtueshmërisë
- **116** Auditimet e Performancës

Përmbledhja ekzekutive

Raporti Vjetor i Auditimit përgatitet në bazë të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Ky raport, për Kuvendin, Qeverinë dhe palët e tjera të interesit përmban:

- Opinionin e Auditorit lidhur me faktin nëse deklaratat financiare të Raportit Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Deklaratën lidhur me kufirin e deficitit buxhetor dhe me kushtet dhe kërkesat ligjore; dhe
- Përmbledhjen e rezultateve të auditimit që përfshijnë konkluzionet dhe rekomandimet e rëndësishme nga të gjitha auditimet e kryera gjatë sezonit audites 2024/2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Deklarata e pajtueshmërisë për deficitin buxhetor - Kufiri i deficitit buxhetor gjatë vitit 2024 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dhe ishte ulur kërkesa për financim. Për vitin 2024, deficiti i përgjithshëm i përllogaritur sipas buxhetit ishte -211,316,000€ apo -2%. Në fund të vitit sipas realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve kishte suficit në vlerë prej 52,836,000€ apo 0.5% e Bruto Produktit Vendor.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Sipas trendit të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Projeksionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet sipas buxhetit për vitin 2024 ishin planifikuar 3,436,472,000€, ndërsa ishin realizuar në vlerë prej 3,234,089,000€ apo 94% e buxhetit. Krahasuar me realizimin e vitit 2023 pranimet janë rritur për 368,449,000€, apo rreth 13%.

Buxheti fillestar për shpenzime ishte 3,492,163,000€, kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,620,293,000€ i cili ishte realizuar në vlerë 3,195,579,000€ apo 88% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2023 kishte rritje të shpenzimeve për 269,581,000€.

Bilanci i fondeve, në fund të vitit 2024 është rritur për 38,509,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2023. Bilanci bankar i pasurive financiare - parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2024 ishte 423,884,000€.

Borxhi shtetëror - Në fund të vitit 2024, vlera e borxheve shtetërore ishte 1,736,960,000€ apo rreth 16.90% të BPV-së dhe është brenda kufijve të përcaktuar ligjor. Prej tyre, 774,760,000€ janë borxhe të jashtme dhe 962,200,000€ borxhe të brendshme. Në raport me vitin e kaluar borxhi i përgjithshëm ka shënuar rritje prej 73,920,000€ apo rreth 4.50%.

Borxhi i jashtëm në raport me vitin e kaluar është rritur për 81,910,000€ përderisa borxhi i brendshëm është zvogëluar për 7,990,000€.

Nga analiza e realizimit të projekteve të financuara nga borxhi shtetëror është vërejtur mos efikasitet dhe ngecje në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme. Kjo është shkaktuar kryesisht nga problemet me menaxhimin e projekteve infrastrukturore, shpronësimet qoftë në fazën e planifikimit apo zbatimit të tyre.

Llogaritë e arkëtueshme - Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 1,004,657,000€ nga këto 727,843,864€ të nivelit qendror dhe 276,813,136€ të nivelit lokal. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 86,453,111€, apo mbi 9% dhe ky është një tregues që institucionet publike nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbledhjen e të hyrave. Në vitin 2024, nga auditimi është identifikuar se llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar në vlerë prej 894,773€.

Detyrimet e papaguara dhe kontingjente - Vlera e përgjithshme e prezantuar e detyrimeve të papaguara në RVF-BRK ishte 190,016,131€ nga këto 145,099,574€ të nivelit qendror dhe 50,916,557€ të nivelit lokal. Krahasuar me vitin paraprak detyrimet e papaguara janë rritur për 37,330,772€ apo rreth 24%. Në vitin 2024, nga auditimi është identifikuar se detyrimet e papaguara ishin nënvlerësuar për 2,045,528€.

Ndërsa, sipas RVF-BRK detyrimet kontingjente për vitin 2024 janë gjithsej 394,341,235€. Nga auditimi është identifikuar se vlera e detyrimeve kontingjente ishte e mbivlerësuar për 4,229,574€.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve - sipas RVF-BRK për vitin 2024 ishin në vlerë 125,415,306€. Në raport me vitin 2023, shuma e këtyre pagesave është rritur për 73,479,062€ apo 141%. Shpenzimet e kësaj natyre të cilat derivojnë nga këto procedura vazhdojnë të jenë sfidë për buxhetin e shtetit edhe për faktin se shpenzimet shtesë përtej borgjit kryesor ishin 22,552,982€, apo 18% e totalit të pagesave.

Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ridestinuar për t'u paguar këto detyrime.

Pasuritë jo financiare - Raportet mbi pasuritë jo financiare në vitin 2024 ende nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë. Të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri janë jo të plota dhe gjendja e tyre është përcjellë me pasaktësi në raportim në vlerë prej 27,090,159€, derisa në vitin 2023 pasaktësia ishte 20,801,678€.

Rezultatet nga auditimet individuale

Në përputhje me mandatin kushtetues, ligjor dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë sezonit audites 2024/2025 ka kryer 127 auditime. Prej tyre janë kryer 87 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë për organizata buxhetore, nëntë (9) auditime të ndërmarrjeve publike, shtatë (7) auditime të projekteve të Bankës Botërore, 12 auditime të performancës dhe 12 auditime të pajtueshmërisë (prej tyre tre me informata të klasifikuara me nivel të kufizuar). Gjithashtu kemi kryer, auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për Buxhetin e Kosovës.

Organizatat buxhetore - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 87 auditimet e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore, prej tyre 46 kishin keqdeklarime materiale të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar, ndërsa 41 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar.

Duhet theksuar se në nivelin qendror në lidhje me raportimin financiar gjendja me vitin paraprak nuk tregon përmirësim. Në vitin 2024 te niveli qendror, janë 15 OB me opinione të modifikuara ndërsa në vitin 2023 ishin 12 me opinione të modifikuara. Në nivelin lokal në vitin 2024 janë dhënë 31 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin 2023 ishin 23 opinione të modifikuara, që tregon një gjendje jo të mirë sa i përket raportimit financiar.

Po ashtu, gjendja në lidhje me pajtueshmërinë nëse aktivitetet dhe transaksionet po kryhen në pajtim me kornizën ligjore ishte jo e mirë sidomos te niveli lokal. Në vitin 2024 nga 87 organizatat buxhetore të audituara 33 kishin konkluzion të pamodifikuar kurse 54 e kishin konkluzionin e modifikuar, prej tyre 37 komuna dhe 17 organizata të nivelit qendror. Në raport me vitin paraprak nuk vërehet ndonjë përmirësim.

Ndërmarrjet Publike - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga nëntë (9) auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, vetëm për një (1) ndërrmarje është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa për tetë (8) të tjera opinion i modifikuar prej tyre katër (4) opinione të kualifikuara dhe katër (4) të kundërta. Cilësia e raportimit financiar në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime të mëtejmë, marrë parasysh që në tetë (8) prej tyre pasqyrat financiare për vitin 2024 përmbanin keqdeklarime materiale.

Po ashtu, sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të gjitha ndërrmarrjet e audituara kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Auditimet e Performancës, Teknologjisë së Informacionit dhe Pajtueshmërisë - Për sezonin audites 2024-2025 janë mbuluar fusha të rëndësishme për qytetarët duke marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030, ku janë kryer 12 raporte të auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit dhe nëntë (9) raporte të pajtueshmërisë. Në raporte e performancës janë dhënë 116 rekomandime, kurse në të pajtueshmërisë 58 rekomandime.

Shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida si në efikasitet ashtu edhe në efektivitet. Auditimet kanë nxjerr në pah se Institucionet parashkollore shpesh funksionojnë pa licencë dhe pa mbikëqyrje të rregullt, ndërsa ligji i ri nuk po zbatohet për shkak të mungesës së udhëzimeve.

Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në Kosovë, nuk ishte i koordinuar mirë, procedurat për ankesa janë të paqarta, inspektimet nuk bazohen në rrezik, dhe fushatat informuese janë të kufizuara.

Projektet e infrastrukturës publike shpesh nisin pa planifikim të mirëfilltë, pa analiza të mjaftueshme të kostove dhe përfitimeve dhe me financim të pamjaftueshëm në raport me vlerën e kontratës.

Në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social auditimet tregojnë se sektori i pylltarisë ka mungesë të kontrollit dhe të dhënave. Qeverisja në zhvillimin urban është e dobët për shkak të mungesës së inspektimeve dhe zbatimit të rregullave ndërtimore.

Intensiteti i lartë i ndërtimeve kanë nxjerrë në pah dobësitë e qeverisjes lokale në menaxhimin e proceseve ndërtimore. Komuna, si institucioni përgjegjës për planifikimin dhe kontrollin ndërtimor, nuk ka siguruar procedura të qarta, shpërndarje të barabartë të detyrave dhe mekanizma efektivë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e objekteve të banimit kolektiv.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë përbëjnë një mundësi të rëndësishme për zhvillimin social dhe ekonomik, duke kontribuar në sigurinë energjetike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme nuk arrijnë të parashikojnë saktë sasinë e energjisë që prodhojnë, duke rezultuar shpeshherë në prodhim më të lartë se sa parashikimet. Teprica e prodhuar paguhet nga KOSTT-i përmes mjeteve të Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, duke shkaktuar shpenzime shtesë dhe duke e bërë menaxhimin e këtij Fondi joefikas.

Në proceset e prokurimit janë evidentuar mangësi për projekte publike investive, të cilat kanë ndikuar në transparencën, konkurrencën dhe efikasitetin e shpenzimit të fondeve publike.

Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të siguruar digjitalizim të plotë të proceseve/shërbimeve, siguri të informacionit, vazhdimësinë e biznesit/ shërbimeve si dhe kontrollet e përgjithshme të aplikacionit janë të dobëta.

Sistemi për integrimin e të dhënave Deponia e të Dhënave ka mungesë të proceseve të formalizuara, dokumentim të plotë të proceseve dhe koordinimi ndërinstitucional ka rezultuar në dobësi në menaxhimin strategjik të sistemit dhe në përdorimin e mangët të tij.

Për vitin 2024, ZKA në nivel lokal ka kryer tetë (8) auditime të pajtueshmërisë, në të cilat ka dhënë 54 rekomandime për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e pronave të dhëna me qira.

Rezultatet e auditimit tregojnë për mungesë të transparencës, kontrollit dhe zbatimit të procedurave të rregullta në procesin e dhënies dhe menaxhimit të pronës komunale. Në disa raste mungojnë rregulloret përkatëse që do të rregullonin dhënien në shfrytëzim të pronës për afat të shkurtër, ndërsa në raste të tjera nuk është siguruar respektimi i rregulloreve ekzistuese, që ka ndikuar në veprime jashtë kornizës ligjore dhe dëme të mundshme financiare.

Është evidentuar mungesa e procedurave formale për vazhdimin e kontratave të qirasë, mungesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe shkelje në lidhje me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të palëve të treta pa miratim paraprak.

Kryetaret e Komunave nuk kanë raportuar në Kuvendet Komunale për realizimin e kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të shfrytëzimit të pronës publike dhe kjo ka kufizuar aftësinë e mbikëqyrjes për të marrë vendime efektive.

Po ashtu, ZKA ka kryer auditimin e pajtueshmërisë "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së" dhe ka dhënë katër (4) rekomandime.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Kompania nuk ka arritur të bëj menaxhimin e kontratës sipas kërkesave ligjore, duke mos realizuar pozicionet e caktuara sipas kontratës dhe tejkalime të theksuara të pozicioneve të caktuara.

Zbatimi i rekomandimeve - Niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditorit për RVF-BRK e vitit 2023 ende vazhdon të mbetet i ulët. Niveli i adresimit të rekomandimeve të dhëna në RVA 2023 ishte rreth 16%.

Në total, mesatarja e zbatimit të rekomandimeve të organizatave buxhetore dhe ndërrmarjeve publike është 37%. Në veçanti, për organizatat buxhetore është vlerësuar se 40% e rekomandimeve të dhëna në vitin 2023 janë zbatuar plotësisht, ndërsa për ndërmarrje publike vlerësohet se vetëm 25% e rekomandimeve janë zbatuar.

Po ashtu, Zyra Kombëtare e Auditimit vlerësoi zbatimin e rekomandimeve nga 10 auditime të performancës të publikuara në vitin 2019, që përfshinin 36 subjekte. Nga 199 rekomandime vetëm 51 apo 25% e tyre janë zbatuar.

Edhe pse rekomandimet e auditimit të dhëna për organizatat buxhetore janë zbatuar jo kënaqshëm, ndikimi i tyre në përmirësimin e menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike ka pasur efekt pozitiv në disa fusha. Bazuar në veprimet e ndërmarra, regjistrat e pasurisë janë më të saktë dhe më të plotë për vlerën rreth 177mil.€ vlera e pasurive të regjistruar në nivel qendror ishte 125,603,346€, ndërsa në nivel lokal ishte 51,467,815€, si dhe korigjimet e Pasqyrave Vjetore Financiare individuale gjatë auditimit që kishin një efekt në paraqitjen e saktë të pasqyrës së pranimeve dhe pagesave për rreth 167mil€.

Kapitulli - I

AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2024

1. Opinioni i auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, i cili përfshinë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, shënimet shpjeguese dhe shtojcat.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Baza për opinionin e kualifikuar

- **Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve -** Gjatë vitit 2024 janë identifikuar klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 35,254,641€. Prej tyre 9,398,425€ apo 27% të nivelit qendror dhe 25,856,216€ apo 73% të nivelit lokal.

  Kjo ka ndodhur si rezultat i pagesave të bëra me vendime gjyqësore në vlerë 27,351,559€, buxhetimit jo adekuat 5,112,582€ dhe të ndikuara nga vetë organizatat buxhetore 2,790,500€;
- **Pasuritë -** Në fund të vitit 2024, totali i pasurive sipas RVF_BRK ishte 10,307,892,365€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar mbivlerësim i pasurive prej 27,090,159€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK-së. Problemet më të mëdha të cilat e kanë përcjellur këtë kategori ishin: regjistrimi jo i plotë i pasurive, moskordinimi në mes organizatave gjatë bartjes së pasurive që ka rezultuar me dyfishim të pasurive dhe regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimit teknik;
- **LLogaritë e arkëtueshme -** Vlera e e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në RVF-BRK ishte 1,004,657,000€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej 894,773€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK;
- **Detyrimet e papaguara -** Vlera e detyrimeve të papaguara e prezantuar në RVF-BRK ishte 196,016,131€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i detyrimeve prej 2,045,528€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK; dhe
- **Detyrimet kontingjente -** Detyrimet kontingjente, janë rezultat i pretendimeve përmes padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritet të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Sipas RVF-BRK detyrimet kontingjente për vitin 2024 janë gjithsej 394,341,235€. Sipas auditimeve individuale, është identifikuar mbivlerësim i detyrimeve kontigjente për 4,229,574€.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar për të përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë, përfshirë pasqyrat e shpalosjeve (anekseve).

2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Korniza ligjore

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë ministritë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë 2024 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (nenet 6 dhe 18);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin auditues 2024/2025;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtueshmërisë;
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza INTOSAI për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe kryer bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit financiar të buxhetit të Kosovës sipas LMFPP-së është baza e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë së gatshme është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohet për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari. Organizatat buxhetore kanë të deleguara përgjegjësit për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve. Po ashtu, bazuar në rregulloren MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë në bazë të të cilëve përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe raportojnë në MFPT/Thesar.

Raporti vjetor financiar për buxhetin e shtetit, përbëhet nga tri pasqyrat kryesore së bashku me shënimet shpjeguese si dhe anekset tjera, të cilat përgatiten nga Thesari, bazuar në shënimet e SIMFK-së.

Gjatë konsolidimit të RVF-BRK-së shënimet për anekset si në vijim: ankesi nr. 8 pasuritë me vlerë nën 1,000€, aneksi 9 stoqet, aneksi 10 të arkëtueshmet, aneksi 12 faturat e papaguara, aneksi 13 detyrimet kontingjente, aneksi 17 numri i të punësuarve jashtë listës së pagave dhe aneksi 18 numri i të punësuarve me kontratë për shërbime, bazohen në shënimet nga pasqyrat financiare individuale të Organizatave Buxhetore.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, raportet e auditimeve individuale i'u dërgohen Kuvendit të Kosovës, Kuvendeve Komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar se asnjë nga organizatat buxhetore nuk kishin mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, sa i përket formatit, strukturës dhe afateve të raportimit.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatisë dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontrolleve të brendshme.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, me 27 mars 2025 i ka dorëzuar Qeverisë për aprovim, Raportin Vjetor Financiar për vitin 2024 brenda afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të, dhe janë aprovuar nga Qeveria. Po ashtu, RVF_2024 janë dorëzuar edhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/anekset e pasqyrave financiare.

Objektivë e auditimit ishte që të ofrojmë siguri të arsyeshme:

- Nëse RVF-BRK, paraqet në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse RVF-BRK, paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së RVF-BRK-së; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Auditimi i RVF-ve të BRK-së për vitin 2024 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar RVF-të dhe me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqëndrohet në adresimin e rreziqeve specifike për opinion, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Qasja e përzgjedhur përfshinë edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet për disa anekse të RVF-ve të cilat konsolidohen nga pasqyrat financiare individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike dhe anekset tjera.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontrolleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Pjesët e mëposhtme të raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2024, por gjithsesi ofrojnë një nivel të arsyeshëm të sigurisë.

3. Deficiti buxhetor

Sipas nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ministri duhet t'i dorëzoj Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, i cili përfshin një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tilla.

Në bazë të nenit 22.A.1. të LMFPP Nr. 04/L-194, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar.

Ndërsa, neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- Kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit; dhe
- Procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive të jashtme si dhe granteve.

Ne analizuam përllogaritjen e deficitit, në Aneksin nr.1 të RVF-BRK të shpalosjes së të dhënave në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2024, dhe nuk kemi identifikuar mospërputhje.

Tabela 1 - Përllogaritja e deficitit buxhetor[1] për vitin 2024 (në '000€)

	Buxheti fillestar 2024	Realizimi 2024 sipas RFV
1. Të hyrat Buxhetore	3,027,997	3,088,019
Te hyrat Tatimore përfshirë kthimet tatimore	2,705,117	2,740,151
Të hyrat jo tatimore	292,880	337,939
Mbështetja buxhetore nga grantet	18,000	1
Grantet e përcaktuara të donatorëve	12,000	9,928
2. Shpenzimet Buxhetore	3,314,323	3,116,810
Paga dhe shtesa	805,390	843,034
Mallra dhe sherbime	518,959	458,447
Subvencione dhe transfere	1,062,316	1,112,492
Shpenzime kapitale	859,176	647,014
nga të cilat-Financimi I buxhetit të rregullt	784,166	627,922
nga të cilat - Shpenzime kapitale nga klauzola	75,010	19,092
Rezerva	10,173	-
Pagesa e interesit	46,309	42,215
Grantete e përcaktuara të donatorëve	12,000	13,607
3. Deficiti/suficiti I përgjithshëm	-286,326	-28,791
4. Deficiti /suficiti I përgjithshëm në % të GDP	-2.71%	-0.27%
5. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale	75,010	81,627
Shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura	-	62,535
Shpenzimet nga pranimet e dedikuara të AKP	-	-
Fondet e likuidimit nga AKP	-	-
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve dhe AKP	75,010	19,092
6. Deficiti/suficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale 5=4+3	-211,316	52,836
7. Deficiti/suficiti i përgjithshëm në % të GDP	-2%	0.5%
8. Bruto produkti vendor i parashikuar	10,552,322	10,305,400

1 Per qëllime te kalkulimit të deficitit buxhetor nuk përfshihen grantet, huamarrja dhe pranimet tjera (Të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga NP, Financimi i njëhershëm nga AKP dhe Pranimet nga depozitat

Tabela më lartë tregon se, deficiti i përllogaritur i përgjithshëm sipas buxhetit fillestar ishte -211,316,000€ apo -2% e BPV-së të parashikuar. Sipas realizimit në fund të vitit, kishte suficit në vlerë prej 52,836,000€ apo 0.5% e BPV-së.

Kufiri i deficitit buxhetor ishte respektuar si me ligjin fillestar të buxhetit ashtu edhe me realizim për vitin 2024.

4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore

Borxhi Shtetëror i Kosovës përbëhet nga borxhi i jashtëm/ndërkombëtar, borxhi i brendshëm dhe garancitë shtetërore. Borxhi i jashtëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjes financiare me kreditor që kanë selinë jashtë vendit, ndërsa borxhi i brendshëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar nga kreditor brenda vendit.

Republika e Kosovës ka filluar të marrë borxhe të jashtme/ndërkombëtare nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 ka filluar të marrë borxhe të brendshme përmes emetimit të letrave me vlerë.

Portofoli i Borxhit Shtetëror në fund të vitit 2024 përbëhet nga borxhi i jashtëm dhe borxhi i brendshëm, si dhe një garanci shtetërore[2]. Deri më tani, Republika e Kosovës nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

Në fund të vitit 2024, borxhi shtetëror arriti vlerën 1,736,960,000€ që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej 73,920,000€ apo 4.45%. Megjithatë, në raport me Bruto Produktin Vendor borxhi shtetëror ka shënuar rënie, duke u reflektuar edhe në përqindjen e borxhit dhe garancive shtetërore, e cila ka zbritur në 16.90% në vitin 2024 nga 17.50% sa ishte në vitin 2023.

Sipas ligjit për Borxhet Shtetëror nr.08/L-099 është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për vitin 2024 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve publike.


2 Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara;

Tabela 2 - Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar dhe borxhi i brendshëm në tre vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Borxhi i Jashtëm	774,760	692,850	641,200
Borxhi i Brendshëm	962,200	970,190	1,112,000
Borxhi i Përgjithshëm	1,736,960	1,663,040	1,753,200
Garancitë Shtetërore	3,570	28,590	29,610
Borxhi dhe Garancitë Shtetërore sipas % së BPV	16.90%	17.50%	20.04%
BPV nga ASK[3]	10,305,400	9,680,0704	8,895,730

Borxhi shtetëror përbëhet 44.6% nga huamarrja e jashtme dhe 55.4% nga huamarrja e brendshme. Qeveria aktualisht ka një garanci shtetërore në vlerë 3,570,000€.

Grafikoni 1- Borxhi i jashtëm dhe i brendshëm ('000 në €)



3 Borxhi i Jashtëm ndryshon nëpër vite edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor. Vlerat e BPV-së për 2022-2023 janë marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2025 ato janë marrë nga Ligji i Buxhetit 2025. Kalkulimi i treguesit përfshinë edhe Garancitë Shtetërore;

4 Është rishikuar vlera e BPV-së nga ASK me datën 14.03.2025;

Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar

Në fund të vitit 2024, borxhi i jashtëm është 774,760,000€, që ka shënuar rritje për 81,910,000€ apo rreth 12% krahasuar me vitin paraprak. Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, mirëqenies sociale, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, ujit, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, sistemit bankar, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave, rritjes ekonomike si dhe mbështetjen e buxhetit.

Kreditorët kryesor të borxhit ndërkombëtar janë: Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH) me pjesëmarrje 34%, Banka Evropiane (BE) me pjesëmarrje 13%, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) me pjesëmarrje 10%, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)) me pjesëmarrje 10%, Banka Evropiane për Investime (BEI) me pjesëmarrje 10%, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (FoZhN) me pjesëmarrje 6% dhe Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (BZhKE) me pjesëmarrje 6%.

Tabela 3 - Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar në tre vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Borxhi i jashtëm	774,760	692,850	641,200
Qeveritar	732,130	652,050	594,190
Nën-huazuar	42,630	40,800	47,010
Borxhi i jashtëm sipas % së BPV	7.52%	7.16%	7.21%
BPV nga ASK	10,305,400	9,680,070	8,895,730

Në vitin 2024, organizatat buxhetore për projekte të cilat financohen nga borxhi ndërkombëtar kanë tërheq fonde nga kreditë në vlerë prej 134,600,000€. Tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga kreditorët si në vijim: FOZHN-ja, FMN, ANZH, dhe BEI.

Gjatë vitit 2024, në Kuvend janë ratifikuar edhe pesë (5) kredi/marrëveshje financiare në vlerë prej 130,500,000€, me qëllim të financimit të programeve në sektorin e mirëqenies sociale, të energjisë solare, të trajtimit të ujërave të zeza, sektorin e financave publike dhe rritjes ekonomike dhe qeverisjen digjitale.

Tabela 4 - Kreditë e ratifikuara në vitin 2024 ('000 në €)

Kredia/Projekti	Kreditori	Data e Marrëveshjes	Valuta	Vlera	Zbatues i Projektit	Statusi
Programi i Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike	FOZHN	09.06.2022	€uro	38,000	MFPT	E ratifikuar
Projekti për Forcimin e Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve	ANZH	18.09.2023	€uro	18,500	MPB dhe ZKM	E ratifikuar
Programi i Energjisë Solare i (Solar4Kosovo I) Fotovoltaike	KfW	11.10.2023	€uro	29,000	KEK	E ratifikuar
Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Ferizaj	BERZh	15.12.2023	€uro	20,000	KRU Bifurkacioni Sh.A	E ratifikuar
Banimi Social Adekuat në Kosovë	BZhKE	25.01.2024	€uro	25,000	MMPHI	E ratifikuar

Mangësi në shfrytëzimin e kredive të jashtme

Për vitin 2024, shuma e pa-tërhequr e kredive është 546,730,000€. Bazuar në aneksin 21.1 të RFV të BRK-së për shpalosjen e borxhit të jashtëm, për dhjetë (10) projekte/kredi në vlerë totale prej 196,800,000€, të ratifikuara përgjatë viteve 2016 deri 2024, nuk janë tërheq mjete fare. Projektet kishin afat realizimi apo përmbushje duke filluar nga viti 2021 deri në vitin 2026.

Kreditë e ratifikuara të cilat nuk kishin disbursim të mjeteve deri në fund të vitit 2024

1. Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në komunat: Ferizaj, Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan, kreditori KFW, zbatues të projektit janë komunat përkatëse, në vlerë 2,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2016 (me afat realizimi 30 maj 2021);
2. Projekti për Impiantin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BEI, zbatues i projektit është Komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 19,800,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në dhjetor 2026);
3. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BERZH, zbatues i projektit është Komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 13,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në dhjetor 2025);
4. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10B, kreditori BEI, zbatues i projektit është Infrakos, në vlerë prej 38,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2023 (me afat të realizimit në dhjetor 2024);
5. Efiçienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prizren, kreditori BERZh, zbatues i projektit është Komuna e Prizrenit, në vlerë prej 5,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2023;
6. Zhvillimi i Sektorit të Energjisë VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit, kreditori KfW , zbatues i projektit është KOSTT, në vlerë prej 25,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2023;
7. Programi i Energjisë Solare i (Solar4kosovo I) Fotovoltaik, kreditori KfW, zbatues i projektit është KEK, në vlerë prej 29,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024;

8. Banimi Social Adekuat, kreditori BZhKE, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 25,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024;
9. Projektin i Trajtimit të Ujërave të Zeza në Ferizaj, kreditori BERZh , zbatues i projektit është Komuna e Ferizajt, në vlerë prej 20,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024; dhe
10. Projekti për Forcimin e Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve, kreditori ANZh, zbatues i projektit është MPB dhe ZKM, në vlerë prej 18,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024.

Kreditë e ratifikuara të cilat kishin vonesa në disbursimin e mjeteve deri në fund të 2024

Për 12 kreditë e ratifikuara në vlerë 274,480,000€, që kanë vonesa më të theksuara e të cilat kanë afat përmbyllje duke filluar nga viti 2022 deri në vitin 2026, niveli i disbursimit deri në fund të 2024 ishte vetëm 114,780,000€ apo 42% të vlerës totale të kredive.

1. Projekti - Zhvillimi i Ujërave të Zeza në Gjilan në vlerë 11,000,000€, kreditori BEI, zbatuese e projektit është ME/Komuna e Gjilanit/KRU Hidromorava, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2021 (me afat realizimi mars 2026), janë tërhequr vetëm 200,000€;
2. Projekti - Trajtimi i ujërave të Zeza në Prishtinë në vlerë 66,000,000€, kreditori BpI France, zbatuese e projektit është Ministria e Ekonomisë, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2017 (me afat realizimi dhjetor 2026), janë tërhequr vetëm 180,000€;
3. Projekti - Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit, kreditori ANZH zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë 25,100,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në nëntor 2025), janë tërhequr vetëm 2,320,000€;
4. Projekti - Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë 29,000,000€, nga kreditori BERZH, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit gusht 2023), janë tërhequr vetëm 9,680,000€;
5. Projekti - Patundshmëria dhe Infrastruktura Gjeo-hapësinore, zbatues i projektit është ME, në vlerë 14,600,000€, nga kreditori ANZH, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2020 (me afat të realizimit gusht 2025), janë tërhequr vetëm 3,310,000€;
6. Projekti - Korniza e Qyteteve të Gjelbërta 2 Dritarja 2 - Efiçienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prishtinë, zbatues i projektit është Komuna e Prishtinës, në vlerë prej 5,000,000€, nga kreditori BERZh, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2017 (me afat të realizimit dhjetor 2025), janë tërhequr vetëm 500,000€;
7. Projekti - Ekonomia Digjitale në Kosovë, zbatues i projektit është ME, në vlerë prej 19,370,000€, nga kreditori ANZH, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit maj 2024), janë tërhequr 17,390,000€;
8. Projekti - Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore, Segmenti Jugor Hani i Elezit-Kosovë, zbatues i projektit është INFRAKOS, në vlerë 39,900,000€, nga kreditori BERZH, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2014 (me afat të realizimit dhjetor 2024), janë tërhequr 24,030,000€;
9. Projekti - Siguria e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit, zbatues i projektit është Ibër Lepenc SH.A, në vlerë 15,000,000€, nga kreditori ANZH, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit tetor 2024), janë tërhequr 12,770,000€;
10. Projekti - Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore, zbatues i projektit është MMPHI/Infrakos, në vlerë 42,000,000€, nga kreditori BEI, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit dhjetor 2024), janë tërhequr 37,300,000€;

11. Projektit - Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit për Komunën e Shtimes, zbatues i projektit është Komuna e Shtimes, në vlerë 2,390,000€, nga kreditori UniCredit, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2019 (me afat të realizimit prill 2024), janë tërhequr 2,100,000€; dhe
12. Projekti - Ndërtimi i Sistemit të Ujësjellësit për Komunën e Graçanicës, zbatues i projektit është Komuna e Graçanicës, në vlerë 5,120,000€, nga kreditori UniCredit, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2019 (me afat të realizimit dhjetor 2022), janë tërhequr 5,100,000€.

Për projektet e lartpërmendura, organizatat zbatuese të projekteve përkatëse raportojnë çdo 3 muaj në MFPT, si dhe për të njëjtat, MFPT raporton çdo 6 muaj në Qeveri mbi rrjedhën e ecurisë së realizimit të këtyre projekteve. Raportimet nga njësitë implementuese të projekteve janë formale dhe jo të mirëfillta, duke mos i listuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe pengesat që paraqiten në terren në realizmin e këtyre projekteve, që të pasqyrojnë veprimet konkrete në eliminimin e tyre.

Hyrja në marrëveshje të kredive dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit, lëvizjet e çmimeve të tregut dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara.

Mospërputhje e dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, që parashihen tarifa zotimi për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit, Qeveria në vitin 2024 ka paguar tarifa të zotimit në vlerë prej 673,934€. Krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të tarifave të zotimit për 176,045€ apo rreth 35%. Këto tarifa paguhen kryesisht për shkak të vonesave në tërheqjen e fondeve.

Nga analiza e RVF_BRK - aneksit 21.1, gjendja e kredive-borgji i jashtëm, është identifikuar një mospërputhje në regjistrim prej 560,000€ në mes Thesarit dhe SRMB (Sistemi i regjistrimit dhe menaxhimit të borxhit). Nga kjo vlerë, 380,000€ në Thesar është regjistruar si kthim avanci, ndërsa në SMRB si kthim i kryegjësë, kurse vlera prej 180,000€ nuk është regjistruar si disbursim në Thesar dhe SMRB .

Borxhi i brendshëm

Republika e Kosovës ka filluar marrjen e borxhit të brendshëm përmes emetimit të letrave me vlerë nga janari i vitit 2012, ky borxh paraqet katalizatorin kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Në vitin 2024, borxhi i brendshëm është 962,200,000€, ku në raport me vitin paraprak ka shënuar rënie për 7,990,000€ apo 0.82%. Borxhi i Brendshëm paraqet 55.4% të Borxhit Shtetëror apo 9.34% të BPV-së.

Tabela 5 - Borxhi i Brendshëm në tre vitet e fundit ('000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Emetimet e Reja	-7,993	-141,810	5,850
Stoku i Borxhit të Brendshëm	962,200	970,190	1,112,000
Borxhi i brendshëm % së BPV	9.34%	10.02%	12.50%
BPV nga ASK	10,305,400	9,680,070[5]	8,895,730

Në vitin 2024 vlera e letrave me vlerë që kanë maturu ishte 260,414,000€, ndërsa për rifinancim janë emetuar 252,421,000€.

Tabela 6 - Shpalosje për Emetimet e Reja të Letrave me Vlerë ('000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2024
Maturimet	-260,414
Emetimet	252,421
Emetimet e Reja	-7,993

Përveç bankave komerciale që janë akterë primar si dhe Trustit Pensional si participant primar, Letra me Vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizikë dhe juridikë (biznese dhe individë privat). Në vijim janë prezantuar në tabelë mbajtësit e letrave me vlerë në tri vitet e fundit.

Tabela 7 - Mbajtësit e Letrave me Vlerë - vlerë nominale ('000 në €)

Instrumenti	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Bankat Komerciale	229,220	231,500	279,510
Fondet Pensionale	434,920	444,540	550,270
Institucionet Publike	215,580	216,600	213,560
Kompanitë e Sigurimeve	51,880	50,330	45,910
Të tjerë	33,810	29,690	26,800
Gjithsej	965,410	972,660	1,116,050

5 Është rishikuar vlera e BPV-së nga ASK me datën 14.03.2025;

Garancitë shtetërore

Në vitin 2024 portofolio e garancive shtetërore të Republikës së Kosovës përbëhet nga një garanci shtetërore e emetuar. Garancia Shtetërore dhe Komunale trajtohet si borxh gjatë llogaritjes së treguesit Borxh/BPV.

Kjo garanci është emetuar gjatë vitit 2016 në vlerë 10,000,000€, përmes së cilës Republika e Kosovës e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e huazuar nga BERZh. Deri në fund të vitit 2024, huamarrësi ka kthyer shumën e kredisë në vlerë 6,430,000€.

Tabela 8 - Gjendja e garancive shtetërore ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Garancitë Shtetërore	3,570	28,590	29,610
BERZh Garancia për Trafikun Urban-Prishtinë	3,570	4,590	5,610
BERZh Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	0	24,000	24,000
Garancitë Shtetërore sipas % së BPV	0.03%	0.30%	0.33%

Rekomandime për Qeverinë

- **Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve; dhe**

- **Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.**

Rekomandim për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.

5. Analiza e buxhetit të shtetit

Të dhënat e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2024 dhe si rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore.

Projeksionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore Nr.08/L-260 ishin në vlerë 3,436,472,000€ dhe nuk kishin ndryshuar gjatë vitit. Derisa realizimi i të hyrave/pranimeve për vitin 2024 ishte në vlerë prej 3,234,089,000€ apo 94% e buxhetit final. Krahasuar me realizimin e vitit 2023 pranimet janë rritur për 368,449,000€, apo rreth 13%.

Lëvizjet buxhetore tek shpenzimet (në vlerë totale 128,129,000€) përmes Vendimeve të Qeverisë përgjat vitit, kishin ndikuar në disa Organizata Buxhetore, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte kishte rritur buxhetin, kurse në disa të tjera e kishin zvogëluar atë. Këto lëvizje buxhetore, vijnë nga ndarjet nga ndryshimet sipas LMFPP-së në vlerë prej 36,964,000€, duke vazhduar nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë prej 81,895,000€ dhe ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve në vlerë prej 9,270,000€.

Buxheti fillestar për shpenzime ishte 3,492,163,000€, kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,620,293,000€ i cili ishte realizuar në vlerë 3,195,579,000€ apo 88% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2023 kishte rritje të shpenzimeve për 269,581,000€ apo 9%.

Informatat në detaje mbi planifikimet fillestare, buxhetin final dhe realizimin janë prezantuar në tabelat në vijim.

Tabela 9 - Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizim (në '000€)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	Sipas Buxhetit Final	Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-260 viti 2024
1	Tatimet direkte	517,168	534,544	534,544
2	Tatimet indirekte	2,297,114	2,249,847	2,249,847
3	Kthimet	-74,131	-79,273	-79,273
4	Të hyrat jo tatimore	337,939	292,880	292,880
5	Grantet dhe ndihmat	9,929	30,000	30,000
6	Financimi nga huamarrja	123,306	391,452	391,452
7	Pranimet tjera	22,764	17,023	17,023
Total pranimet		3,234,089	3,436,472	3,436,472
1	Paga dhe mëditje	843,034	844,744	805,390
2	Mallra dhe shërbime	429,198	491,132	484,773
3	Shpenzime komunale	29,249	33,047	34,186

4	Subvencione dhe Transfere	1,112,492	1,162,405	1,062,316
5	Shpenzimet kapitale	647,014	840,896	859,176
6	Rezerva	-	2,651	10,173
7	Interesi	42,215	46,309	46,309
8	Të tjera	92,376	199,110	189,840
Total pagesat		3,195,579	3,620,293	3,492,163
Rritja/zvogëlimi i bilancit bankar		38,509	(183,821)	(55,691)

Sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, te Rezervat janë buxhetuar 10,173,000€ prej tyre në nivel qendror 9,769,000€ dhe nivel lokal 404,000€.

Pjesa e nivelit qendror prej 7,233,000€ janë shpërndarë përmes vendimeve të qeverisë, për mbulimin e një pjesë të pagesës sipas Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit për rastin ICC HBH Contour Global, për mbulimin e mungesës së mjeteve në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa për komunat e Kamenicës dhe Vitisë dhe për mbulimin e nevojave tjera emergjente.

Pjesa e nivelit lokal prej 289,000€ janë shpërndarë për financimin e projekteve kapitale.

Në buxhetin final kanë mbetur si mjete të lira pjesa prej 2,651,000€ (2,536,000€ te niveli qendror dhe 115,000€ te niveli lokal).

5.1. Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike

Projeksionet për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-260 për vitin 2024 ishin në vlerë 3,436,472,000€, derisa realizimet ishin në vlerë 3,234,089,000€ apo 94% e planifikimit të tyre.

Pasqyra më poshtë ofron informata më në detaje për buxhetin fillestar, final dhe trendet e realizimeve gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 10 - Pranimet sipas burimit sipas RVF/BRK-së ('000 në €)

Pranimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Realizimi 2022
Tatimet direkte	534,544	534,544	517,168	490,294	413,829
Tatimet indirekte	2,249,847	2,249,847	2,297,114	2,076,882	1,870,248
Kthimet	-79,273	-79,273	-74,131	-61,277	-67,069
Të hyrat jo tatimore	292,880	292,880	337,939	266,881	256,532
Grantet dhe ndihmat	30,000	30,000	9,929	81,323	19,988
Financimi nga huamarrja	391,452	391,452	123,306	-36,845	112,201
Pranimet tjera	17,023	17,023	22,764	48,382	22,823
Total	3,436,472	3,436,472	3,234,089	2,865,640	2,628,552

Në tre vitet e fundit, ka një trend të rritjes së të hyrave buxhetore. Në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, realizimi i pranimeve/të hyrave është më i lartë për 13%, ndërsa në raport me vitin 2022, realizimi është më i lartë për 23%.

Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave (TAK), tatimi në të ardhura personale (TAP), tatimi në pronë (TP), si dhe tatime tjera. Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë 517,168,000€ apo rreth 97% e shumës së planifikuar me buxhetin vjetor për këtë kategori të të hyrave.

Burim kryesor i tatimeve direkte ishte: tatimi në të ardhura personale me 280,782,000€ apo 54%, tatimi në të ardhura të korporatave me 203,380,000€ apo 39%, tatimi në pronë me 32,977,000€ dhe tatimet tjera me 29,000€ apo 7%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga Komunat. Krahasuar me vitin 2023, tatimet direkte kanë shënuar rritje për 5%, ndërsa 25% krahasuar me vitin 2022.

Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH), detyrimi doganor, akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi për këtë kategori të të hyrave ishte 2,297,114,000€ apo 102% nga shuma e planifikuar me buxhetin vjetor. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 1,504,924,000€ apo afër 66% e realizimit total, akcizat 618,287,000€ apo 27%, taksat doganore 172,069,000€ apo 7%, dhe tatimet tjera indirekte prej 1,834,000€. Krahasuar me vitin 2023, tatimet indirekte kanë shënuar rritje për 220,232,000€ apo rreth 11%, ndërsa krahasuar me vitin 2022, rritja është për 426,866,000€ apo rreth 23%.

Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganën, përllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit, shuma e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 79,273,000€, ndërkaq shumat e kthyera deri në përfundim të vitit fiskal ishin 74,131,000€ ose 94% e planit. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK ishte 71,610,000€, kurse 2,521,000€ janë kthimet nga Dogana. Në krahasim me vitin 2023, kthimet e tatimeve ishin për 12,854,000€ më të larta apo për 21%.

Të hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj. Të hyra jo tatimore mblidhen nga niveli qendror, niveli lokal dhe agjencitë e pavarura buxhetore.

Të hyrat jo tatimore për vitin 2024 sipas Ligjit të Buxhetit fillestar dhe final ishin në vlerë prej 292,880,000€. Prej tyre në nivelin qendror ishin planifikuar 166,280,000€, në nivelin lokal 56,200,000€, renta minerare 30,300,000€, taksa koncesionare 32,000,000€, të hyrat nga dividenta 5,000,000€ si dhe të hyrat nga interesi 3,100,000€.

Realizimi i të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2024 ishte 337,939,000€ apo 115% e planit. Prej tyre, 197,787,000€ ishte shuma e mbledhur nga niveli qendror, nga niveli lokal 66,239,000€, nga rentat minerare ishte 27,455,000€, nga taksa koncesionare 33,037,000€, nga të hyrat nga interesi i kredive për ndërmarrje publike 3,045,000€ si dhe nga të hyrat nga dividenta 10,376,000€.

Trendi tregon se të hyrat jo tatimore kanë shënuar rritje për 71,058,000€ apo rreth 27% krahasuar me vitin 2023, dhe për 81,407,000€ apo rreth 32% në raport me vitin 2022.

Grantet dhe ndihmat

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes të Qeverisë dhe donatorëve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Shuma e granteve sipas Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-260 për ndarjet buxhetore dhe buxhetin final për vitin 2024, duke përfshirë grantet për mbështetje buxhetore, ishte planifikuar në vlerë prej 30,000,000€. Realizimi i granteve ishte 9,929,000€ apo 33% nga vlera e planifikuar.

Financimi nga huamarrja

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja ishin planifikuar në vlerë 391,452,000€, prej tyre, huamarrja e jashtme ishte në vlerë prej 291,452,000€, ndërsa huamarrja e brendshme ishte në vlerë prej 100,000,000€.

Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njëhershëm AKP-së, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e dedikuara dhe pranimet nga depozitat. Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-260, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 17,023,000€, gjatë vitit nuk ka pasur lëvizje të buxhetit në këtë kategori.

Realizimi i pranimeve tjera ishte në vlerë 22,764,000€, prej të cilave: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 11,486,000€, të hyrat e dedikuara në vlerë 6,485,000€ dhe pranimet nga depozitat në vlerë 4,793,000€.

5.2. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Buxheti final për shpenzimet e përgjithshme ishte në vlerë 3,620,293,000€, ndërsa realizimi ishte 3,195,579,000€ apo 88% e buxhetit. Krahasuar me vitin 2023, pagesat janë rritur për 269,581,000€, ndërsa me vitin 2022 janë rritur për 570,571,000€.

Tabela 11 - Pasqyra e pagesave krahasuar me dy vitet e fundit ('000 në €)[6]

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Realizmi 2022
Pagat dhe Shtesat	805,390	845,548	843,599	767,305	653,436
Mallrat dhe Shërbimet	484,773	497,500	432,514	397,978	337,414
Shërbimet Komunale	34,186	33,072	29,250	28,779	25,952
Subvencionet dhe Transferet	1,062,316	1,165,294	1,114,605	1,079,450	1,065,195
Investime kapitale	859,176	852,079	654,626	560,868	422,579
Shpenzimet e interesit	46,309	46,309	42,215	42,215	35,039
Rezervat	10,173	2,651	-	-	
Të tjera	189,840	177,840	78,770	49,403	85,394
Total	3,492,163	3,620,293	3,195,579	2,925,998	2,625,009

Në vijim janë paraqitur realizimi i shpenzimeve sipas kategorive si dhe krahasimet me vitet e kaluara.

Pagat dhe shtesat

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore prezantohen si një ndër kategoritë me përqindje të lartë të shpenzimeve me 26%. Buxheti për vitin 2024 ishte 845,548,000€, ndërsa shpenzimet 843,599,000€ apo mbi 99% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 76,294,000€ që ka ndodhur për shkak të rritjes të vlerës së koeficientit të pagave dhe rritjes së numrit të përgjithshëm të të punësuarve për 1075 punonjës.

Po ashtu, edhe këtë vit kishte pagesa për punonjësit në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë. Numri i të punësuarve për këtë kategori të punonjësve ishte 101, kurse vlera e këtyre pagesave për vitin 2024 ishte 691,050€.

6 Vlerat në tabelë sipas kategorive ekonomike, përfshijnë edhe grantet e donatorëve.

Mallrat dhe shërbimet

Në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore marrin pjesë me rreth 14%. Buxheti final për vitin 2024 ishte 497,500,000€, ndërsa shpenzimet 432,514,000€ apo rreth 87% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 34,536,000€.

Shërbimet komunale

Buxheti për vitin 2024 ishte 33,072,000€, ndërsa shpenzimet 29,250,000€ apo rreth 88% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 471,000€.

Subvencionet dhe Transferet

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 35% që njëherit prezanton kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti për vitin 2024 ishte 1,165,294,000€, kurse shpenzimet ishin 1,114,605,000€ apo rreth 96% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 35,155,000€.

Investimet kapitale

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme investimet kapitale marrin pjesë me rreth 20%. Buxheti final për këtë kategori ishte 852,079,000€, kurse shpenzimet 654,626,000€ apo rreth 77% e buxhetit për investime kapitale. Krahasuar me vitin 2023 ka një rritje të shpenzimeve për 93,758,000€.

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të deajuar dhe të aprovohet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MFPT aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Në këtë nivel të realizimit të Investimeve kapitale ka ndikuar mos inicimi me kohë i kërkesave nga njësitë kërkuese të organizatave, apo tejzgjatja e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave nga operatorët në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Po ashtu, një pjesë e kontratave për punë janë ndërprerë për shkak të mos realizimit të punimeve nga operatorët ekonomik, menaxhimi jo i duhur i zbatimit të kontratave dhe mos zgjidhja e problemeve shpronësore mbetet një sfidë nga viti në vit, si shkak i të cilës tejzgjaten punimet e kontraktuara.

Realizimi më i ulët i projekteve kapitale vërehet te këto organizata buxhetore: Ministria e Ekonomisë 31%, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë 26%, Ministria e Shëndetësisë 57%, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit 61%, Komuna e Prishtinës 63%, Komuna e Kamenicës 67% etj.

Realizimi i ulët i projekteve kapitale te niveli qendror, ka rezultuar kryesisht si pasojë e planifikimit të dobët të Ndërmarrjeve Publike të cilat kanë qenë bartëse të planifikimit dhe të realizimit të projekteve të financuara nga klauzola e investimeve, vonesa në nënshkrim të kontratave për shkak të ankesave në OSHP si dhe vonesa në kryerjen e punëve dhe shërbimeve sipas planit dinamik të tyre.

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbarimore) dhe shpenzimeve të interesit. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ri destinuar për t'u paguar këto detyrime.

Në nivelin lokal gjashtë[7] komuna, kishin përdorur fondet e projekteve tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar në vlerë të përbashkët 4,657,001€, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër, duke mos marrë aprovimin nga kuvendi komunal.

Po ashtu, shtatë (7) komuna, kishin hyrë në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontrata për projekte pa pasur buxhet të mjaftueshëm, në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore, e ku vlera e përbashkët e obligimeve kontraktuale pa mbulesë ishte 13,225,982€. Detajet e hyrjes në obligime kontraktuale përtej buxhetit sipas Komunave janë si në vijim:

- Komuna e Podujevës, në gjashtë (6) kontrata në vlerë 4,619,545€;
- Komuna e Prizrenit, në tre (3) kontrata në vlerë 3,301,660€;
- Komuna e Prishtinës, në dy (2) kontrata në vlerë 1,898,964€;
- Komuna e Pejës, në një (1) kontrata në vlerë 1,447,611€;
- Komuna e Malishevës, në katër (4) kontrata në vlerë 1,102,644€;
- Komuna e Vitisë, në tre (3) kontrata në vlerë 524,870€;
- Komuna e Kaçanikut, në tre (3) kontrata në vlerë 330,688€.

Shpenzimet e interesit, rezervat dhe pagesat tjera

Për këto kategori janë buxhetuar gjithsej 226,800,000€ ndërsa janë realizuar shpenzime në vlerë 120,985,000€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet e interesit, pagesat për kthimin e borxhit dhe nën huazimeve, dhe kthimi i depozitave.

7 Prishtina, në vlerë 3,400,807€; Suhareka, në vlerë 305,213€; Podujeva, në vlerë 350,562€; Malisheva, në vlerë 466,767€; Vushtrria në vlerë 68,756€; si dhe Vitia, në vlerë 64,896€.

Rekomandime për Qeverinë

- **Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollet në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe të monitoroj nëse fondet e alokuara janë të mjaftueshme dhe janë shpenzuar për projektet për të cilat janë aprovuar me buxhet; dhe**

- **Përmes ministrive përkatëse të ndërmerr veprimet të mëtejshme për punonjësit që nuk kanë vijueshmëri në punë, të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.**

5.2.1. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Sipas Rregullës financiare Nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve në vitin 2024 ishte në vlerë prej 35,254,641€, duke reflektuar një problem të theksuar në mënyrën si janë regjistruar shpenzimet publike. Prej kësaj shume, 27% i përket nivelit qendror (15 organizata buxhetore), ndërsa 73% nivelit lokal (31 komuna). Krahasuar me vitin paraprak, vlera e shpenzimeve të klasifikuara në kategori jo adekuate është rritur për 10,115,369€, apo 40%.

Rritja më e theksuar lidhet me pagesat e kryera përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore, buxhetimit jo adekuat të shpenzimeve dhe pagesave të kryera gabimisht nga vetë OB-të. Në tabelë prezantohen më në detaje klasifikimet jo adekuate të shpenzimeve.

Tabela 12 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategori ekonomike

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Investimet kapitale	281,065	1,269,331	1,102,289	2,652,685
	Pagat dhe shtesat	102,088	-	5,154,650	5,256,738
	Subvencionet dhe transferet	109,137	-	132,298	241,435
Gjithsej Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë		492,290	1,269,331	6,389,237	8,150,858
Subvencionet dhe transferet	Investimet kapitale	-	-	241,777	241,777
	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	487,842	-	-	487,842
	Pagat dhe shtesat	-	-	821,459	821,459
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		487,842	-	1,063,236	1,551,078
Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	1,048,877	3,843,251	3,811,940	8,704,068
	Pagat dhe shtesat	731	-	16,051,982	16,052,713
	Subvencionet dhe transferet	760,760	-	35,164	795,924
Gjithsej Investimet kapitale		1,810,368	3,843,251	19,899,086	25,552,705
Gjithsej Keqklasifikimi për vitin 2024		2,790,500	5,112,582	27,351,559	35,254,641

Si në tabelën e mësipërme, më e ndikuar nga klasifikimi jo adekuat është kategoria e Investimeve Kapitale me 25,552,705€ apo 73%, pastaj kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve me 8,150,858€ apo 23% dhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve me 1,551,078€ apo 4%.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte ndikuar kryesisht nga:

- Pagesat e realizuara nga Thesari apo OB, përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore me 27,351,559€ apo 78%;
- Buxhetimi jo i duhur me 5,112,582€ apo 14%; dhe
- Shpenzimet e bëra nga vetë organizatat buxhetore në kategori ekonomike të gabuara me 2,790,500€ apo 8%.

Në vijim janë paraqitur pesë (5) Ministri dhe 5 (pesë) Komuna me vlera më të lartë të klasifikimeve jo adekuate si shkak i vendime gjyqësore/përmbarimore, shpenzimeve të bëra nga vetë organizatat buxhetore apo si rezultat i buxhetimit të gabuar.

Tabela 13 - Niveli qendror

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
MMPHI	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	2,416,595	Pagesat të realizuara me vendime gjyqësore /permbarimore e që kishin të bëjnë me shpenzime të kamatës dhe shpenzimeve tjera procedurale si dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ministria ndaj operatorit ekonomik.
MASHTI	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	2,367,808	Pagesat ishin realizuar për blerjen e pajisjeve që për nga vlera individuale dhe natyra e tyre këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.
MPB	Mallrat dhe shërbimet	Paga dhe Shtesat	736,913	Pagesat janë realizuar me vendime gjyqësore/ përmbarimore dhe kishin të bëjnë borxhin kryesor për pagesën e pagave shtesë.
MKRS	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	631,066	Pagesa janë realizuar përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore për “Shpenzime të organizimit të eventeve, dizajne dhe shtypja e materialeve promovuese.
ME	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	411,433	Pagesat kishin të bënin për shërbime të internetit.

Tabela 14 - Niveli lokal

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Komuna e Gllogocit	Investimet kapitale	Paga dhe Shtesat	1,879,133	Pagesa për paga jubilare dhe shujta si rezultat i kontratës kolektive, këto shpenzime nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.
Komuna e Podujevës	Investimet kapitale	Paga dhe Shtesat	1,769,418	Pagesat janë realizuar me vendime gjyqësore/ permbarimore dhe kishin të bëjnë me shpenzime zbatimin e kontratës kolektive.
Komuna e Pejës	Investimet kapitale	Paga dhe Shtesat	1,708,393	Pagesa për paga jubilare dhe shujta dhe kualifikim për arsimtar si rezultat i kontratës kolektive, këto shpenzime nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.
Komuna e Suharekës	Investimet kapitale	Paga dhe Shtesat	1,620,470	Pagesa për paga jubilare dhe shujta dhe kualifikim për arsimtar si rezultat i kontratës kolektive, këto shpenzime nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.
Komuna e Prishtinës	Investimet kapitale	Paga dhe Shtesat	1,283,453	Pagesa për paga jubilare dhe shujta dhe kualifikim për arsimtar si rezultat i kontratës kolektive, këto shpenzime nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj kontrolle efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFPP-së dhe SNKSP-ve.

5.3. Analiza e shpenzimeve sipas funksionit

Shpenzimet sipas funksionit përfshijnë shërbimet publike, mbrojtjen, rendin dhe sigurinë publike, çështjet ekonomike, mbrojtjen e mjedisit, komoditetet e banimit dhe të bashkësisë, shëndetësinë, rekreacionin, kulturën dhe religjionin, arsimin, si dhe mbrojtjen sociale.

Tabela 15 - Pasqyra e pagesave sipas funksionit në tri vite ('000 në €)

KF	Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
01	Shërbimet e përgjithshme publike	391,973	429,725	472,062
02	Mbrojta	113,829	98,135	48,822
03	Rendi dhe siguria publike	291,870	266,377	213,931
04	Çështjet ekonomike	565,183	499,052	409,194
05	Mbrojtja e mjedisit	7,409	7,883	7,880
06	Komoditetet e banimit dhe të bashkësisë	58,511	50,554	46,952
07	Shëndetësia	320,008	298,441	238,150
08	Rekreacioni, kultura dhe religjioni	104,775	80,416	54,068
09	Arsimi	446,862	395,099	346,711
10	Mbrojtja sociale	774,175	708,698	666,960
	Total[8]	3,074,595	2,834,380	2,504,730

Shpenzimet sipas funksionit ishin në vlerë prej 3,074,595,000€ e që në raport me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 240,215,000€.

Te shumica e shpenzimeve sipas funksionit vërehet trendi në rritje i shpenzimeve nga viti paraprak e që rritja më të lartë ishte te çështjet ekonomike me 66,131,000€, te Arsimi me 51,763,000€ dhe Mbrojtja sociale me 65,477,000€.

Shpenzimet sipas funksionit janë prezantuar bazuar në shënimet e SIMFK-së. Nga analiza e shpenzimeve vërehet se ka shpenzime të cilat nuk janë klasifikuar drejt sipas funksionit. Rasti më i theksuar dhe i përsëritur është regjistrimi i shpenzimeve prej 55,435,488€ të cilat i takojnë mbrojtjes përderisa ishin të regjistruara gabimisht te shërbimet e përgjithshme publike.

8 Në total nuk përfshihen pagesat tjera: pagesa e borxhit, kredi dhënia për ndërmarrjet publike dhe kthimet nga fondet e depozitave

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.

5.4. Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike

Gjatë vitit 2024, shpenzimet për mbështetjen ekonomike janë ndarë përmes Programit të Rimëkëmbjes/ Ringjalljes Ekonomike dhe janë alokuar me kodet e programeve 00097 (kontingjencat e BE-së për Energji), 00098 (pakoja e ringjalljes ekonomike) dhe 00099 (pakoja emergjente) sipas planit kontabël. Këto mjete janë ndarë në bazë të vendimeve të Qeverisë, dhe në përputhje me autorizimet sipas ligjit të buxhetit vjetor.

Për këto programe ishin buxhetuar gjithsej 114,682,626€, ndërsa ishin shpenzuar 112,408,068€, apo 98% të mjeteve të buxhetuara. Krahasuar me vitin 2023, kur ishin shpenzuar 186,111,273€, vërehet një zvogëlim prej 73,703,206€ në nivelin e shpenzimeve për këto programe.

Tabela 16 - Totali i pagesave nga kodi 00097, 00098 dhe 00099

Përshkrimi	Buxheti 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Progresi 2024
Kontingjencat e BE-së për Energji (00097)	28,701,795	27,779,253	44,759,839	97%
Pakoja e Ringjalles Ekonomike (kodi 00098)	85,497,300	84,290,745	140,724,960	99%
Pakoja Emergjente (kodi 00099)	483,531	338,070	626,474	70%
Gjithsej	114,682,626	112,408,068	186,111,273	98%

Shpenzimet për këto programe ekonomike janë realizuar nga niveli qendror dhe janë shpërndarë si më poshtë:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka shpenzuar 85,994,879€, për mbështetjen e bizneseve, mbështetjen e mërgatës dhe për energji nga kontingjenca e BE-së;
- Ministria e Ekonomisë ka shpenzuar 19,202,282€, për mbështetjen e ndërmarrjeve publike dhe për energji nga kontingjenca e BE-së;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka shpenzuar 6,543,533€, për subvencionimin e teksteve dhe mjeteve shkollore;
- Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar 338,070€ për sektorin e shëndetësisë, kryesisht në paisje dhe shtesat e stafit shëndetësor;
- Zyra e Kryeministrit ka shpenzuar 253,675€ për zbatimin e skemës së granteve për zanate; dhe
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka shpenzuar 75,629€, për subvencionimin e kredive investive.

Mjetet në lidhje me pakon e ringjalljes ekonomike ishin realizuar nga kategoria subvencione dhe transfere.

Shpenzimet nga kontingjenca e BE-së janë ndarë nga MFPT dhe ME në pjesën më të madhe për Subvencione dhe Transfere dhe për mallra dhe shërbime dhe shkalla e realizimit të tyre ishte 97%.

Tabela 17 - Kontingjencat e BE-së për Energji (00097) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Progresi
Mallra dhe shërbime	113,779	17,695	0	16%
Subvencione dhe transfere	28,588,016	27,761,557	44,759,839	97%
Total	28,701,795	27,779,252	44,759,839	97%

Shpenzimet nga pakoja e ringjalljes ekonomike janë dhënë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve përmes ZKM, MFPT, MINT, MASHT dhe ME.

Tabela 18 - Pagesat nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (kodi 00098) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Progresi
Paga dhe shtesa	-	-	887,258	-
Subvencione dhe transfere	85,497,300	84,290,745	139,837,702	99%
Total	85,497,300	84,290,745	140,724,960	99%

Shpenzimet nga pakoja emergjente, kanë të bëjnë me mjete të ndara për nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe shkalla e realizimit të tyre ishte 70%.

Tabela 19 - Pagesat nga Pakoja Emergjente (00099) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Progresi
Paga dhe shtesa	38,782	38,782	204,777	100%
Mallra dhe shërbime	3,362	990	292,547	29%
Investime kapitale	441,387	298,298	129,150	68%
Total	483,531	338,070	626,474	70%

5.5. Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit

Financimi i ndërmarrjeve publike për vitin 2024 ishte në vlerë 29,766,549€ apo rreth 20% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Janë financuar 15 ndërmarrje publike, prej tyre pesë (5) ndërmarrje të nivelit qendror, shtatë (7) janë rajonale si dhe tre (3) të nivelit lokal. Pjesa më e madhe e financimit është realizuar nga granti qeveritar në vlerë 29,243,878€ apo 98% si dhe nga të hyrat vetanake të komunave dhe donatorët e jashtëm në vlerë 522,671€ apo rreth 2%.

Nga analiza e orientimit të financimit vërehet se 82% ishin për financimin e NP-ve qendrore kurse pjesa tjetër për NP rajonale (16%) dhe lokale (2%).

Në vijim kemi paraqitur qëllimin e subvencionimit për disa nga ndërmarrjet publike qendrore si pranueset e pjesës më të madhe të financimit:

- Subvencionimi i NP Trepça - ishte për mbulimin e shpenzimeve operative si: pagat e punëtorëve, energjia elektrike, naftë, furnizim me lëndë dhe pajisje për ecurinë e prodhimit, mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve/makinerive, blerjen e mjeteve të punës etj;
- Subvencionimi i Postës së Kosovës - ishte për kompenzimin e humbjeve për sigurimin e shërbimit universal postar të vitit 2023;
- Subvencionimi i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) për mbështetjen nga pako për ringjalljen ekonomike, masa 4.6. Po ashtu, për të mbuluar koston e devijimeve të energjisë elektrike në komunat veriore, sipas vendimit të Qeverisë 03/240, janë marrë fondet nga Komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq dhe i janë transferuar KOSTT-it;
- Subvencionimi i NP Trainkos - ishte për funksionalizimin e linjave të aprovuara për transportin e udhëtarëve gjatë periudhës fiskale pesë vjeçare 2023-2027 si dhe për financimin e shpenzimeve tjera operative të ndërmarrjes si: paga, qasja në binarë, për lëndë djegëse etj; dhe
- Subvencionimi i NP Infrakos - ishte për financimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjes si: paga, energjinë elektrike etj.

Po ashtu, edhe qëllimi i financimit të NP-ve tjera rajonale dhe lokale ishte kryesisht për mbulimin shpenzimeve operative të tyre.

Organizatat Buxhetore me pjesëmarrjen më të madhe të financimit të NP-ve ishin ME me 83% si dhe MFPT 10%.

Me poshtë janë paraqitur ndërmarrjet publike të financuara sipas fondit burimor, nivelit dhe organizatës buxhetore financuese.

Tabela 20 - Subvencionimi i Ndërmarrjeve Publike

Nr	Organizata Buxhetore Financuese	Ndërmarrja Publike Përfituese	Fondi Burimor			Total
			Donatorët e jashtëm (FB-61)	Fondi Qeveritar (FB 10)	Të Hyrat vetanake të Komunave (FB 21&22)	
Ndermarrjet Publike Qendrore						
1	MMPHI dhe ME	Trainkos SHA	-	2,119,197	-	2,119,197
2	Ministria e Ekonomisë	Posta e Kosovës Sh.A	-	1,168,932	-	1,168,932
3	Ministria e Ekonomisë	Infrakos SHA	-	1,292,568	-	1,292,568
4	Ministria e Ekonomisë	Trepça SHA	-	9,870,976	-	9,870,976
5	ME dhe MFPT	KOSTT SHA	-	9,874,502	-	9,874,502
Totali			-	24,326,175	-	24,326,175
Ndermarrjet Publike Rajonale						
1	ME, Komuna Gjakovë dhe Rahovec	KRU Gjakova SHA	-	1,200,000	192,671	1,392,671
2	ME dhe Komuna Suharekë	KRU Hidroregjioni Jugor SHA	-	228,496	-	228,496
3	Ministria e Ekonomisë	KRU Hidrodrini SHA	-	379,422	-	379,422
4	ME dhe Komuna Podujevë	KRU Prishtina SHA	-	834,820	-	834,820
5	Ministria e Ekonomisë	KRU Bifurkacioni SHA	-	616,402	-	616,402
6	Ministria e Ekonomisë	KRU Mitrovica SHA	-	46,300	-	46,300
7	ME dhe Komuna Kamenicë	Hidromorava SHA	-	1,108,819	100,000	1,208,819
Totali			-	4,414,259	292,671	4,706,929
Ndermarrjet Publike Lokale						
1	ME & Komuna Gjakovë	Ngrohtorja e qytetit	-	443,444	150,000	593,444
2	Komuna Kamenicë	NPL Dardana SHA	-	10,000		10,000
3	Komuna Skënderaj	NPL Eko Natyra SHA	80,000	50,000		130,000
Totali			80,000	503,444	150,000	733,444
Totali i përgjithshëm			80,000	29,243,878	442,671	29,766,549
% e financimit sipas fondit			0.3%	98.2%	1.5%	100%

6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme transit, Kuota në Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF), llogaritë e Misioneve Diplomatike të Republikës së Kosovës, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Fondet për qëllime specifike përbëhen nga**:** Grantet e Përcaktuara të Donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, të tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave), dhe Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2024 dhe të bartura në vitin 2025.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa më e madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2024 ishte 423,884,000€.

Tabela 21 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve ('000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Banka Qendrore e Kosovës	395,911	345,232	419,664
Kuotat në INF	9,832	8,395	8,210
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	3,837	3,566	3,256
Paraja në transit	7,223	22,894	10,845
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	4,849	3,899	2,527
Para të gatshme (arka)	2,231	1,389	1,233
A. Gjithsej: pasuritë financiare në PG	423,884	385,375	445,734
Bilanci i fondeve	**Viti 2024**	**Viti 2023**	**Viti 2022**
Garantët e përcaktuara të donatorëve	7,675	17,472	15,505
Të hyrat vetiake të bartura NQ	2,000	3,027	2,584
Të hyrat vetiake të bartura në NL	57,515	81,387	90,005
Fondi zhvillimor në mirëbesim	3,782	3,510	7,974
Të hyrat e dedikuara	4,253	3,431	2,285
Grantet (kontigjenca) e BE-së për energji	-	22,740	-
Të hyrat tjera	33,832	29,262	24,807
Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja	6,953	6,226	16,751
B. Fonde qëllime specifike	116,010	167,056	159,911
C. Të pashpërndara	307,874	218,320	285,824
Gjithsej fondet (B+C)	423,884	385,375	445,734

Bilanci i fondeve, në fund të vitit 2024 është rritur për 38,509,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2023. Bilanci bankar i pasurive financiare - parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2024 ishte 423,884,000€.

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK është 395,911,000€ apo 93% e totalit të parasë së gatshme. Krahasuar me vitin paraprak, paraja e gatshme në fund të vitit 2024 është rritur për 50,679,000€.

7. Pasuritë jo financiare kapitale, jokapitale dhe stoqet

Rregullorja MF Nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit. Pasuritë jo financiare sipas klasifikimit kontabël ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, kanë vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, kanë vlerë financiare më pak se 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

Menaxhimi i pasurive jo financiare bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël i SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MFPT-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€, si dhe sistemi/aplikacionit "E - pasuria" që është një sistem i integruar në kuadër të MPB-së, ku të gjitha organizatat buxhetore duhet të evidentojnë, menaxhojnë dhe raportojnë për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet/pajisje rezervë dhe material zyre.

Rezultatet e auditimit tregojnë se raportet mbi pasurit jo financiare në vitin 2024 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri, janë jo të plota.

Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive jo financiare janë duke vazhduar edhe me tutje si te institucionet e nivelit qendror dhe lokal duke mos i regjistruar saktë dhe raportuar drejtë pasuritë e tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Si rezultat, këto pasaktësi reflektohen edhe në Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë (RVF-BRK), pavarësisht rekomandimeve të përsëritura ndër vite për përmirësimin e menaxhimit dhe forcimin e kontrolleve.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PVF-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Tabela 22 - Pasuritë jofinanciare kapitale dhe jokapitale si dhe stoqet

Pasuritë	Institucionet	Vlera e pasurisë në RVF-BRK	Sipas Auditimit	Mbivlerësimi/ Nënvlerësimi
Pasuritë kapitale mbi 1,000€	Niveli Qendror	3,389,091,020	3,358,611,318	30,479,702
	Niveli Lokal	6,815,668,241	6,818,618,566	-2,950,325
Pasuritë kapitale nën 1,000€	Niveli Qendror	34,631,448	34,070,077	561,371
	Niveli Lokal	25,867,561	26,334,853	-467,292
Stoqet	NQ+NL	42,634,095	43,167,392	-533,297
Total		10,307,892,365	10,280,802,206	27,090,159

Pasuritë jo financiare, sipas auditimit, në total ishin mbivlerësuara në vlerë neto për 27,090,159€.[9] Nga kjo vlerë, në nivelin qendrore pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 30,479,702€, ndërsa në nivelin lokal ishin nënvlerësuar për 2,950,325€. Pasuritë jo kapitale, në nivelin qendror, ishin mbivlerësuar për 561,371€, ndërsa në nivelin lokal ishin nënvlerësuar për 467,292€.

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK janë 42,634,095€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 43,167,392€ me një nënvlerësim prej 533,297€.

Edhe në vitin 2024, gjendja e pasurisë jo financiare është përcjellë me pasaktësi, pasi që totali i mbivlerësimeve neto ishte 27,090,159€, (në vitin 2023 nënvlerësimi neto ishte 20,801,678€).

Niveli qendror

Në nivelin qendror, 16 organizata buxhetore, prej tyre 12 ministri dhe katër (4) institucione të pavarura kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë jo financiare të raportuara në PVF, duke mos i raportuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë pasuritë kapitale dhe jo kapitale..

Nga auditimet individuale ka rezultuar se disa organizata buxhetore kanë përfshirë në regjistra pasuri jo financiare të cilat nuk i plotësojnë kriteret për t'u regjistruar. Si pasojë, vlera neto e prezantuar në Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë (RVF-BRK) është mbivlerësuar për 30,479,702€, kryesisht si rezultat i raportimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me vlerë 30,855,845€ dhe nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës me 1,016,094€.

Në anën tjetër, janë evidentuar edhe nënvlerësime në disa institucione të tjera qendrore, si në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për 1,184,104€, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për 1,232,643€ dhe në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për 870,760€.

9 Mbivlerësimet kapitale dhe jokapitale janë 31,041,073€, ndërsa nënvlerësimet janë 3,950,914€

Këto mospërputhje janë shkaktuar kryesisht nga::

- Mosfunksionim i kontrolleve të brendshme;
- Mos kompetenca e duhur e zyrtarëve përgjegjës në regjistrimin e pasurive; dhe
- Mos koordinimi i institucioneve qendrore me ato lokale për ti siguruar marrëveshjet e nënshkruara nga komunat për bartjen e pronësisë se tyre.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet dhe menaxhimi i pasurive jo financiare është përcjellë me disa mangësi, që kryesisht janë:

- Në pesë (5) institucione nuk ishte bëre mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim;
- Në dy (2) Ministri nuk ishte kryer procesi i Inventarizimit dhe nuk ishin bërë harmonizime me regjistrat e kontabilitetit.
- Në dy (2) ministri nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë, përderisa në tetë (8) institucione procesi i inventarizimit nuk ishte kryer me kohë, ishte kryer pjesërisht apo nuk ishte kryer fare;
- Në katër (4) institucione të pavarura nuk ishte përdorur sistemi e-pasuria;
- Në një (1) ministri kishte mangësi në regjistrimin e pasurive në klasat e duhura të pasurive; dhe
- Në një (1) ministri nuk është bërë zhvlerësimi përmes softuerit e-pasuria.

Niveli Lokal

Në nivelin lokal, 16 komuna, kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë jo financiare të raportuara në PVF, duke mos i raportuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë pasuritë kapitale dhe jo kapitale.

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa komuna nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë jo financiare, dhe si rezultat i kësaj, vlera e pasurive jo financiare e prezantuar në RVF-BRK është nënvlerësuar për 3,417,617€. Komunat që kanë ndikuar me se shumti në nënvlerësimin e pasurive jo financiare janë: Mitrovica e Jugut me 2,824,090€, Deçani me 965,276€, Zubin Potoku me 935,311€, Prizreni me 645,857€ dhe e Vushtrrisë me 607,516€. Në anën tjetër, janë evidentuar edhe mbivlerësime të pasurive jo financiare, si në Komunën e Prishtinës me 3,220,349€, Graçanicës me 275,521€ dhe Lipjani me 188,476€.

Mangësitë në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Në katër (4) komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë, përderisa në tetë (8) komuna procesi i inventarizimit nuk ishte kryer me kohë, ishte kryer pjesërisht apo nuk ishte kryer fare; dhe
- Në 12 komuna nuk ishte përdorur softueri e-pasuria për regjistrimin dhe raportimin e pasurive jo kapitale.

Stoqet për Nivelin Qendror dhe Lokal

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK janë 42,634,095€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 43,167,392€ me një nënvlerësim prej 533,297€. Nënvlerësimi neto i stokut, vjen kryesisht si rezultat i raportimit të gabuar nga Komuna e Graçanicës me një nënvlerësim prej 528,666€ dhe nënvlerësimit nga Komuna e Prishtinës 9,641€, si dhe kemi një mbivlerësim nga Ministria e Shëndetësisë për 5,010€.

Rekomandime për Qeverinë

- **Qeveria përmes MFPT duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të kontrolleve të brendshme dhe të rrisë kompetencën e stafit përgjegjës në regjistrimin e pasurive në mënyrë që regjistrat e pasurive të prezantohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë, si dhe procesi i inventarizimit të kryhet sipas afateve ligjore; dhe**

- **Qeveria duhet të sigurojë përdorimin e sistemit e-pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.**

8. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme i referohen shumave monetare që palët e jashtme u detyrohen organizatave buxhetore për shërbimet e kryera ose transaksione të tjera të ofruara, për të cilat të hyrat ende nuk janë arkëtuar. Këto mjete mbeten si borxhe të pa arkëtuara, ndërsa OB-të janë të detyruara që sipas rregullave përkatëse, të ndërmarrin veprime për mbledhjen e tyre. Vjetërsimi i këtyre llogarive e vështirëson procesin e arkëtimit dhe krijon rrezik për humbje financiare për OB-të.

Të arkëtueshmet luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin dhe menaxhimin financiar të sektorit publik. OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të shumave të faturuara e të pa arkëtuara, të cilat shërbejnë si bazë për raportim financiar. Përderisa shënimet mbahen kryesisht në mënyrë manuale, ato më pas konsolidohen si për nevoja të raportimit financiar të organizatave, ashtu edhe për pasqyrat e konsoliduara financiare.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të këtyre llogarive në PVF-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes vlerave të raportuara.

Tabela 23 - Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme në tre vitet e fundit (në €)

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2024	Sipas RVF - BRK 2024		
		2024	2023	2022
Niveli qendror	727,620,859	727,843,864	669,694,702	599,860,698
Niveli lokal	277,930,914	276,813,136	248,509,187	231,390,985
Total	1,005,551,773	1,004,657,000	918,203,889	831,251,682

Bazuar në auditimin tonë, vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme ishte 1,005,551,773€, ndërsa vlera e raportuar në RVF-BRK ishte 1,004,657,000€. Kjo paraqet një nënvlerësim prej 894,773€, i cili përbëhet nga një mbivlerësim në nivelin qendror prej 223,005€ dhe një nënvlerësim në nivelin lokal prej 1,117,778€.

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror

Vlera e llogarive të arkëtueshme e raportuar në RVF për nivelin qendror ishte 727,843,864€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ishte 727,620,859€, që paraqet një mbivlerësim prej 223,005€. Vërehet një trend i vazhdueshëm i rritjes së vlerës së llogarive të arkëtueshme ndër vite, ndërsa veprimet e ndërmarra për raportimin e saktë dhe të drejtë të tyre vazhdojnë të mos jenë mjaftueshëm efikase.

Në nivelin qendror, rreth 89.2% e vlerës së përgjithshme të llogarive të arkëtueshme përbëhet nga tri institucione: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me vlerë prej 649,786,592€ apo 81.2%; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me 41,962,983€, apo 6%; dhe Ministria e Punëve të Brendshme me 14,141,189€, apo 2%.

Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror kanë shënuar një rritje prej 8.73%, ndërsa një vit më parë rritja ishte 10.1%.

Institucionet e nivelit qendror të cilat kanë raportuar vlera jo të sakta të llogarive të arkëtueshme në pasqyra vjetore financiare (ndryshimet në mes të pasqyrave financiare të OB-së dhe vlerës sipas auditimit):

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerën prej 237,013€ si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate në paraqitjen dhe azhurnimin e regjistrave në përputhje me dokumentet burimore;
- Ministria e Shëndetësisë kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 10,000€, si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur gjatë përgatitjes së PVF; dhe
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 24,008€, pasi që nuk i kishte raportuar llogaritë e arkëtueshme që i përkasin viteve 2014-2018.

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal

Vlera e llogarive të arkëtueshme të raportuara në RVF-BRK ishte 276,813,136€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ishte 277,930,914€, me një nënvlerësim për 1,117,778€.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal përbëhen nga tatimi në pronë, taksat ndërtimi, lejet e urbanizimit, qiratë dhe të tjera. Në totalin e llogarive të arkëtueshmeve, për nivelin lokal, Komuna e Prishtinës merr pjesë me 31%,e Prizrenit me 9.85%, dhe e Ferizajit me 6.86% etj. Krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal karakterizohen me një trend rritës prej rreth 11.33%, për dallim prej vitit të kaluar ku rritja ka qenë 6.6%.

Komunat që kanë nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare janë:

- Komuna e Graçanicës për 1,418,635€ si rezultat i mos raportimit të plotë të llogarive të arkëtueshme nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme;
- Komuna e Mitrovicës për 18,582€, si rezultat i mos raportimit së saktë i llogarive të arkëtueshme nga qiraja;
- Komuna e Vushtrrisë për 34,376€, si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme;
- Komuna e Malishevës për 1,000€, si rezultat i mungesës së dokumenteve burimore.

Komunat që i kanë mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme janë:

- Komuna e Ferizajit për 143,870€, si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme;
- Komuna e Vitisë për 85,327€, si rezultat i mos zbatimit të duhur të kornizës ligjore sa i përket faturimeve të tatimit në pronë të institucioneve publike;
- Komuna e Prishtinës për 30,008€, si rezultat i mospërputhjes se evidencave të brendshme dhe të dhënave të raportuara në pasqyrat vjetore financiare;
- Komuna e Prizrenit për 71,074€, për shkak të mos azhurnimit të regjistrit të të arkëtueshmeve me pagesat e operatorëve; dhe
- Komuna e Suharekës për 10,685€, pasi kishte ngarkuar me tatim pronën/ parcelën e cila ishte në pronësi publike.

Po ashtu, në nivelin lokal gjatë krahasimeve ndërmjet PVF-ve individuale të OB-ve dhe RVF-BRK është identifikuar një diferencë prej 13,851€, e cila ka rezultuar nga lëshime teknike të bëra gjatë bartjes së të dhënave në RVF-BRK.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të duhura në mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme dhe raportimin e saktë dhe të drejtë të tyre.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria, në koordinim me MFPT duhet të sigurojnë raportim të saktë dhe të drejtë financiar të llogarive të arkëtueshme të organizatave buxhetore. Po ashtu, duhet të sigurojnë një strategji të qëndrueshme dhe efektive të mbledhjes së të hyrave përmes rivlerësimit të mekanizmave aktual për monitorimin dhe inkasimin e borxheve.

9. Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuara për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Si rezultat i përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të raportohet në pasqyrat vjetore financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin e tyre.

Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhërblerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë.

Organizatat buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të detyrimeve të papaguara në PVF, të cilat më pas janë konsoliduar RVF-BRK. Me rastin e auditimit të këtyre pasqyrave, janë vërejtur mospërputhje në mes të vlerave të raportuara dhe gjendjes faktike, gjë që ka rezultuar me nënvlerësime të detyrimeve në nivel qendror dhe lokal.

Tabela në vijim paraqet një krahasim të detyrimeve të papaguara sipas auditimit dhe sipas RVF-BRK për tri vitet e fundit.

Tabela 24 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2024	RFV-BRK 2024			Krahasimi 2024 - 2023/ në %
		2024	2023	2022	
Niveli qendror	145,555,372	145,099,574	131,980,331	129,409,699	9.94%
Niveli lokal	52,506,288	50,916,557	26,705,028	20,089,571	90.66%
Total	198,061,659	196,016,131	158,685,359	149,499,270	23.52%

Detyrimet e papaguara sipas RVF-BRK janë 196,016,131€, ndërsa sipas auditimit janë 198,061,659€, si rezultat i kësaj kemi një nënvlerësim neto prej 2,045,528€. Krahasuar me vitin paraprak sipas RFV-2024 detyrimet janë rritur për 37,330,772€ apo rreth 24%.

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Sipas auditimit vlera e detyrimeve të papaguara në raport me RVF-BRK ishte nënvlerësuar për 455,798€.

Ky nënvlerësim është evidentuar kryesisht te Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të duhura gjatë përgatitjes së PFV-ve, si dhe pakujdesisë në përditësimin e të dhënave lidhur me detyrimet para përfundimit të vitit fiskal.

Më tej, sipas RVF-BRK-së detyrimet e nivelit qendror për vitin 2024 ishin rritur për 13,119,243€ krahasuar me ato të vitit 2023. Rritja më e theksuar e këtyre detyrimeve është evidentuar në organizatat si në vijim:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vlerë prej 6,404,195€, ku detyrimet janë krijuar kryesisht gjatë 30 ditëve të fundit të vitit. Arsyeja kryesore për moskryerjen e pagesave lidhet me pranimin e faturave pas perfundimit së vitit fiskal dhe me kthimet nga bankat komerciale;
- Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në vlerë prej 1,436,028€, arsyeja kryesore për moskryerjen e pagesave ishte për shkak se lëndët inshin në proces te shqyrtimit nga Bordi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike (TMJISHP);
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në vlerë prej 1,354,619€. Rritja e detyrimeve është rezultat i mosrealizimit të pagesave, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit, mbylljes së sistemit të pagesave, si dhe mangësive në nxjerrjen e urdhërblerjeve dhe zotimin e mjeteve;

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Si rezultat i raportimit të gabuar të detyrimeve në PVF individuale, gabimet janë bartur edhe në totalin e detyrimeve të RVF-BRK-së.

Sipas auditimit vlera e detyrimeve në raport me RVF-BRK ishte nënvlerësuar në vlerë neto prej 1,589,731€. Në disa komuna janë evidentuar nënvlërsime të detyrimeve si në Komunën e Ferizajit 1,711,063€ dhe Suharekës 42,118€ ndërsa mbivlersime në Komunën e Vushtrrisë 113,756€ dhe të Gjilanit në vlerë prej 49,692€

Më tej, sipas RVF-BRK-së detyrimet e nivelit lokal për vitin 2024 ishin rritur për 24,211,529€ krahasuar me ato të vitit 2023.

Rritja më e theksuar e detyrimeve të nivelit lokal është evidentuar në Komunën e Ferizajit me 13,850,652€, apo 57.21% të totalit të rritjes; në Komunën e Vitisë me 3,947,257€, apo 16.3%, në Komunën e Podujevës me 1,985,167€, apo 8.2%; dhe në Komunën e Vushtrrisë me 1,973,401€, apo 8.15%. Rritja e detyrimeve tek këto komuna ishte kryesisht për shkak të kërkesave të dalura nga kontrata kolektive e cila ka rezultuar me mungesë të buxhetit për realizimin e këtyre pagesave.

Raportimet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të saktë dhe jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollet e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të drejte të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandim për Qeverinë

MFPT duhet të vendos kontrolle përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe në rast të devijimeve nga afatet ligjore të ndërmerren masa.

Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, raportohen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Tabela më poshtë paraqet krahasimin e detyrimeve kontingjente sipas auditimit dhe RVF-BRK për tri vitet e fundit.

Tabela 25 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente

Detyrimet kontingjente	Sipas auditimit	Sipas RFV-BRK-së 2024			Krahasimi 2024 - 2023/ në %
	2024	2024	2023	2022	
Niveli qendror	210,663,838	207,469,064	191,725,035	200,739,822	8%
Niveli lokal	179,447,823	186,872,171	147,508,729	137,927,413	27%
Gjithsej	390,111,661	394,341,235	339,233,764	338,667,235	16%

Në RVF-BRK, detyrimet kontingjente janë raportuar gjithsej 394,341,235€, ndërsa sipas auditimit janë 390,111,661€, që paraqet një mbivlerësim në total për 4,229,574€.

Krahasuar me vitin paraprak, detyrimet kontingjente janë rritur për 55,107,471€ apo 16%. Gabimet në raportimin e tyre në PVF individuale dhe mungesa e komunikimit efektiv ndërmjet OB-ve dhe Avokaturës Shtetërore janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë devijim.

Detyrimet kontingjente të nivelit qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente sipas RVF-BRK-së ishte 207,469,064€, ndërsa sipas auditimit 210,663,838€ me një nënvlerësim për 3,194,774€. Në vijim janë prezantuar institucionet të cilat kanë nënvlerësuar/mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 4,193,072€;
- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 933,522€;
- Universiteti i Prishtinës ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,232,818€; dhe
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 403,279€.

Komunikimi jo efektiv në mes zyrtarëve përgjegjës të Ministrive dhe Avokaturës Shtetërore, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta rreth monitorimit mbarëvajtjes së lëndëve në procese gjyqësore ishin arsyet më të shpeshta të mbi apo nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente ndaj komunave janë të natyrës së ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilare e deri tek paditë për shpronësime. Vlera e detyrimeve kontingjente sipas RVF-BRK-së ishte 186,872,171€ ndërsa sipas auditimit ishte 179,447,823€ me një mbivlerësim prej 7,424,348€ (prej tyre: nënvlerësimi ishte 59,622€ kurse mbivlerësimi ishte 7,483,970€).

Në vijim janë prezantuar komunat të cilat i kanë mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Komuna e Prishtinës i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 3,886,576€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një sitemi të mirëfilltë për menaxhimin e lëndëve, të cilat aktualisht mbahen në formë fizike, gjë që ka ndikuar në kontroll të dobët të brendshëm për përditësimin dhe menaxhimin e tyre; dhe
- Komuna e Prizrenit i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 2,324,215€ si pasojë e gabimeve me rastin e regjistrimit të detyrimeve kontigjente dhe mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme për identifikimin e gabimeve para prezantimit të tyre në PFV.

Gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta ishin arsyet më të shpeshta të mbivlerësimt/nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente te niveli lokal.

Mbivlersimi dhe nënvlersimi i detyrimeve të papaguara dhe kontigjente krijojnë një pasqyrë jo të saktë dhe jo të drejtë të gjendjes financiare të institucioneve dhe mund të çojnë në vendime të gabuara buxhetore dhe strategjike, duke rrezikuar besueshmërinë e pasqyrave vjetore financiare. Po ashtu edhe pagesat shtesë për procedurat gjyqësore dhe përmbarimore rrisin kostot e përgjithshme të organizatave buxhetore, duke çuar në shpenzime të panevojshme dhe duke dëmtuar kapacitetin e tyre për të realizuar projekte të planifikuara.

Rekomandim për Qeverinë

Që përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyrat ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta dhe të drejta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korrigjohen.

10. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Mbështetur në LMFPP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi, dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të përmbaruesve privat për vitin 2024 ishin në vlerë 125,415,306€. Në krahasim me të dhënat e vitit 2023, shuma e këtyre pagesave është rritur për 73,479,061€ apo 141%. Trendi i këtyre pagesave (si në tabelë) në raport me vitin e kaluar ka shënuar një rritje, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore ballafaqohen me mungesën e fondeve në kryerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik dhe debitorëve tjerë.


Tabela 26 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore (në €uro)

Pagesat sipas kategorive	2024	2023	2022
Pagat dhe shtesa	41,205,175	18,150,858	16,075,491
Mallrat dhe shërbimet/komunalitë	17,800,080	8,919,733	5,142,784
Subvencione dhe transfere	24,151,834	1,207,926	1,274,649
Investimet kapitale	42,258,217	23,657,727	23,856,425
Total	125,415,306	51,936,244	46,349,349

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbarimore) dhe shpenzimeve të interesit. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ri destinuar për t'u paguar këto detyrime.

Në diagramin e mëposhtëm, janë paraqitur shtatë (7) prej OB-ve te të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha se 5,000,000€. Këto pagesa përbëjnë rreth 51% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore/përmbarimore apo mbi 63,460.022€ si:

Grafikoni 2 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore mbi 5mil€



Nga analiza e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore në SIMFK dhe bazuar në auditimet individuale të OB-ve, është vërejtur se në shumicën e këtyre pagesave, Thesari nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve të borxhit kryesor kundrejt shpenzimeve të procedurave përmbarimore gjyqësore, siç është e paraparë me planin kontabël.

Sipas evidencave tjera të Thesarit në lidhje me ndarjen e këtyre shpenzimeve jashtë SIMFK-së dhe bazuar në këto informata, vërehet se nga totali i pagesave me vendime gjyqësore/përmbarimore, shpenzimet shtesë përtej borxhit kryesor ishin 22,552,982€, apo 18%.

Tabela 27 - Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore sipas nivelit të qeverisjes (në €)

Pagesat sipas Llojit	2024	2023	2022
Niveli qendror	39,075,021	11,734,942	9,887,292
Niveli lokal	86,340,285	40,201,302	36,462,057
Total	125,415,306	51,936,244	46,349,349

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit qendror

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 39,075,021€,[10] apo rreth 32% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin, me humbjen e rastit në arbitrazh ndërkombëtar, pagat jubilare dhe përcjellëse të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave dhe shtesave si dhe pagesat për shpronësime.

10 Vendimi i Qeverisë nr. 17/212 i datese 10.07.2024 Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 21,070,583.27€ (njëzet e një milion e shtatë dhjetëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre euro e njëzet e shtatë centë) për pagesë sipas Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit për rastin ICC Case No.26388 /HBH Contour Global, LLC vs Republic of Kosova

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit lokal

Pagesat në nivelin lokal ishin 86,340,285€ apo rreth 68% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me kompensimin e punëtoreve për paga jubilare, përcjellëse dhe shujtat të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave, vonesa në pagesat e faturave nga ana e OB-ve për dhe mungesës së mjeteve buxhetore.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria, përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive, shpronësimet, vonesat në pagesa dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të sigurojë që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime shtesë nga proceset eventuale gjyqësore.

Rekomandim për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministri, në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.

11. Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, numri i planifikuar i të punësuarve për nivelin qendror dhe lokal ishte 91,046, përderisa numri i të punësuarve sipas RVF-BRK-së ishte 84,679, duke përfshirë këtu edhe numrin e asamblistëve të komunave të cilët paguhen përmes sistemit të pagave dhe nga kategoria paga dhe shtesat. Pra numri i të punësuarve aktual përfshinë të gjithë nëpunësit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me organizatat buxhetore përkatëse dhe janë pjesë e sistemit të menaxhimit të pagave (Payroll).

Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas RVF-BRK-së, numri i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 535 (niveli qendror 380 ndërsa niveli lokal 155). Numri më i lartë i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte në Universitetin e Prishtinës 125[11], Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve 93 (të angazhuar për projektin reforma e sistemit për asistencë sociale) SHSKUK 80, Zyra e Kryeministrit 26, Ministria e Arsimit,

11 Referuar RVF të OB-së për vitin 2024, ky numër pasqyron të angazhuarit me kontrata, në kuadër të OB-ve të cilët financohen nga donatorët ose bashkëfinancohen prej tyre për projekte specifike, përfshirë antarët e bordeve, komisioneve, këshilltarët për regjistrim të popullsisë.

Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit 17, Komuna e Fushë Kosovës 74, Komuna e Rahovecit 28, Komuna e Gllogocit 19, Komuna e Prishtinës 18 etj.

Krahasuar me vitin paraprak numri i të punësuarve të kësaj kategorie ishte rritur për 94.

Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV)

Sipas RVF-BRK, numri i të angazhuarve përmes MSHV-ve ishte 4,749, që krahasuar me vitin paraprak numri i tyre ishte rritur për 3,342.

Sipas raporteve individuale të auditimit për vitin 2024 angazhimi i stafit me MSHV ishte për detyra specifike, por kishte raste edhe për plotësimin e pozitave të rregullta. Po ashtu, kishte raste kur nuk ishin aplikuar procedurat përkatëse për angazhimin e tyre.

Numri më i lartë i të angazhuarve me MSHV në nivelin qendror ishte në ZKM me 3,506 persona. Kjo rritje reflektohet kryesisht te Agjencia e Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë. Po ashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte 287 të angazhuar pasi që kishte organizuar procesin e votimit në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut. Përveç, këtyre Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve vazhdon të ketë numër të lartë të punësuarve me MSHV 152 të punësuar.

Përderisa në nivelin lokal, komunat të cilat kanë numrin më të madhë të angazhuarve me MSHV janë Komuna e Gjilanit me 97 dhe Komuna e Prishtinës me 73 punonjës.

Kapitulli - II

AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË

Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve

ZKA për vitin 2024, ka publikuar 96 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, prej tyre 49 të nivelit qendror, 38 të nivelit lokal si dhe 9 për ndërmarrje publike. Auditimi i këtyre raporteve është kryer në bazë të metodologjisë së auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë në përputhje me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, si dhe konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret për secilën Organizatë Buxhetore (OB).

Nga auditimi i 96 PFV individuale, 42 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar (34 niveli qendror, 7 për komuna si dhe 1 për NP - Telekomi), 50 kanë rezultuar me opinion të kualifikuara (15 niveli qendror, 31 komuna si dhe 4 për NP) si dhe 4 NP kanë opinion të kundërt - Trepça, KRU Hidro-Drini, NP Uniteti – Mitrovicë dhe Termokosi.

Raportimi financiar ka shënuar përkeqësim krahasuar me vitin paraprak. Në nivelin qendror, në vitin 2024 është rritur numri i OB që kanë marrë opinion të kualifikuar për 3, përderisa në nivelin lokal në vitin 2023 janë dhënë 23 opinione të kualifikuara përderisa në vitin 2024 janë 31 komuna që kanë opinion të kualifikuar. Ndërkohë, sa i përket ndërmarrjeve publike, gjendja mbetet pothuajse e njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Përveç opinioneve për PFV, ZKA krahas tyre ka dhënë edhe konkluzion për pajtueshmërinë me autoritetet (ligjet dhe rregulloret), duke vlerësuar nëse transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituara, në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Nga auditimet e kryera, për 33 raporte të auditimit janë dhënë konkluzione të pamodifikuara, (32 nivelin qendror dhe 1 në nivelin lokal), 60 konkluzione të kualifikuara (17 në nivelin qendror, 35 nivelin lokal si dhe 8 për ndërmarrje publike), përveç tyre janë dhënë edhe 3 konkluzione të kundërta (Komuna e Prishtinës, Komuna e Malishevës si dhe NP Trepça).

Konkluzioni i përgjithshëm është se organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike nuk kanë bërë përmirësime në aspektin e raportimit financiar e as në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore.

Përveç opinioneve dhe konkluzioneve të pajtueshmërisë, janë dhënë rekomandime përkatëse për përmirësimin e fushave të identifikuara.

Tabela 28 - Numri i rekomandimeve sipas kategorive për OB-të dhe NP-të për vitin 2024

Nr.	Kategorit ekonomike	Niveli qendror	Niveli lokal	Ndërmarrjet Publike	Totali
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	8	10	17	35
2	Pagat dhe shtesa	26	22	14	62
3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit	37	36		73
4	Çështjet e përbashkëta (MSh dhe IK)	11	24	26	61
5	Investimet kapitale	26	105		131
6	Subvencionet dhe transferet	12	23		35
7	Të hyrat	4	44	11	59
8	Obligimet e papaguara	6	23	17	46
9	Detyrimet kontingjente	17	10	0	27
10	Llogaritë e arkëtueshme	5	48	22	75
11	Pasuritë	43	54	38	135
12	Auditimi i brendshëm	10	14	1	25
13	Sistemet Informative			7	7
	Total	205	413	153	771

Në raportet individuale të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për vitin 2024 kemi dhënë 771 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Nga 771 rekomandime, 205 janë rekomandime të cilat janë dhënë në nivelin qendror, 413 rekomandime në nivelin lokal si dhe 153 rekomandime për ndërmarrjet publike. Kategoritë me nivelin më të lartë të rekomandimeve janë ajo e pasurive, investimeve kapitale, llogarive të arkëtueshme, mallra dhe shërbime dhe komunali si dhe paga dhe shtesa.

Po ashtu, në auditimet e performancës janë dhënë 116 rekomandime dhe në auditimet e pajtueshmërisë 58 rekomandime, të cilat nuk janë të specifikuara sipas kategorive si në tabelën e mësipërme.

Tabela 29 - Numri i rekomandimeve sipas llojit të rekomandimit për vitin 2024

Subjektet e Audituara	Rekomandime të reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Total rekomandime
Niveli Qendror	114	73	18	205
Niveli Lokal	189	204	20	413
Ndërmarrjet Publike	68	77	8	153
Auditimet e Pajtueshmërisë	58	-	-	58
Auditimet e Performancës	116	-	-	116
Totali i Rekomandimeve	545	354	46	945

Nga tabela e mësipërme vërejmë se numri i rekomandimeve të reja është më i lartë se numri i rekomandimeve të përsëritura.

Përveç këtyre, niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm është në nivel të ulët, 42% e rekomandimeve ishte zbatuar në nivel lokal, përderisa në nivel qendror vetëm 36%. Po ashtu, pesë organizata nuk kanë themeluar Komitetin e Auditimit (KA), ndërsa në gjashtë raste, megjithëse KA-të janë themeluar, ato nuk kanë funksionuar gjatë vitit. Këto të dhëna tregojnë për mungesë të vullnetit dhe përkushtimit institucional për forcimin e funksionit të auditimit të brendshëm si një mekanizëm kyç për kontrollin dhe mbikëqyrjen e brendshme.

1. Niveli Qendror

1.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

ZKA-ja për vitin 2024, ka finalizuar 49 raporte të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin qendror, ku përfshihen auditimet për ministritë dhe institucionet e pavarura (përfshirë edhe Radiotelevizionin e Kosovës).

Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për pasqyrat financiare në përputhje me SNISA-t, si dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me pasqyrat financiare vjetore të OB-ve, të nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 30 - Lloji dhe numri i opinioneve për nivelin qendror për vitin 2024

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror[12]	10	11	21
Institucionet e pavarura[13]	24	4	28
Total	34	15	49

Nga 49 raportet e auditimit të organizatave të nivelit qendror (përfshirë edhe institucionet e pavarura), 34 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 15 me opinion të kualifikuar.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit janë si në vijim:

- Mangësi në regjistrimin dhe prezantimin e pasurive në pasqyrat financiare vjetore, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me regjistrime të pasakta apo me mos regjistrim të pasurive dhe pronave në regjistra përkatës të tyre, duke nënvlerësuar apo mbivlerësuar ato. Këto mangësitë dhe devijimet kanë ndodhur kryesisht për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, mungesës së komunikimit ndërmjet njësive përgjegjëse, mungesës së procedurave të qarta dhe mos marrjes së veprimeve konkrete nga menaxhmenti për adresimin e gjetjeve të përsëritura;
- Detyrimet kontigjente nuk ishin prezantuar saktë në pasqyrat vjetore financiare, si rezultat i mbivlerësimit, nënvlerësimit dhe shpalosjeve jo të duhura të tyre. Problemet me detyrimet kontingjente kanë ardhur kryesisht si pasojë e mungesës së koordinimit dhe komunikimit ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj financiare, dobësive në kontrollet e brendshme, mos informimit nga avokatura shtetërore dhe mos përditësimit të të dhënave nga proceset gjyqësore;
- Çështjet që kanë ndikuar të pagat dhe mëditjet lidhen kryesisht me kompensimin e pagave dhe shtesave pa bazë të rregullt ligjore për 101 punonjës të cilët ishin kompensuar 691,050€ pa vijueshmëri në punë (MMPHI për 62 punonjës ka paguar 465,568€, MKK për 19 punonjës ka paguar 112,558€ dhe MPB për 20 punonjës ka paguar 112,942€). Po ashtu, kishte kalkulim të pasaktë të shtesave dhe mungesë të evidencave mbështetëse për praninë në punë. Dukuria e kompensimit të punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë dhe pa aktivitete konkrete vazhdon prej vitesh, si pasojë e mungesës së masave konkrete nga ministritë përkatëse; dhe
- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte si rezultat i kryerjes së pagesave dhe regjistrimit të shpenzimeve nga kategori ekonomike jo adekuate, të ndikuara nga ndarjet e mjeteve me ligj të buxhetit në kategoritë jo adekuate, planifikimit jo të mirë buxhetor dhe pagesat në bazë të vendimeve gjyqësore përmbarimore.

Mangësitë në përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) kanë qenë rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme të brendshme, koordinimit jo të duhur gjatë konsolidimit të të dhënave, gabimeve teknike, si dhe planifikimit jo të mirë ekonomik. Këto çështje kanë ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të plotë të mekanizmave të kontrollit të brendshëm brenda organizatave buxhetore, të cilët nuk kanë qenë në gjendje të parandalojnë devijimet dhe pasaktësitë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

12 Ne institucionet e nivelit qendror janë: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, SHSKUK dhe RTK.

13 Në vitin 2024, për herë të parë është audituar Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

Raportimi financiar në krahasim me vitin paraprak nuk ka ndonjë përmirësim, pasi që vitin e kaluar janë dhënë 12 opinione të kualifikuara për OB-të e nivelit qendror, ndërsa këtë vit janë dhënë 15 opinione të kualifikuara.

1.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me OB-të e nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 31 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin qendror për vitin 2024

Subjektet e audituara	Konkluzion i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror[14]	7	14	21
Institucionet e pavarura	25	3	28
Total	32	17	49

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të konkluzioneve janë si në vijim:

- Mangësitë kryesore te subvencionet dhe transferet ishin vonesat në arsyetimin e subvencioneve, tejkalim i buxhetit të planifikuar, subvencionim i paplanifikuar, mos zbatimi i kritereve për subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), përfitimi i më shumë se një pensioni dhe përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar. Gjithashtu, kishte dobësi në subvencionimin për blerjet e teksteve dhe materialeve mësimore si dhe mangësi në dokumentimin dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara për OJQ-të;
- Te prokurimi dhe menaxhimi i kontratave u identifikuan mangësi dhe vonesa në realizimin e kontratave, shpërblimi i operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm, ndryshime në sasitë e paramasës pa aprovim paraprak, përdorim i procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, si dhe përfshirja e kritereve diskriminuese në dosje të tenderit. Po ashtu, kishte ndërprerje dhe mos funksionalizim i projekteve për shkak të problemeve në planifikim, vonesa në liferimin e mallrave, si dhe vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave;
- Mangësitë e identifikuara te pagat dhe mëditjet ishin mbulimi i pozitave me ushtrues detyre përtej afatit ligjor, ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e përcaktuara, kompensimin përtej afateve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ si dhe mangësi në proces të rekrutimit; dhe
- Çështje tjera me ndikim në konkluzion të auditimit ishin vonesat në pagesën e faturave dhe obligimeve të papaguara, vonesa në shqyrtimin e kërkesave për kthim apo rimbursim tatimor si dhe mangësi në menaxhimin e avanseve për udhëtime zyrtare.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit të plotë të kontrolleve të brendshme të organizatave buxhetore për t'i parandaluar këto gabime. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

14 Ne institucionet e nivelit qendror janë: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, SHSKUK dhe RTK

në fuqi tregon një përkeqësim krahasuar me vitin paraprak, pasi është shënuar një rritje e numrit të konkluzioneve të kualifikuara. Gjatë këtij viti janë dhënë 17 konkluzione të kualifikuara për OB-të të nivelit qendror, krahasuar me 14 sa ishin në vitin e kaluar.

1.3. Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Çështjet më të shpeshta dhe të përsëritura ndër vite në institucionet e nivelit qendror, të ndara sipas kategorive ekonomike dhe duke përjashtuar ato që kanë ndikuar në opinionin e auditimit financiar dhe në konkluzionin për pajtueshmëri, janë paraqitur si më poshtë:

Paga dhe shtesa

Te pagat dhe shtesat janë identifikuar dobësi në proceset e rekrutimit, emërime dhe ushtrime në detyrë në kundërshtim me kërkesat ligjore, tejkalim të afateve ligjore për ushtruesit e detyrës, mungesë të dokumentacionit mbështetës, mos nxjerrje të rregulloreve të brendshme dhe akteve të nevojshme sipas dispozitave ligjore.

Mallra dhe shërbime

Në këtë kategori janë identifikuar një sërë mangësish të rëndësishme, përfshirë angazhimin e konsulentëve për mbulimin e pozitave të rregullta, klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, menaxhim të dobët të barnave dhe kontratave, moszbatim të procedurave të E-prokurimit, mos ndalje të tatimit në burim për shërbimet nga personat jo rezidentë, mungesë të dokumentimit dhe protokollimit të faturave, mungesë sigurie për ekzekutimin e kontratës, planifikim të dobët në pranimin e mallrave, tejkalim të vlerës së kontratave, si dhe vonesa dhe parregullsi në pagesën e faturave.

Investime kapitale

Mangësitë që janë identifikuar në fushën e projekteve kapitale dhe prokurimit lidhen kryesisht me avancet e hapura për projekte, klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, mangësi në menaxhimin e kontratave, pagesa për shpronësime dhe vendime gjyqësore, mungesë të përdorimit të platformës së e-prokurimit, vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve dhe në realizimin e projekteve për shkak të mungesës së planit ekzekutiv, vonesa në realizimin e punimeve si dhe raste të ndërprerjes së kontratave për projekte kapitale.

Subvencione dhe transfere

Mangësitë sa i përket procesit të subvencionimit lidhen kryesisht me formimin e komisioneve vlerësuese dhe të ankesave në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Pasuritë

Te pasuritë kemi evidentuar një numër të konsiderueshëm të mangësive, përfshirë mos-harmonizimin e regjistrave të inventarizimit me regjistrat e pasurive, mungesën e inventarizimit brenda afateve ligjore, regjistra jo të saktë dhe klasifikim të gabuar të pasurive, mos regjistrim të investimeve dhe pasurive jokapitale, nënvlerësim të pasurive në pasqyrat financiare, si dhe mos funksionalitet apo përdorim të pjesshëm të sistemit elektronik E-pasuria për menaxhimin dhe evidentimin e pasurive.

Të hyrat

Në ATK, bazuar në testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, ka rezultuar që në 326 raste, kishte vonesa në shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim apo rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Në raport me vitin e kaluar numri i rasteve të shqyrtuara me vonesë ishte rritur për 241 (në vitin 2023 kishin qenë 85 raste). Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.

Mangësi tjera të identifikuara ishin kryesisht vonesa dhe parregullsi në trajtimin e kërkesave të operatorëve ekonomikë dhe në procedurat e shitjeve me negocim direkt te Fondet në Mirëbesim si dhe mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, përfshirë mosmarrjen e veprimeve për inkasimin e borxheve të vjetra dhe mbivlerësimin e të hyrave nga qiratë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm ka shfaqur mangësi të theksuara për shkak të mosfunksionimit të plotë të Njësive të Auditimit të Brendshëm (NjAB), mosrealizimit të planit vjetor të auditimit, mungesës së shërbimeve të auditimit të brendshëm, si dhe mosfunksionimit apo përbërjes jo të plotë të Komiteteve të Auditimit, duke cenuar ndjeshëm mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes institucionale.

Detyrimet kontigjente dhe ato të papaguara

Lidhur me detyrimet kontingjente dhe obligimet janë evidentuar mangësi të vazhdueshme në prezantimin dhe shpalosjen e tyre në pasqyrat financiare, përfshirë mbivlerësimin dhe paraqitjen jo të saktë të tyre në shënimet shpjeguese, si dhe vonesa në pagesën e obligimeve.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e vonesave në përmbushjen e detyrimeve ligjore, mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe teknike, planifikimit të dobët buxhetor, mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme si dhe moszbatimit të rregulloreve përkatëse.

1.4. Rekomandimet e dhëna

Në kuadër të 49 raporteve individuale të auditimit për institucionet e nivelit qendror për vitin 2024, janë dhënë gjithsej 205 rekomandime, të cilat synojnë përmirësimin e fushave ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Në tabelën më poshtë paraqitet numri i rekomandimeve të dhëna gjatë tre viteve të fundit, me qëllim të krahasimit dhe vlerësimit të progresit në adresimin e tyre.

Tabela 32 - Numri i rekomandimeve për nivelin qendror për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Niveli Qendror	140	127	165
Institucionet e pavarura	65	52	54
Total	205	179	219

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë një rritje të numrit të rekomandimeve në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2024 janë dhënë gjithsej 205 rekomandime (prej tyre 114 të reja, 73 të përsëritura dhe 18 pjesërisht të përsëritura), ndërsa në vitin 2023 ky numër ishte 179. Kjo rritje reflekton mungesën e veprimeve të mjaftueshme nga ana e organizatave të nivelit qendror për adresimin e mangësive të evidentuara, si në fushën e menaxhimit financiar ashtu edhe në atë të pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Institucionet që shënojnë rritje të numrit të rekomandimeve në krahasim me vitin paraprak janë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Universiteti i Prishtinës; Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Zyra e Kryeministrit, si dhe institucione të tjera.

2. Niveli Lokal

2.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

Në vitin 2024, janë publikuar 38 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për nivelin lokal. Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për pasqyrat financiare, në përputhje me SNISA-t, dhe kemi dhënë konkluzione për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret për secilën komunë. Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të e komunave, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 33 - Lloji dhe numri i opinioneve për nivelin lokal për vitin 2024

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinioni i kualifikuar	Gjithsejt
Komunat	7	31	38

Sipas tabelës së mësipërme, nga gjithsej 38 raportet e auditimit për komuna, në 7 prej tyre është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa në 31 raporte është dhënë opinion i kualifikuar. Kjo do të thotë se 81% e komunave kanë marrë opinione të kualifikuara të auditimit. Krahasuar me vitin 2023[15], ku 23 raporte apo 60% ishin me opinione të kualifikuara, viti aktual shënon një rritje negative prej 21% në numrin e opinioneve të kualifikuara të auditimit. Kjo nënkupton se shumica e komunave kanë probleme në prezantimin, raportimin dhe shpalosjen e informacionit të kërkuar në PVF, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e tyre disponojnë pasqyra financiare të sakta dhe në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara.

Arsyet kryesore për kualifikimin e opinioneve të auditimit ishin:

- Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve (i realizuar nga OB), i ndikuar kryesisht nga pagesat e kryera përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve, sidomos për kompensimin e pagave jubilare dhe shujtave, por edhe nga planifikimi jo i duhur i buxhetit lidhur për kategori të caktuara ekonomike;
- Mbivlerësimi i pasurive si rrjedhojë e klasifikimit të pasurive në klasa jo përkatëse në regjistrin kontabël apo regjistrimeve të dyfishta të pasurive. Në anën tjetër, pasuritë ishin nënvlerësuar, si rezultat i mos regjistrimit në regjistrat kontabël të pasurive të blera gjatë vitit, si dhe klasifikimit të pasurive në klasa jo përkatëse në regjistrin kontabël;
- Informata të pasakta për detyrime kontingjente, të cilat rrjedhin nga nënvlerësimi i tyre për shkak të mos evidentimit të plotë në regjistrat përkatës si dhe për shkak se vlerat e regjistruara nuk përputheshin me dokumentacionin mbështetës të vendimeve gjyqësore. Në anën tjetër, ka raste të mbivlerësimit, si pasojë e përfshirjes në regjistër të detyrimeve të cilat kanë përfunduar për shkak të tërheqjes së padive, ose për lëndët ku procedurat gjyqësore janë mbyllur me vendimet përfundimtare;
- Llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për shkak të ngarkesës me tatim të pronave publike si dhe mos azhurnimit të regjistrit të të arkëtueshmeve me pagesat e operatorëve. Nga ana tjetër, llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar si rrjedhojë e mos prezantimit të plotë të borxheve të pa arkëtuara si dhe për shkak të mos përfshirjes në regjistër të të gjitha faturave të lëshuara nga komunat;
- Obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar për shkak të përfshirjes në regjistër të faturave të paguara, si dhe, nga ana tjetër ishin nënvlerësuar për shkak të mos përfshirjes së faturave të pa paguara dhe lëndëve të përmbarimit të cilat ishin obligime financiare; dhe
- Gabime në prezantimin e informatave në pasqyrat financiare vjetore.

Në disa raste, modifikimi i opinionit ka qenë i lidhur me faktorë të jashtëm, të cilët nuk varen nga komunat dhe ku komunat nuk kanë pasur mundësi për të kryer korrigjimet e nevojshme. Raste të tilla kanë qenë keq klasifikimet, që kanë rezultuar nga pagesat e realizuara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore lidhur me pagesën e pagave jubilare, bazuar në kontratën kolektive, për të cilat komunat nuk kishin mundësitë buxhetore për pagesë për shkak të mos ndarjeve buxhetore për këtë qëllim. Në 14 komuna[16] keqklasifikimi i shpenzimeve si rezultat i kontratës kolektive ishte përcaktues në kualifikimin e opinionit financiar.

15 Në vitin 2023, për 38 komunat janë dhënë 15 opinione të pamodifikuara si dhe 23 opinione të kualifikuara

16 Komunat: Gjilanit, Istogut, Pejës, Junikut, Malishevës, Obiliqit, Shtimes, Vitisë, Kaçanikut, Suharekës, Podujevës, Gllogocit, Shtërpcës dhe Gjakovës.

Nga ana tjetër, çështjet e tjera që kanë ndikuar në opinionet e auditimit burojnë nga kontrolle jo të mjaftueshme brenda komunave, sidomos në menaxhimin e përgjegjësive nga ana e zyrtarëve, të cilët nuk kanë realizuar në mënyrë adekuate identifikimin dhe regjistrimin e duhur të llogarive të caktuara për raportim, çka është reflektuar në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV).

2.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Lidhur me çështjet e pajtueshmërisë, ZKA-ja për vitin 2024, ka dhënë 38 konkluzione të pajtueshmërisë për nivelin lokal (komunat). Këto konkluzione të pajtueshmërisë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 34 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin lokal për vitin 2024

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Konkluzioni i kundërt	Gjithsejt
Komunat	1	35	2	38

Bazuar në gjetjet e auditimit, për komunën e Prishtinës dhe të Malishevës është dhënë konkluzion i kundërt për pajtueshmëri. Këto dy komuna nuk i kanë zhvilluar një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të tyre në pajtueshmëri me ligjin. Mangësitë e identifikuara ishin materiale dhe të përhapura në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve.

Arsyet kryesore për konkluzion të kualifikuar ishin:

- Vonesat në pagesën e faturave (detyrimeve) përtej afatit ligjor prej 30 ditësh;
- Mos inspektimi (verifikimi) i pronave në përqindjen 20% të pronave të tatueshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme;
- Në disa raste, komunat kanë përdor fonde nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa marrë aprovimin e Kuvendit Komunal për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër;
- Dobësi në procedurat e prokurimit, duke filluar nga inicimi i prokurimeve në mungesë të projekteve detale (ekzekutive) të ndërtimit, përdorim joadekuat i kontratave publike kornizë, përdorimi i kritereve favorizuese në specifikat e dosjes së tenderit, si dhe mos vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit sipas kohëzgjatjes së kontratës. Po ashtu, dobësi të theksuara janë vërejtur në procesin e vlerësimit të tenderëve, për shkak të përzgjedhjes së operatoreve ekonomik që nuk i plotësonin kriteret e vendosura në dosjen e tenderit;
- Mangësi në procesin e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve si rrjedhojë e dhënies së subvencioneve pa shpallur thirrje publike, subvencionim i përfituesve të cilët nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara me thirrjen publike dhe me rregulloret përkatëse për subvencionim, si dhe mangësi në monitorimin e subvencioneve;
- Realizim i pagesave për punë të papërfunduara dhe realizim i artikujve të kontratës me çmim për njësi, jo në përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit;
- Kontraktimi i projekteve në mungesë të fondeve të mjaftueshme të parapara me buxhet, që për pasojë kanë shkaktuar edhe vonesa në realizim të projekteve përtej afateve të parapara me planet dinamike të tyre; dhe

- Angazhim i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedurat e prokurimit.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si rezultat i funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme në nivelin e komunave, si dhe për shkak të papërgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave nga ana e zyrtarëve përkatës. Gjithashtu, komunat nuk kanë ndërmarrë masa adekuate për të parandaluar dhe adresuar në mënyrë efektive problemet e identifikuara.

Në vijim shpalosim detajet lidhur me dy çështje kyçe: përdorimin e fondeve të dedikuara/planifikuara për projekte specifike për qëllime tjera, si dhe hyrjen në obligime kontraktuale pa siguruar paraprakisht mjetet e nevojshme buxhetore. Të dyja këto raste kanë ndikuar drejtpërdrejt në konkluzionin e kualifikuar të auditimit.

Në gjashtë (6) komuna janë evidentuar 52 pagesa për projekte, me një vlerë të përbashkët 4,657,001€, ku fondet e dedikuara për projekte specifike janë përdorur për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar. Këto veprime ishin kryer pa ndjekur procedurat dhe kriteret e përcaktuara për transferimin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër, dhe pa marrë aprovimin nga kuvendi komunal. Detajet e këtyre rasteve janë si në vijim:

- Komuna e Prishtinës, në 17 pagesa në vlerë 3,400,807€;
- Komuna e Suharekës, në 15 pagesa në vlerë 305,213€;
- Komuna e Podujevës, në 4 pagesa në vlerë 350,562€;
- Komuna e Malishevës, në 11 pagesa në vlerë 466,767€;
- Komuna e Vushtrrisë, në 2 pagesa në vlerë 68,756€; dhe
- Komuna e Vitisë, në 3 pagesa në vlerë 64,896€.

Rastet e tilla të ndryshimeve në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në procesin e vendimmarrjes lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike. Këto po ashtu mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese, duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm për to.

Përveç kësaj, shtatë (7) komuna, kishin hyrë në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontrata për projekte të ndryshme pa siguruar paraprakisht buxhet të mjaftueshëm, në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore. Vlera totale e këtyre obligimeve kontraktuale pa mbulesë ishte 13,225,982€. Kjo praktikë paraqet rrezik të lartë për menaxhimin e qëndrueshëm të financave publike dhe mund të çojë në vonesa në pagesa, rritje të borxheve dhe ndikim negativ në ofrimin e shërbimeve publike. Detajet e këtyre rasteve janë si në vijim:

- Komuna e Podujevës, gjashtë (6) raste në vlerë 4,619,545€;
- Komuna e Malishevës, katër (4) raste në vlerë 1,102,644€;
- Komuna e Prizrenit, tre (3) raste 3,301,660€;
- Komuna e Kaçanikut, tre (3) raste në vlerë 330,688€;
- Komuna e Vitisë, tre (3) raste në vlerë 524,870€;
- Komuna e Prishtinës, dy (2) raste në vlerë 1,898,964€; dhe
- Komuna e Pejës, një (1) rast në vlerë 1,447,611€.

Hyrja në obligime financiare nga ana e komunave pa siguruar paraprakisht fondet e nevojshme ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara apo mundësinë e shpenzimeve të përmbarimit duke dëmtuar buxhetin e vitit aktual dhe duke shkaktuar ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

2.3. Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Përveç çështjeve që e kanë ndikuar opinionin financiar dhe konkluzionin e pajtueshmërisë, ZKA për vitin 2024 në raportet individuale për 38 Komuna ka ngritur edhe çështjet rreth menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Çështjet e identifikuara lidhen me kategori të ndryshme ekonomike dhe janë evidentuar kryesisht në raportet individuale të komunave. Këto çështje pasqyrojnë mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative gjatë menaxhimit të fondeve publike.

Paga dhe shtesat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e pagave dhe shtesave janë:

- Aplikimi i koeficienteve, jo në pajtueshmëri me ligjin për paga;
- Mangësi në procedurat e rekrutimit për shkak të: mos respektimit të kritereve të përcaktuara në shpalljen publike me rastin e pranimit në shërbimin civil, mos përfshirjes së njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në procesin e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik, si dhe për shkak të aplikimit të legjislacionit të shfuqizuar;
- Kontratat e punës/akt emërimet nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë – koeficientit dhe elementet e tjera, sipas ligjeve në fuqi;
- Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë;
- Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore; dhe
- Mos finalizimi i rregullores për Organizmin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Mallra dhe shërbime

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve janë:

- Faturimi i pozicioneve jo konform paramasës dhe parallogarisë së kontratës;
- Vonesa në realizimin e kontratave dhe moszbatimi i ndëshkimeve sipas kushteve kontraktuale;
- Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore për shkak se në kontratat publike kornizë të lidhura me çmimin për njësi, ishte përfshirë devijimin +-30%, që është në kundërshtim me kërkesat e rregullores së prokurimit publik;

- Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme;
- Kompensimet nga mallrat dhe shërbimet për zyrtarët e komunës në kundërshtim me Rregulloren për kompensim për funksion shtesë; dhe
- Menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk ishte bërë përmes sistemit elektronik të e-prokurimit;

Investime Kapitale

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë:

- Pranimi i mallrave dhe furnizimeve tjera kapitale nga menaxheret e kontratave dhe jo nga komisionet e pranimit, siç kërkohet me rregullat ligjore;
- Kontraktimi dhe pagesa në formë të paradhënies në kundërshtim me Ligjin e prokurimit dhe Ligjin e buxhetit;
- Ndryshime të sasive të realizuara në disa pozicione të kontratave për punë, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, e në disa raste pa aprovime paraprake nga menaxhmenti. Për këto ndryshime, nuk kishte amandamentim të kontratës;
- Realizim i pagesave për projekte kapitale për të cilat kishte skaduar afati i kontratës;
- Përdorimi i shpeshtë i aneks kontratave si rezultat i hartimit të dobët të projekteve bazike;
- Mosrespektimi i afatit ligjor për pranimin e tenderëve me rastin e zhvillimit të procedurave të prokurimit, pa ndonjë arsye të bazuar;
- Fillimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave, pa pasur lejet ndërtimore;
- Vonesa në kryerjen e punimeve, ku punët nuk ishin kryer sipas planit dinamik të paraparë me kontratë; si dhe
- Menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve, nuk është bërë përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi);

Subvencione dhe transfere

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve janë:

- Shpërndarja e subvencioneve pa u bazuar në ndonjë rregullore specifike për subvencione;
- Disa komuna nuk kishin përgatitur planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve për vitin 2024 ashtu siç parashihet me kërkesa ligjore; dhe
- Dobësi të tjera në menaxhimin e subvencioneve që lidhen me raportimin e përfituesve dhe monitorimin e implementimit të projekteve të subvencionuara.

Të hyrat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e të hyrave janë:

- Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore si dhe dhënia e tyre në mungesë të komisionit për shqyrtimin e raporteve për leje mjedisore komunale;
- Raportim jo i rregullt për shfrytëzim të pronave komunal nga ana e Kryetarëve të Komunave;
- Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara;
- Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë për shkak të mungesës së të dhënave në lidhje me numrin personal të tatimpaguesve dhe mangësive në përfitimin e zbritjes për vendbanim parësor;
- Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale jo në pajtim me tarifat e Rregullores komunale dhe aplikim jo i drejtë i taksave komunale; dhe
- Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë me rastin e aplikimit të zbritjeve të tatimit në pronë.

Përveç çështjeve të paraqitura më lartë, është e rëndësishme të theksohet edhe trendi në rritje i llogarive të arkëtueshme nga viti në vit, si dhe mangësitë në menaxhimin e pasurive, përfshirë mosmbylljen e investimeve në vijim, mos përdorimin e sistemit e-pasuria dhe mangësitë në proceset e inventarizimit të pasurive. Po ashtu, mangësi janë konstatuar edhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit, të cilat lidhen me mos themelimet e këtyre organeve në disa komuna dhe mos funksionimin e tyre në disa të tjera.

2.4. Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të komunave për vitin 2024 janë dhënë gjithsej 413 rekomandime për përmirësimin e fushave ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet për komunat gjatë tri viteve të fundit. Këto rekomandime përfaqësojnë çështje dhe mangësi të identifikuara në menaxhimin e financave publike, aspektit financiar, pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret, proceset e prokurimit, transparencën, llogaridhënien si dhe fusha të tjera të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Tabela 35 - Numri i rekomandimeve për nivelin lokal për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Komunat	413	369	352

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se numri i rekomandimeve për komunat ka shënuar rritje të vazhdueshme përgjatë këtyre tri viteve. Kjo rritje nga viti në vit nuk reflekton përmirësim në qeverisje lokale, por përkundrazi tregon përkeqësim të situatës në shumë komuna.

Ky rezultat kërkon një angazhim më të madh të komunave në zbatimin e rekomandimeve, si dhe për forcim të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar për të shmangur përsëritjen dobësive.

3. Ndërmarrjet Publike

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024 për nëntë (9) Ndërmarrje Publike (NP). Prej tyre, shtatë (7) janë ndërmarrje publike qendrore, dhe dy (2) ndërmarrje publike lokale. Ndërmarrjet publike qendrore të audituara janë: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, (KEK), Trepça sh.a, KOSTT sh.a, NPH Ibër-Lepenci sh.a, Telekomi i Kosovës sh.a, KRU Prishtina sh.a, KRU Hidrodrini sh.a. Ndërsa ndërmarrjet publike lokale të audituara janë: KRM Uniteti sh.a Mitrovicë dhe Termokosi sha Prishtinë.

Përzgjedhja e këtyre ndërmarrjeve për auditim është bërë mbi bazën e disa kritereve kyçe, përfshirë madhësinë e buxhetit apo të hyrave, numri i punëtorëve, kompleksitetin e shërbimeve që ofrojnë, gjendjen financiare dhe interesin publik.

Edhe pse në disa ndërmarrje janë vërejtur përmirësime, auditimit ka nxjerrë në pah se menaxhimi financiar dhe funksionimi i kontrolleve të brendshme mbeten fusha që kërkojnë përmirësime të mëtejshme. Nga auditimi i tyre ka rezultuar se për katër (4) ndërmarrje është dhënë opinion i kundërt, katër (4) opinion i kualifikuar si dhe vetëm një ndërmarrje ka opinion të pamodifikuar (Telekomi) si dhe tetë (8) konkluzione të pajtueshmërisë të kualifikuara dhe një (1) konkluzion të kundërt (Trepça). Opinionet dhe konkluzionet e modifikuara, pasqyrojnë cilësinë jo të kënaqshme të të dhënave financiare, mospërputhjet me kornizën ligjore dhe mangësi në raportim. Kjo tregon nevojën e domosdoshme për përmirësime të vazhdueshme në të gjitha fushat ku janë identifikuar mangësi, në mënyrë që të rritet besueshmëria, transparenca dhe llogaridhënia në menaxhimin e ndërmarrjeve publike.

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të ndërmarrjeve publike, ZKA ka dhënë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve, të cilat janë përfshirë në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat përgjegjës për qeverisje të NP-ve, si dhe tek aksionarët e tyre.

Përveç kësaj, Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike mbikëqyrë aktivitetet operative dhe raportimin financiar të këtyre ndërmarrjeve, duke informuar në mënyrë të rregullt Qeverinë për gjendjen dhe zhvillimet në to.

Një analizë më e detajuar mbi performancën e këtyre ndërmarrjeve publike dhe cilësinë e raportimit financiar paraqitet në nën kapitujt vijues të këtij raporti.

3.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

Opinionet e auditimit në lidhje me PVF-të e ndërmarrjeve publike, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 36 - Lloji dhe numri i opinioneve për ndërmarrjet publike për vitin 2024

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinioni i kualifikuar	Opinion i kundërt	Gjithsejt
Ndërmarrjet publike	1	4	4	9

Nga shtatë (7) NP në nivel qendror të audituara, katër (4) kanë opinione të kualifikuara, dy (2) kanë opinione të kundërta dhe një (1) opinion të pamodifikuar, ndërsa të dy (2) NP në nivel lokal të audituara, kanë opinione të kundërta. Krahasuar me vitin 2023, nuk ka pasur ndryshime sa i përket opinioneve të auditimit në lidhje me Pasqyrat Financiare Vjetore.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të opinionit kanë të bëjnë me:

- **Pasuritë -** mungesa e dokumentacionit të pronësisë/dëshmive mbështetëse, mospërputhje ndërmjet regjistrave kontabël dhe gjendjes fizike, mos rivlerësimi i pasurive, trajtimi jo i duhur i investimeve në vijim, prezantimi jo i saktë i rezervës së rivlerësimit, zhvlerësim i pasaktë dhe mungesë e një politike për trajtimin e pasurive;
- **Stoqet -** mungesa e harmonizimit të regjistrave të stoqeve me inventarizimin fizik;
- **Llogaritë e arkëtueshme -** mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare dhe mos harmonizimi në mes të shënimeve kontabël të llogarive të arkëtueshme, përfshirja e pasaktë e parapagimeve të klientëve në analitiken e llogarive të arkëtueshme;
- **Llogaritë e pagueshme -** mos prezantimi i saktë i llogarive të pagueshme, mos harmonizimi në mes të shënimeve kontabël të llogarive të pagueshme dhe dëshmive mbështetëse;
- **Obligimet e pagueshme tatimore dhe të papaguara -** mos përputhja e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël me gjendjen e obligimeve në ATK dhe mos prezantim i saktë i obligimeve; dhe
- **Çështjet tjerë që kanë ndikuar në opinione të auditimit -** mospërputhje ndërmjet PVF-ve dhe shënimeve kontabël (të hyrat e shtyra), mos prezantimi i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë gatshme dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, pasaktësi në trajtimin e parapagimeve, prezantim jo i plotë dhe i saktë i shënimeve shpjeguese, mungesa e dëshmive për grantet.

Mangësitë e identifikuara në pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike kanë rezultuar kryesisht si pasojë e mosveprimit të menaxhmentit, i cili në disa raste i ka konsideruar rekomandimet si të vështira për t'u zbatuar për shkak të rrethanave specifike. Dobësitë kryesore lidhen me regjistrimin, mos-përditësimin dhe zhvlerësimin e pasurive, të cilat kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme, mungesës së dokumentacionit burimor, mos qarkullimit të duhur të informacionit ndërmjet departamenteve, si dhe mungesës së politikave të brendshme për menaxhimin e pasurive dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore. Për më tepër, mosrespektimi i standardeve përkatëse dhe mungesa e vëmendjes ndaj raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme, përfshirë edhe moskryerjen e inventarizimeve dhe harmonizimit me evidencat kontabël, ka rezultuar në pasaktësi dhe mangësi të rëndësishme.

Në anën tjetër, mungesa e një databaze për pasuritë e financuara nga grantet ka pamundësuar regjistrimin dhe paraqitjen e tyre të saktë në pasqyrat financiare. Përgatitja e pasqyrave financiare është ndikuar negativisht edhe nga mungesa e kontrolleve gjatë përgatitjes së tyre, përdorimi i informacioneve jashtë sistemit financiar-kontabël dhe mungesa e mbështetjes së dokumentacionit të nevojshëm. Procesi kryesisht manual i kontabilitetit, si dhe mbështetja në të dhëna jo të verifikuara plotësisht në shënimet shpjeguese, kanë çuar në mosbarazime ndërmjet librit kryesor dhe ditarit, duke përkeqësuar kështu saktësinë e regjistrimeve financiare dhe duke ndikuar negativisht në besueshmërinë e raportimit financiar të ndërmarrjeve publike.

3.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Përveç aspektit të përgatitjet së pasqyrave financiare, kemi audituar edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit dhe kemi dhënë edhe konkluzione të pajtueshmërisë për të gjitha NP-të e audituara.

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me NP-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 37 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për ndërmarrjet publike për vitin 2024

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Konkluzioni i kundërt	Gjithsejt
Ndërmarrjet publike		8	1	9

Sipas tabelës, ndërmarrjet publike të audituara kanë konkluzione të kualifikuara, që tregon se ato kanë probleme të pajtueshmërisë me autoritetet dhe se transaksionet financiare nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Krahasuar me vitin e kaluar, shumica e ndërmarrjeve publike në vitin 2024 kanë mbetur në të njëjtin nivel të performances, pa treguar përparim. Ndërkaq, Trepça sh.a për të dytin vit me radhë vazhdon të ketë konkluzion të kundërt, duke reflektuar mungesën e adresimit të rekomandimeve të mëparshme të auditimit.

Kjo tregon se shumica e ndërmarrjeve publike vazhdojnë të kenë mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore, të cilat lidhen kryesisht me shpenzimet operative, shpenzimet për paga, menaxhimin e të hyrave dhe përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare. Përmirësimi në këto fusha është i domosdoshëm për të siguruar menaxhim më të mirë financiar dhe përmbushje të detyrimeve ligjore.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të konkluzionit të pajtueshmërisë janë:

- Menaxhimi i prokurimit/shpenzimet operative - mangësitë në procesin e prokurimit dhe menaxhimin e kontratave janë të pranishme në shumë ndërmarrje publike, duke përfshirë realizimin e shpenzimeve pa marrëveshje kontraktuale, mangësi në realizimin e procesit të prokurimit, si dhe përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit. Për më tepër, vërehen dobësi në vlerësimin e tenderëve, dhe mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për menaxhimin dhe vlerësimin e kontratave;
- Shpenzimet e pagave - mangësi në ristrukturim të ndërmarrjes, mos pagesa e kontributeve pensionale dhe tatimit në pagë për punonjësit, mangësi në procese të rekrutimit përmes konkursit të jashtëm, dobësi në sistematizimin e vendeve të punës;

- Të hyrat - mungesa e kontratave në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve si dhe regjistri i konsumatorëve të ndërmarrjes jo në përputhje me rregullat e Autoritetit Rregullativ të Ujësjellësit; dhe
- Çështjet tjera me ndikim në konkluzion - vonesa në aprovimin e pasqyrave financiare dhe mos funksionim të njësive të Trepça sh.a sipas kërkesave të plota ligjore. Po ashtu, edhe nënshkrimi i kontratave për auditimin e pasqyrave financiare vjetore nga kompanitë private.

Këto mangësi burojnë kryesisht nga moszbatimi i kërkesave ligjore dhe procedurave të brendshme nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjeve publike, si dhe nga dobësitë në planifikimin dhe kontrollin e brendshëm. Ato janë pasojë e mos përmbylljes së procesit të ristrukturimit dhe moszbatimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme në ndërmarrjet publike. Për më tepër, këto mangësi kanë ndodhur si rezultat i veprimeve të pamjaftueshme të menaxhmentit, ndryshimeve në përbërjen e tij gjatë përpilimit të pasqyrave financiare vjetore, mungesës së mbikëqyrjes efektive nga Bordi Mbikëqyrës dhe mosaplikimit të duhur të kërkesave ligjore.

3.3. Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar

Gjatë këtij sezoni audites kemi konstatuar se vetëm ndërmarrja publike Trepça nuk i kishte përgatitur dhe finalizuar me kohë Pasqyrat Vjetore Financiare. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare për vitin 2024, ishin finalizuar me datën 13 maj 2025, jashtë afateve të parashikuara.

Vonesat në përgatitjen dhe finalizimin e PVF-ve kishin ndodhur kryesisht nga dorëheqja dhe largimi nga puna e zyrtarit kryesor financiar i ndërmarrjes. Për më tepër, vështirësitë në marrjen e shënimeve nga njësitë biznesore të ndërmarrjes kanë ndikuar në vonesën e përfundimit të procesit të përgatitjes së PVF-ve.

Këtë çështje e kemi adresuar në raportin individual dhe shpresojmë që në vitet në vijim raportimi të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar.

Vlen të theksohet se ZKA kishte njoftuar me kohë se do të kryente auditimin e PVF-ve për vitin 2024, ndërkohë, ndërmarrjet publike KEK dhe KOSTT kishin kryer auditimin e PVF-ve për vitin 2024 edhe nga kompanitë private të auditimit.

Analiza e gjendjes financiare e ndërmarrjeve publike

Ndonëse gjendja financiare e ndërmarrjeve publike më hollësisht mund të kuptohet nga pasqyrat e bashkëngjitura në raportet individuale, në këtë kapitull në mënyrë përmbledhëse janë paraqitur treguesit kryesor të performancës financiare dhe gjendjes së tyre të fund vitit 2024. Për qëllime analize, janë marrë në shqyrtim të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtra dhe detyrimet afatgjata.

Tabela 38 - Treguesit kryesor financiar të ndërmarrjeve publike të audituara për vitin 2024

Nr.	Subjektet e audituara	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi/ Humbja	Detyrimet afatshkurtra	Detyrimet afatgjata
1	KEK "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a.	218,591,000	179,467,000	39,124,000	32,813,000	164,486,000
2	Trepça sh. a.	27,590,971	29,898,058	-2,307,087	34,293,454	2,943,690
3	Telekomi i Kosovës, sh. a.	59,296,000	52,411,000	6,885,000	46,884,000	38,100,000
4	Ndërmarrja Publike "KOSTT"	82,400,000	64,212,000	18,188,000	58,015,000	60,228,000
5	KRU "Hidrodrini"	5,845,326	5,601,986	243,340	2,773,723	31,046,018
6	NPH "Ibër - Lepenc" sh. a. – Prishtinë	11,345,946	9,838,503	1,507,443	3,435,099	10,428,911
7	KRU "Prishtina" sh. a. - Prishtinë	19,188,312	16,860,123	2,328,189	5,495,782	33,037,936
8	NP "Termokos", sh. a. - Prishtinë	14,880,021	12,408,992	2,471,029	3,282,692	34,168,923
9	KRM " Uniteti" sh. a. - Mitrovicë	2,320,461	2,280,096	40,365	3,981,119	454,679
	Totali	441,458,037	372,977,758	70,787,366[17]	190,973,869	374,894,157

Rezultati financiar (fitimi/humbja) - Nga tabela më sipër shihet se nga nëntë (9) ndërmarrje publike të audituara, tetë (8) prej tyre kanë operuar me një total të fitimeve prej 70.7mil.€ ndërsa humbje kishte vetëm NP Trepça sh.a prej 2.3mil.€.

Pjesën më të madhe të fitimit e kishin dy NP të nivelit qendror: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në shumën prej 39.1mil.€ apo 55% të totalit të fitimeve dhe Kompania Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në shumën prej 18.1mil.€ apo 26% të totalit të fitimeve. Vlen të theksohet se në raport me vitin paraprak ndërmarrja KEK kishte fitim dukshëm më të lartë, ndër shkaqet kryesore të rritjes së të hyrave ishte rimbursimi gjatë vitit 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës. Përderisa, KOSTT nga janari 2024 sipas vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ishte liruar nga obligimi i mbulimit të humbjeve të energjisë për pjesën veriore, kjo kishte ndikuar në uljen e shpenzimeve të KOSTT-it respektivisht rritjen e fitimit të vitit.

Detyrimet afatshkurtra/qarkulluese - janë obligime financiare që duhet të shlyhen brenda një viti fiskal. Ato përfshijnë: llogaritë e pagueshme, tatimet e pagueshme, kreditë afatshkurtër, dhe detyrimet tjera me afat pagese brenda një viti.

Për nëntë (9) ndërmarrjet, detyrimet afatshkurtra ishin në shumën prej 190mil.€, ku 90% prej tyre e përbëjnë katër (4) ndërmarrjet publike të nivelit qendror: KOSTT me 58mil.€ apo rreth 30%, Telekomi

17 Në këtë total janë përfshirë vetëm vlerat e NP-ve me fitim, përjashtuar vlerën e humbjes prej 2,3 mil. të Trepça Sha.

i Kosovës me 46.8mil.€ apo rreth 25%, Trepça me 34mil.€ apo rreth 18%, dhe Korporata Energjetike e Kosovës me 32.8mil.€ apo 17%. Ndërsa pjesën e mbetur prej 18.9mil.€ apo 10% e përbëjnë detyrimet afatshkurtra të 5 ndërmarrjeve tjera.

Detyrimet afatgjata - janë obligime financiare ose detyrime jo qarkulluese të cilat listohen në bilancin e gjendjes si obligime që afatin e pagesës e kanë më të gjatë se një vit. Këtu bëjnë pjesë kreditë për mjete themelore, detyrimet ndaj letrave me vlerë, dhe detyrimet tjera që duhet të paguhen në afat më të gjatë se një vit.

Detyrimet afatgjata për nëntë (9) ndërmarrjet në fund vitin 2024 ishin afër 374mil.€, apo rreth 96% më të larta se detyrimet afatshkurtra. Meqenëse pasqyra e shpalosjeve përmban shumë mangësi të informatave, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna analitike se brenda sa vitesh duhet të kthehen këto detyrime.

Pra, në bazë të analizave të mësipërme edhe pse të gjitha ndërmarrjet e audituara (me përjashtim të NP Trepça) kanë rezultat pozitiv për vitin 2024, gjendja e tyre financiare është e vështirë për shkak të shumave të larta të detyrimeve të pa paguara.

Gjithsej detyrimet e pa paguara të këtyre ndërmarrjeve janë rreth 565mil.€, prej të cilave detyrime afatshkurtra që duhet të paguhen brenda një viti janë rreth 190mil.€ dhe detyrime afatgjata rreth 374mil.€.

Marrë parasysh faktin se të hyrat totale ishin rreth 441mil.€, pagesa eventuale e këtyre detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata duket mjaft e vështirë. Kur kësaj i shtohen edhe detyrimet tjera potenciale që krijohen gjatë vitit vijues gjendja mund të bëhet edhe më e vështirë sa i përket detyrimeve.

3.4. Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Përveç çështjeve që e kanë ndikuar opinionin financiar dhe konkluzionin e pajtueshmërisë, ZKA për vitin 2024 në raportet individuale për ndërmarrjet publike të audituara, ka ngritur edhe çështjet rreth menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Çështjet e identifikuara lidhen me kategori të ndryshme ekonomike dhe janë evidentuar kryesisht në raportet individuale të NP-ve. Këto çështje pasqyrojnë mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative gjatë menaxhimit të fondeve publike.

Mallra dhe shërbime

Në fushën e menaxhimit të prokurimit janë çështjet si: përdorimi i shpeshtë i procedurës me vlerë minimale, vendosja e kritereve në dosje të tenderit jo në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik. Këto mangësi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së koordinimit dhe planifikimit të nevojave nga njësitë kërkuese, si dhe për shkak të mungesës së vëmendjes gjatë vendosjes së kritereve në dosjet e tenderëve.

Paga dhe shtesa

Në fushën shpenzimeve të pagave janë evidentuar çështjet si: pagesa e punonjësve me gradë të ndryshme për pozitën e njëjtë, dobësi gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave të tatimeve dhe kontributeve. Këto mangësi ishin si rezultat i mos zbatimit të plotë të planit të veprimit, përkundër zotimit të ndërmarrjes se çështja do të adresohej dhe për shkak të gabimit teknik të softuerit, të cilat nuk janë vërejtur nga punonjësit.

Llogaritë e arkëtueshme

Te llogaritë e arkëtueshme janë evidentuar çështjet si: mungesa e dëshmive mbështetëse për llogaritë e arkëtueshme, diferencë në mes sistemit të kontabilitetit dhe sistemit të faturimit. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të mos harmonizimit të llogarive të arkëtueshme me dëshmitë mbështetëse dhe për shkak të bartjeve të faturimit mujor në mënyrë manuale nga sistemi i faturimit në sistemin e kontabilitetit, dhe korrigjimet eventuale në njërin nga sistemet nuk janë reflektuar paralelisht në këto dy sisteme.

Në fushën e stoqeve janë evidentuar çështjet si: mos provizionimi i stoqeve dhe prezantim jo i saktë i tyre në PFV.

Detyrimet afatshkurtra

Në fushën e detyrimeve afatshkurta janë evidentuar çështjet si: mospërputhje e regjistrimeve kontabël me dëshmitë burimore, mos prezantim i saktë i obligimeve në regjistrin e kompanisë, si dhe mungesa e identifikimit të pagesave nga konsumatorët të paidentifikuar. Mangësitë e tilla ishin si rezultat i vështirësive të vazhdueshme në identifikimin e konsumatorëve, të cilat janë bartur ndër vite pa u adresuar në mënyrë adekuate, si dhe mos realizimit të korrigjimeve të nevojshme nga furnitorët, pavarësisht kërkesave zyrtare të ndërmarrjes.

Mangësitë e tilla ishin rezultat i mungesës së ndërlidhjes me sistemet shtetërore, mungesës së udhëzuesve standard për menaxhimin e qasjeve, mos rishikimit periodik të të drejtave të përdoruesve, mos definimit të periudhës për ruajtjen e log file-ve, për shkak të kompleksitetit teknik në implementimin e kodit shtetëror dhe mungesës së dokumenteve standarde planifikuese për zgjerimin e rrjetit.

3.5. Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të nëntë (9) NP-ve për vitin 2024, kemi dhënë 153 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela 39- Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të NP-ve në 2024

Ndërmarrjet publike të:	Rekomandime të reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Total rekomandime
Nivel Qendror	45	58	6	109
Nivel Lokal	23	19	2	44
Total	68	77	8	153

Nga gjithsej 153 rekomandimet e dhëna, 68 janë rekomandime të reja, 77 të përsëritura dhe 8 pjesërisht të përsëritura. Kjo tregon se 45% e rekomandimeve janë të reja, 50% janë të përsëritura nga viti i kaluar ndërsa 5% janë pjesërisht të përsëritura.

Rekomandime për Qeverinë dhe Komisionet përkatëse të Aksionareve

- **Ti forcojnë masat llogaridhënëse ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit të Ndërmarrjeve Publike, të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike me qëllim të eliminimet të gabimeve që kanë ndikuar në opinionet dhe konkluzionet e modifikuara. Po ashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF të vitit 2025 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; dhe**

- **Në rastet e angazhimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditim të pasqyrave vjetore financiare, të shmangen kontraktimet e shërbimeve të auditimit të PVF-ve me kompanitë private të auditimit.**

4. Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) përbën një funksion thelbësor për garantimin e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, duke i ofruar menaxhmentit të lartë siguri se këto mekanizma janë të dizajnuar dhe funksionojnë siç duhet. Ky funksion kontribuon në arritjen e objektivave organizative përmes një qasjeje të strukturuar dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të menaxhimit të rrezikut, sistemeve të kontrollit dhe qeverisjes.

Komiteti i Auditimit (KA) shërben si trup këshillues për menaxhmentin e lartë të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP), duke ofruar mbështetje për auditorët e brendshëm, ruajtur pavarësinë e tyre, vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve dhe ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm.

Në kuadër të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, është paraparë avancimi i mëtejshëm i funksionit të AB-së përmes zbatimit të programeve për zhvillim profesional, sigurimit të cilësisë dhe përditësimit të kuadrit ligjor. Ky proces koordinohet nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NjQHAB), e cila mbikëqyr dhe monitoron funksionimin e auditimit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm financiar në të gjitha subjektet publike.

Në sistemin e auditimit të brendshëm kemi vërejtur këto mangësi kryesore:

- Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, përcakton kriteret që duhet të plotësojnë Organizatat Buxhetore (OB), për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), si dhe numrin minimal të auditorëve që duhet të kenë OB-të, bazuar në buxhetin e tyre. Nga gjithsej 86 organizata buxhetore, 60 prej tyre plotësojnë kriteret për themelimin e NjAB-së. Megjithatë, gjashtë (6) prej tyre (Komuna e Leposaviqit, e Zveçanit, Zubin Potokut, Mitrovicës Veriore, Kamnica dhe Hani i Elezit) nuk e kanë themeluar NjAB-në, edhe pse plotësojnë kriteret. Ndërsa, nga 60[18] institucionet në të cilat është themeluar NjAB, në 35 prej tyre numri i auditorëve ishte më i ulët sesa që parashihet në kërkesat e rregullores;
- Bazuar në auditimet tona, menaxhmenti i OB-ve nuk ka marrë veprime të mjaftueshme për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm duke i zbatuar vetëm 38% të rekomandimeve të dhëna. Në nivel lokal, 42% e rekomandimeve janë zbatuar, rekomandimet tjera janë në proces ose të pazbatuara, përderisa në nivel qendror zbatimi i rekomandimeve ishte edhe më i ulët me vetëm 36%. Ndërsa niveli i auditimeve të realizuara në raport me ato të planifikuara ishte 98%;
- Nga 60 OB, të cilat kanë të themeluar NjAB-në, pesë (5) prej tyre nuk kanë themeluar KA, si: MAPL, Junik, Novobërdë, Kllokot dhe Fushë Kosovë. Në MINT, MMPHI, MASHTI, KPK, KQZ, dhe Malisheva, Komitetet e Auditimit përkundër që ishin të themeluara, nuk kanë funksionuar gjatë vitit; dhe

18 Numri prej 60 përbëhet nga 54 OB të cilat i plotësojnë kriteret për themelimin e NJAB si dhe 6 OB të cilat kanë themeluar NJAB edhe pse nuk janë të obliguara për themelimin e kësaj njësie

- Në 12 OB[19], Komiteti i Auditimit ka mbajtur më pak se katër takime siç kërkohet në UA 01/2019, ndërsa në nëntë (9) OB[20], Komitetet e Auditimit nuk kanë dorëzuar raportin vjetor sipas nenit 10 të UA 01/2019.

Auditimet kanë nxjerrë në pah se mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme është një problem i përhapur në disa OB. Kjo vjen si rezultat që shpeshherë, mungon dokumentimi i duhur për procedurat e kontrollit, gjë që ndikon në moszbatimin e vazhdueshëm dhe efektiv të kontrolleve. Mungesa e resurseve të nevojshme është një tjetër shkak që ndikon në mosfunksionimin e kontrolleve. Procedurat për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve shpesh herë nëpër OB, nuk janë të dokumentuara mirë, duke shpie në mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe menaxhim të dobët të rreziqeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, për të përmbushur objektivat në tërësi për të siguruar menaxhmentin se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive dhe në parandalimin e gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandime për Qeverinë

- **Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe**

- **Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së. Po ashtu, të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.**

19 MINT, MFPT, ME, MD, MZHR, UP, Gjykata Kushtetuese, Obiliqi, Graqanica, Malisheva,Istogu dhe Kaçaniku
20 MASHT, MINT,MPB,MD,MZHR, AKKVP, Obiliqi, Malishevë, dhe Itogu

Kapitulli - III

AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PAJTUESHMËRISË

1. Auditimet e Performances, TI-së dhe Pajtueshmerisë

Zyra Kombëtare e Auditimit, vazhdon me fokus të veçantë ndaj auditimeve të performancës, si faktor i rëndësishëm në ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Auditimet e performancës vlerësojnë se sa fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Përmes rezultateve të auditimit, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e fondeve publike.

Po ashtu, ZKA ka rritur fokusin edhe për auditimet e pajtueshmërisë me qëllim të vlerësimit nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Për sezonin auditues 2024-2025 janë mbuluar fusha më të rëndësishme për qytetarët duke marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030.

Gjatë sezonit raportues, janë kryer 12 raporte të auditimit të performancës përfshirë teknologjinë e informacionit, ku gjithsej janë dhënë 116 rekomandime. Në vijim, janë paraqitur raportet, temat dhe përmbajtja e tyre.

Shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida si në efikasitet ashtu edhe në efektivitet. Institucionet parashkollore shpesh funksionojnë pa licencë dhe pa mbikëqyrje të rregullt, ndërsa ligji i ri nuk po zbatohet për shkak të mungesës së udhëzimeve. Në nivel lokal mungojnë planet zhvillimore dhe qasja gjithëpërfshirëse në shërbime.

Sistemi aktual për mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i koordinuar mirë, dhe paraqet dobësi të theksuara në secilën hallkë të tij. Procedurat për ankesa janë të paqarta, inspektimet nuk bazohen në rrezik, dhe fushatat informuese janë të kufizuara.

Shqetësimet e mëtejshme përfshijnë llogaridhënien dhe transparencën. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerësoi zbatimin e 199 rekomandimeve nga 10 auditime të performancës të publikuara në vitin 2019, që përfshinin 36 subjekte. Nga 199 rekomandime vetëm 25% janë zbatuar. Mungojnë planet e veprimit dhe bashkëpunimi institucional.

Projektet e infrastruktura publike shpesh nisin pa planifikim të mirëfilltë, pa analiza të mjaftueshme të kostove dhe përfitimeve dhe me financim të pamjaftueshëm në raport me vlerën e kontratës. Mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, vlerësimet e dobëta dhe kapacitetet e kufizuara profesionale çojnë në ndryshime të shumta në kontrata që për pasojë rezultojnë me punë shtesë dhe rritje të konsiderueshme të kostove. Po ashtu, menaxhimi joefikas i kontratave dhe mungesa e mbikëqyrjes efektive ndikojnë negativisht në zbatimin e projekteve të infrastrukturës publike. Këta faktorë bëhen shkak për tejkalim të afateve dhe vonojnë arritjen e rezultateve të synuara.

Në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social auditimet tregojnë se sektori i pylltarisë ka mungesë të kontrollit dhe të dhënave. Qeverisja në zhvillimin urban është e dobët për shkak të mungesës së inspektimeve dhe zbatimit të rregullave ndërtimore.

Rritja e shpejtë e popullsisë në zonat urbane dhe intensiteti i lartë i ndërtimeve kanë nxjerrë në pah dobësitë e qeverisjes lokale në menaxhimin e proceseve. Komuna, si institucioni përgjegjës për planifikimin dhe kontrollin ndërtimor, nuk ka siguruar procedura të qarta, shpërndarje të barabartë të detyrave dhe mekanizma efektivë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e objekteve të banimit kolektiv.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë përbëjnë një mundësi të rëndësishme për zhvillimin social dhe ekonomik, duke kontribuar në sigurinë energjetike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, menaxhimi dhe mbikëqyrja janë të dobëta. Prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme nuk arrijnë të parashikojnë saktë sasinë e energjisë që prodhojnë, duke rezultuar shpeshherë në prodhim më të lartë se sa parashikimet. Teprica e prodhuar paguhet nga KOSTT-i përmes mjeteve të Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, duke shkaktuar shpenzime shtesë dhe duke e bërë menaxhimin e këtij Fondi joefikas.

Auditimi ka evidentuar mangësi në proceset e prokurimit për projekte publike investive, të cilat kanë ndikuar në transparencën, konkurrencën dhe efikasitetin e shpenzimit të fondeve publike. Mospërmbushja e kritereve të përcaktuara në dosjet e tenderit nga operatorët ekonomik, pranim i dokumentacionit të paplotë apo referencave të paverifikuara, si dhe mungesa e dokumentimit dhe arkivimit të duhur nga autoritetet kontraktuese, përbëjnë shkelje në prokurim publik.

Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të siguruar digjitalizim të plotë të proceseve/shërbimeve, siguri të informacionit, vazhdimësinë e biznesit/shërbimeve si dhe kontrollet e përgjithshme e të aplikacionit janë të dobëta.

- Sistemi ASYCUDA World në Doganën e Kosovës ka ndihmuar në digjitalizimin e proceseve, por ka mangësi në sigurinë e informacionit, vazhdimësinë e biznesit dhe kontrollet e brendshme;
- Platforma e-Kosova ka ndihmuar në digjitalizimin e shërbimeve publike, por përballet me mangësi në sigurinë e informacionit, integrimin e sistemeve dhe vazhdimësinë e shërbimeve;
- Sistemi i Tatimit në Pronë (SITP) ka transformuar administrimin e tatimit në pronë duke e bërë më të menaxhueshëm, si platformë të centralizuar me një bazë të të dhënave të vetme për të gjitha komunat. Megjithatë Sistemi i Tatimit në Pronë nuk garanton plotësisht ofrimin e të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme; dhe
- Sistemi për integrimin e të dhënave Deponia e të Dhënave ka mundësuar grumbullimin e të dhënave nga institucione të ndryshme për përmirësimin e raportimit dhe menaxhimit të të dhënave. Megjithatë, mungesa e proceseve të formalizuara, dokumentimit të plotë të proceseve dhe koordinimit ndërinstitucional ka rezultuar në dobësi në menaxhimin strategjik të sistemit dhe në përdorimin e mangët të tij.

ZKA në nivel lokal ka kryer tetë (8) auditime të pajtueshmërisë, në të cilat ka dhënë 54 rekomandime për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e pronave të dhëna me qira.

Rezultatet e auditimit tregojnë për mungesë të transparencës, kontrollit dhe zbatimit të procedurave të rregullta në procesin e dhënies dhe menaxhimit të pronës komunale. Në disa raste mungojnë rregulloret përkatëse që do të rregullonin dhënien në shfrytëzim të pronës për afat të shkurtër, ndërsa në raste të tjera nuk është siguruar respektimi i rregulloreve ekzistuese, që ka ndikuar në veprime jashtë kornizës ligjore dhe dëme të mundshme financiare.

Është evidentuar mungesa e procedurave formale për vazhdimin e kontratave të qirasë, mungesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe shkelje në lidhje me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të palë të treta pa miratim paraprak.

Kryetaret e Komunave nuk kanë raportuar në Kuvendet Komunale për realizimin e kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të shfrytëzimit të pronës publike dhe kjo ka kufizuar aftësinë e mbikëqyrjes për të marrë vendime efektive.

Po ashtu, ZKA ka kryer **auditimin e pajtueshmërisë** "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së".

Rezultatet e auditimit tregojnë se Kompania nuk ka arritur të bëj menaxhimin e kontratës sipas kërkesave ligjore, duke mos realizuar pozicionet e caktuara sipas kontratës dhe tejkalime të theksuara të pozicioneve të caktuara.

1.1. Auditimet e Performancës

Përmes auditimeve të përformancës, Zyra Kombëtare e Auditimit synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Në këtë fushë janë kryer 8 auditime që përfshinë tema të ndryshme. Në kuadër të këtyre auditimeve janë dhënë 68 rekomandime për organizatata e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore

Edukimi në Fëmijërinë e Hershme luan një rol të rëndësishëm dhe siguron një bazë të fortë për zhvillimin edukativ dhe të përgjithshëm social. Zhvillimi i këtij sektori ka ndikim pozitiv në shtimin e kujdesit ndaj shtresave të ndjeshme shoqërore dhe rritjen e potencialit të punësimit tek gratë. Ky sektor i arsimit në vendin tonë përballet me mungesa të theksuara infrastrukturore dhe organizative. Analizimi i këtyre problemeve dhe shqyrtimi i mundësive për tejkalimin e tyre, hap rrugë për përmirësimet e domosdoshme.

Auditimi ynë ka pasur për objektivë vlerësimin e organizimit të procesit të edukimit të hershëm, shfrytëzimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe funksionimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e institucioneve parashkollore.

Auditimi ka përfshirë Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe tri komuna të Kosovës, përkatësisht Drejtoritë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë Periudha e auditimit përfshinë vitet 2022-2024.

Mesazhi i auditimit: *Rezultatet e auditimit tregojnë se pavarësisht përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të avancuar edukimin në fëmijërinë e hershme, sektori parashkollor përballet me sfida të mëdha strukturore, menaxheriale dhe zbatuese. Mungesa e kuadrit të plotë ligjor dhe mekanizmave funksional për monitorim, licencim dhe inspektim pengon*

zbatimin efektiv të politikave arsimore. Në nivel lokal, përparimet janë të pjesshme dhe të pamjaftueshme, përderisa mungojnë plane zhvillimore afatgjata dhe përfshirja gjithëpërfshirëse e fëmijëve. Kërkesat për zgjerim dhe themelim të institucioneve të reja mbeten të mëdha dhe ende të papërmbushura.

Sistemi aktual përballet me vështirësi në aspektin e organizimit dhe të menaxhimit të institucioneve parashkollore. Mungesa e udhëzuesve të rinj administrativë dhe e mbikëqyrjes efektive ka krijuar paqartësi në funksionimin e institucioneve parashkollore.

Procedurat e licencimit të institucioneve parashkollore të sektorit privat, me bazë në komunitet dhe publiko privat, zhvillohen pa standarde të qarta kohore dhe pa një sistem funksional të monitorimit, gjë që shkakton probleme në funksionimin e tyre.

Në nivelin komunal, në Komunën e Prishtinës mungojnë planifikimet afatgjata për ndërtimet e reja, kurse në Komunën e Prizrenit ka pasur pengesa në realizimin e procedurave të emërimit të objekteve të reja. Kjo komunë, gjithashtu, nuk ka përfshirë moshat 0-3 vjeç në institucionet parashkollore, siç është e paraparë me ligj.

Mungesa e sistemit të monitorimit apo të përcaktimit të stafit dhe mos përfshirja e nivelit të edukimit të hershëm në rregulloret komunale për arsim, ka ndikuar në menaxhim të paorganizuar dhe pa përcjellje të rregullt të institucioneve parashkollore në Prishtinë dhe Prizren.

Vlen të ceket se Komuna e Gjakovës ka arritur të përmbushë më mirë nevojat e institucioneve publike dhe ka pasur mbarëvajtje si në shërbime komunale ashtu edhe në zgjerim të kapaciteteve teknike.

Auditimi përcjellës i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2019

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është përmirësimi i procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara dhe zbatimi i tyre shërben si mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Përmes këtij auditimi kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimeve të performancës të publikuara gjatë vitit 2019 dhe nëse rekomandimet kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar përmes auditimit.

Ky auditim përcjellës në fushëveprim kishte 13 raportet të auditimit të performancës të publikuara në vitin 2019. Në këto auditime janë përfshirë 36 subjekte të audituara me 199 rekomandime të dhëna.

Mesazhi i auditimit: *Disa rekomandime janë zbatuar në nivel individual dhe kanë ndikuar pozitivisht në adresimin e mungesave, por progresi i përgjithshëm mbetet i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm, kjo për faktin që rekomandimet për këto raporte janë dhënë në vitin 2019, pra kanë kaluar rreth gjashtë vite nga gjendja e konstatuar në atë kohe. Angazhimet e subjekteve të audituara për të zbatuar rekomandimet e dhëna nuk janë të mjaftueshme.*

Auditimi përcjellës ka treguar se vetëm 25% e rekomandimeve të dhëna në 13 raportet e auditimit të performancës janë zbatuar plotësisht. Ndërkohë, 55% e tyre nuk janë trajtuar fare dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për zbatimin e tyre. Për 4% është evidentuar progres i pjesshëm, pasi ndodhen në faza të ndryshme të zbatimit, ndërsa për 16% të rekomandimeve nuk ka qenë e mundur të bëhet vlerësimi, për shkak të mungesës së përgjigjeve nga institucionet përkatëse dhe kufizimit të fushëveprimit.

Bashkëpunimin ndërinstitucional ka reflektuar një ndikim të drejtpërdrejtë të auditimit në funksionalitetin institucional. Vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve në entitetet ku janë marrë masat për zbatim të plotë të rekomandimeve tregon se ka pasur efekt të dukshëm, si rasti i Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ku u zbatuan të gjitha rekomandimet e dhëna.

Sa u përket institucioneve me zbatim më të kufizuar, mungesa e planeve të veprimit nga të gjitha entitet e përfshira në auditim ka reduktuar ndikimin plotë të zbatimit të rekomandimeve.

Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore

Pyjet në Kosovë përbëjnë një pasuri natyrore me rëndësi të veçantë për biodiversitetin, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Këto pyje janë të shpërndara si brenda zonave të mbrojtura, përfshirë Parkun Kombëtar "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", ashtu edhe jashtë tyre, sipërfaqe që janë në pronësi publike dhe private.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore, me qëllim që të vlerësohet efikasiteti i institucioneve përgjegjëse në mbrojtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e hapësirave pyjore. Fushëveprimi i auditimi ka përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë Pyjore, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Mesazhi i auditimit: *Hapësirat pyjore janë ndër pasuritë publike më të atakuara dhe dëmtuara dy dekadat e fundit. Rezultatet e auditimit tregojnë se ende ka sfida serioze në këtë fushë. Mungesa e kornizës së qartë ligjore/rregullative, kontrollit efektiv dhe mos koordinimi institucional ka lejuar prerje ilegale, uzurpime dhe dëmtime në zonat e mbrojtura, duke sjellë humbje të mëdha ekonomike dhe mjedisore.*

Mungesa e mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së Pyjeve Publike nga Agjencia Pyjore e Kosovës, duke përfshirë mungesën e kontrollit, regjistrimit dhe inventarizimit të sipërfaqeve pyjore ka ndikuar në humbje dhe dëmtime të masës drusore në vend.

Inspektorati i Pyjeve nuk ka qenë efektiv, kjo ka ndikuar në mos reagim ndaj dëmtimit dhe keqpërdorimit të hapësirave pyjore publike. Gjatë operimit brenda Agjencisë Pyjore deri në vitin 2023 ka ndikuar negativisht në pavarësinë dhe objektivitetin e veprimtarive të tij inspektuese, tani është në kuadër të MBPZHR, por mungon ende baza ligjore për funksionimin e tij dhe mbikëqyrja efektive nga ministria.

Në Parqet Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", ka prerje ilegale, ndërtime pa leje dhe dëmtime nga sëmundjet e pyjeve. Parku "Sharri" nuk është i mbuluar me roje, ndërsa në "Bjeshkët e Nemuna" numri i ndërtimeve pa leje është dyfishuar nga viti 2010 deri më 2024. Për më tepër, mungesa e koordinimit ndërinstitucional ka pamundësuar trajtimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve që prekin rreth 3% të sipërfaqes pyjore në këto parqe.

Agjencia Pyjore e Kosovës përballet me mungesë të të dhënave të sakta, janë identifikuar vetëm 246 raste uzurpimi, ndërkohë kanë aplikuar për qiradhënie mbi 2,200 raste që tregon shfrytëzim të paautorizuar për vite me radhë. Agjencia nuk ka listë me detajet e pronave që menaxhon dhe janë rreth 500 emërtime të ndryshme të pronave pa i unifikuar dhe verifikuar ato me Agjencinë Kadastrale, ndërsa mbi 11,600 hektarë kanë pësuar ndryshime kadastrale pa njoftimin e saj, kryesisht si pasojë e vendimeve institucionale e gjyqësore nga mostrat e testuara.

Realizimi i pamjaftueshëm i objektivave dhe rrezikimi i fidanishteve rreth 44% të objektivave të planifikuara në planet vjetore që ndërlidhen me kultivimin, trajtimin dhe ngritjen e pyjeve të reja nuk janë realizuar si dhe janë rreth një milion fidanë që rrezikojnë të dështojnë për shkak të mungesës së kontraktimeve për pyllëzim nga ana e Agjencisë.

Mangësi në procesin e qiradhënies dhe mbikëqyrjes së kontratave. Procesi i qiradhënies së pronave publike nga Agjencia Pyjore e Kosovës ka vonesa të konsiderueshme. Në disa raste, trajtimi i kërkesave për qiradhënie është zvarritur deri në 38 muaj dhe mbikëqyrja e kontratave është e dobët.

Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë

Mbrojtja e konsumatorëve përbën një nga shtyllat kryesore të një tregu funksional, të drejtë dhe të qëndrueshëm. Në Kosovë, mbrojtja e konsumatorit është e rregulluar me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe përfshin një strukturë institucionale ku Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, dhe Inspektoratit Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, luajnë rolin kryesor në hartimin e politikave dhe zbatimin e masave mbrojtëse për konsumatorët.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar një auditim të performancës për të vlerësuar funksionalitetin dhe efektivitetin e sistemit për mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë gjatë periudhës 2022–2024 në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Objektivi i auditimit ishte të vlerësojë nëse institucionet përgjegjëse sigurojnë mbrojtje reale, të drejtë dhe efektive për konsumatorët në përputhje me parimet e transparencës, qasjes së barabartë dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Mesazhi i auditimit: *Sistemi aktual për mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë është joefikas dhe i pakoordinuar, me mangësi të theksuara në secilën hallkë të tij. Procedurat për trajtimin e ankesave te konsumatorëve nuk janë të unifikuara, mungon gjurmueshmëria dhe dokumentimi i vendimeve, ndërsa një pjesë e ankesave mbetet e pazgjidhur ose trajtohet me vonesë.*

Inspektimet nga Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) nuk kryhen në mënyrë sistematike dhe nuk bazohen në analiza të rrezikut. Ato realizohen kryesisht vetëm pas paraqitjes së ankesave

individuale, ndërsa mungon planifikimi proaktiv për sektorët me rrezik të lartë. Gjobat e shqiptuara nga IQMT janë të njëjta për shumicën e rasteve, të pa diferencuara sipas llojit apo ashpërsisë së shkeljes, dhe nuk ndjekin një qasje progresive. Gjithashtu, IQMT nuk ndjek sistematikisht zbatimin e masave ndëshkuese. Nuk ekziston rikontroll për të verifikuar nëse gjobat janë zbatuar, dhe të dhënat nuk analizohen për të matur ndikimin e ndërhyrjeve në sjelljen e operatorëve ekonomikë.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) nuk përdor në mënyrë të strukturuar të dhënat nga ankesat për të ndërtuar politika të bazuara në evidencë dhe nuk ka kapacitete analitike për të identifikuar sektorët me rrezik të lartë. Edhe pse ekziston një platformë elektronike për paraqitjen e ankesave, ajo nuk është funksionale në mënyrë të plotë, nuk është e integruar me IQMT-në, nuk mundëson ndjekjen e statusit nga konsumatori dhe nuk ofron raporte të avancuara për analizë. Po ashtu, ndërgjegjësimi dhe informimi i qytetarëve mbetet i kufizuar, DMK nuk është aktive në media tradicionale apo digjitale dhe mungojnë fushata vetëdijësuese. Sipas anketës me qytetarët, mbi 26% nuk dinë si dhe ku të ankohen, ndërsa 28% nuk kanë marrë përgjigje fare, duke reflektuar mungesën e komunikimit efektiv dhe besimit në institucion.

Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorëve 2021–2025 nuk zbatohet në mënyrë të matshme dhe të strukturuar. As DMK, si organ politikëbërës, e as IQMT, si organ zbatues, nuk kanë ndërtuar lidhje funksionale ndërmjet objektivave strategjike dhe aktiviteteve operacionale. Aktivitetet institucionale zhvillohen të shkëputura, pa indikatorë performance dhe pa raportim për ndikimin real të ndërhyrjeve.

Për përmirësimin e gjendjes së konstatuar, janë dhënë gjithsej 13 rekomandime për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Efikasiteti dhe Efektiviteti në Procesin e Ndërtimeve të Larta në Komunën e Prishtinës

Urbanizimi dhe lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale dhe vendet tjera të Kosovës në ato urbane ka shtuar numrin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës. Komuna duhet të sigurojë planifikim të duhur dhe ndërtim cilësor në mënyrë që qytetarët të realizojnë të drejtën e tyre për të jetuar në një ambient që është: i përshtatshëm, i sigurt dhe që përmbushë kërkesat themelore në aspektin social, mjedisor dhe financiar.

Zyra Kombëtare a Auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar nëse Komuna e Prishtinës ka vendosur procedura se si të trajtoj procesin e ndërtimeve të larta, si dhe nëse ka përdorur mekanizmat në dispozicion për të siguruar se janë lëshuar certifikatat e përdorimit, që janë vërtetim i cilësisë dhe sigurisë së ndërtesave.

Kemi audituar 48 mostra të lejeve të ndërtimit për objekte shumë banesore nga gjithsej 477 (10%) të lëshuara për periudhën 2021-2023 si dhe 15 certifikata të përdorimit nga gjithsej 83 (18%) të lëshuara në vitet e mëparshme.

Mesazhi i auditimit: *Komuna e Prishtinës nuk ishte efikase as efektive në procesin e lëshimit të lejeve të ndërtimit e as në pajisjen e tyre me certifikata të përdorimit.*

Ka mungesë të kontrolleve gjatë lëshimit të kushteve, trajtim jo të barabartë të kërkesave për leje ndërtimore, mungesë të inspektimeve të mirëfillta dhe të rregullta si dhe mekanizmi për pajisje me certifikatë të përdorimit nuk është efektiv. Vetëm 15% e lejeve të lëshuara për ndërtim gjatë viteve 2017- 2021 janë pajisur me certifikatë të përdorimit, pra, pjesa tjetër e ndërtesave nuk u ofron banorëve siguri që objektet janë të sigurta për banim, si dhe nuk u sigurohet e drejta ligjore mbi atë pronë.

Komunës i duhen prej 3 deri në 30 muaj për të lëshuar një leje ndërtimore, për shkak se nuk kishte bërë shpërndarje proporcionale të detyrave mes zyrtarëve të saj (një zyrtar kishte trajtuar 97 kërkesa për leje ndërtimi, ndërsa tjetri vetëm dy).

Ngjashëm ishte edhe shpërndarja e detyrave tek inspektorët (një inspektor kishte 54% e lëndëve, ndërsa pjesa e mbetur ishte tek nëntë inspektorë tjerë). Për t'iu përgjigjur një kërkese për inspektim, Komunës i duhen 8 deri në 60 ditë, gjë që ka ndikuar edhe në uljen e vullnetit të investitorëve për të bërë kërkesë për inspektim.

Komuna nuk ka zhvilluar mekanizma funksional që obligojnë investitorin që pas inspektimit final dhe para se objekti të lëshohet për banim të pajiset me certifikatë të përdorimit.

Për të siguruar se janë vendosur procedura të duhura dhe funksionale për trajtimin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës dhe se mekanizmat në dispozicion sigurojnë se janë lëshuar certifikatat e përdorimit, ne kemi dhënë shtatë rekomandime.

Efikasiteti në Realizimin e Projektit "Rehabilitimi i Linjës 10 Hekurudhore Hani i Elezit – Leshak"

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën "Efikasiteti në realizimin e projektit 'Rehabilitimi e Linjës 10 Hani Elezit – Leshak'" me objektivin që të vlerësojë nëse Infrakos së bashku me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe me Ministrinë e Ekonomisë ishin efikase në menaxhimin e projektit.

Auditimi është fokusuar në procedurat e kontraktimit dhe kostot e ndërlidhura, pasi që projekti ende nuk është zbatuar ndërsa ka nisur para një kohe të gjatë - kërkesa për financim në 2012, negocimi i marrëveshjes në 2015. Projekti financohet nga huamarrja dhe grante ndërkombëtare. Deri në fund të vitit 2024, janë shpenzuar 92.3 milion euro (37%) nga 250 milion euro sa janë përcaktuar në marrëveshjen e përditësuar të vitit 2023.

Mesazhi i auditimit: *Institucionet përgjegjëse për realizimin e projektit të Rehabilitimit të Linjës 10 nuk kishin qenë efikase për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet tyre , angazhimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së ekspertëve adekuat. Projekti do të duhej të ishte i gatshëm për përdorim në vitin 2019, por deri në fund të vitit 2024 vetëm 60% të punimeve ishin realizuar për Fazën I, 32% për Fazën II dhe pa projekt të dizajnuar për Fazën III. Gjatë viteve 2022 dhe 2023 projekti kishte kosto shtesë dhe provizionale në vlerë prej 30 milion euro, prej të cilave 28 milion burojnë nga ndryshime në kontratat bazë, ndërsa pjesa tjetër nga shpenzime të tjera të ndërlidhura me projektin.*

Realizimi i projektit është përcjellë me vonesa të mëdha, kosto shtesë dhe ndryshime të shumta në kontratat fillestare. Për pasojë afati për realizim të projektit është zgjatur deri në vitin 2027. Mos fillimi i fazës së tretë dhe largimi i disa komponentëve kritikë rrisin rrezikun për tejkalim të mëtejmë të kostove dhe afateve.

Projekti është karakterizuar nga vlerësime të dobëta fillestare, që kanë sjellë nevojën për huamarrje shtesë në vlerë prej 38 milion euro, si dhe kostot shtesë të sinjalizimit dhe elektrifikimit të parashikuara deri në 55 milion euro. Procedurat e kontraktimit dhe menaxhimit të kontratave kanë qenë joefikase – me mospërshtatje të metodës së kontraktimit, mungesë të menaxherëve të kontratave, procedura të ngadalta të vlerësimit dhe ndryshime të shpeshta në kontrata, që kanë rritur kostot me rreth 28 milion euro apo 21% krahasuar me kontratat bazë.

Janë evidentuar mospërputhje në cilësinë e punimeve, raste të mashtrimit nga nën-kontraktorë, mungesë veprimesh konkrete ndaj tyre dhe vonesa në vendimmarrje. Njësia për Implementimin e Projektit, që ka rol vendimtar në zbatim të projektit, nuk ka funksionuar në kapacitet të plotë dhe ka qenë e paqëndrueshme në përbërje.

Mbyllja e linjave Fushë Kosovë–Hani i Elezit dhe Fushë Kosovë–Mitrovicë është bërë pa transparencë dhe jashtë autorizimit ligjor, duke ndikuar negativisht në qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në transport hekurudhor.

Për më tepër, ka munguar monitorimi efektiv nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, ndërsa Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti Drejtues nuk kanë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes, përkundër që projekti ka qenë vazhdimisht nën pritshmëri.

Për të siguruar se janë rritur angazhimet e palëve të përfshira, e që rrjedhimisht do të ndikonin në përmirësimin e procesit dhe rritjen e efikasitetit për të përfunduar realizimin e projektit të rehabilitimit të hekurudhave-linja 10, ne kemi dhënë 11 rekomandime.

Dy rekomandime janë dhënë për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dy për Ministrinë e Ekonomisë, përkatësisht Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe shtatë për Infrakosin.

Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë

Ndërtimi i klinikës së Ortopedisë në QKUK është vlerësuar si një nevojë urgjente dhe e domosdoshme për shkak të sfidave të shumta me të cilat është përballur sistemi shëndetësor në këtë fushë. Hapësirat që i posedonte klinika e Ortopedisë nuk i përmbushnin nevojat për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e aktiviteteve te nevojshme profesionale mjekësore.

Zyra Kombëtare a Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën "Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë". Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësojmë nëse Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ishte efikas në menaxhimin e projektit për ndërtimin e kësaj klinike.

Mesazhi i auditimit: *Auditimi ka nxjerrë në pah një numër të konsiderueshëm të parregullsive që tregojnë se ShSKUK nuk ka qenë efikase në menaxhimin e këtij projekti. Kjo kishte ndodhur për shkak se projekti nga fillimi e deri tek përfundimi ka zgjatur afër pesë vite, përderisa ishte planifikuar të kryhej për një vit e gjysmë. Në këtë vonesë ka ndikuar planifikimi jo i duhur i projektit, mungesës së një analize të hollësishme të nevojave reale dhe burimeve të kërkuara. Për më tepër, janë evidentuar mangësi të konsiderueshme në menaxhimin e kontratës, si në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të punëve, ashtu edhe në adresimin me kohë të pengesave të hasura gjatë realizimit.*

Zbatimi i projektit është shoqëruar me sfida të shumta që kanë nisur qysh në fazën e planifikimit. Kërkesa iniciuese dhe projektimi janë bërë pa analiza të plota teknike dhe pa verifikime në terren. Fillimisht ishte planifikuar renovimi i objektit ekzistues dhe zgjerimi përmes një kati shtesë dhe një aneksi të ri. Megjithatë, pas inspektimeve është konstatuar se objekti nuk i përmbushte kushtet strukturore, duke çuar në demolim të tij dhe rikonceptim të projektit. Gjatë zbatimit, janë identifikuar edhe mangësi në projekt, të cilat kërkuan ndryshime në pozicione teknike, ndalje të punimeve dhe një kontratë shtesë për punë të paparashikuara, gjë që zgjati afatin dhe rriti koston.

Ndryshimet e shumta kanë ndikuar edhe në funksionalitetin e objektit. Edhe pse rregullimet e sasive brenda kontratës ishin brenda kufijve ligjorë, ato tregojnë mungesë të analizës së saktë paraprake. Gjithashtu, disa dhoma që ishin paraparë për pacientë janë shfrytëzuar për funksione të tjera, duke ulur kapacitetin e ofrimit të shërbimeve. Si pasojë e gjithë këtyre devijimeve, projekti ka përfunduar në qershor 2024, në vend të janarit 2021, duke kaluar nga 1.5 vite të planifikuara në rreth 5 vite realizim.

Projekti është karakterizuar edhe me menaxhim të dobët të kontratës. Vlera përfundimtare e kontratës është rritur në mbi 2.57 milion euro, ose 16% më shumë se parashikimi fillestar. Janë evidentuar tejkalime të sasive mbi 75 mijë euro pa miratim, si dhe tri pagesa në vlerë mbi 255 mijë euro pa nënshkrimin e menaxherit të kontratës. Gjithashtu, nuk është bërë vlerësim i dokumentuar i performancës së kontratës, duke pamundësuar një analizë objektive për mësime të vlefshme në të ardhmen.

Për të siguruar se kontratat e ardhshme të ndërtimit në ShSKUK zbatohen në mënyrë efikase, ne kemi dhënë gjashtë rekomandime. Lista e plotë e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin pesë të këtij raporti.

Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

Siguria në furnizimin me energji, operimi efikas i sistemit të transmetimit dhe garantimi i një tregu të drejtë e transparent përbëjnë prioritete thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Mënyra se si menaxhohen resurset energjetike ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien ekonomike dhe sociale, për shoqërinë dhe për gjithë vendin në tërësi. Në kuadër të resurseve energjetike në vendin tonë bëjnë pjesë edhe burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar mënyrën e menaxhimit të Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, si dhe për të shqyrtuar zbatimin e masave të ndërmarra për rritjen e kapaciteteve të këtyre burimeve.

Mesazhi i auditimit: *KOSTT nuk ka qenë efikas në organizimin e shitblerjes së energjisë së ripërtërishme. Prodhuesit e energjisë kishin parashikime jo të sakta, duke krijuar tepricë prodhimi dhe jo-balanca që shkaktuan kosto shtesë në Fondin e energjisë së ripërtërishme për blerjen e kësaj energjie. Gjithashtu janë identifikuar mangësi gjatë fazës testuese dhe certifikimit të prodhueseve të kësaj energjie. Në anën tjetër, ZRRE me vendimin e vitit 2019 e kufizoi përgjegjësinë e prodhuesve për jo-balancat në vetëm 5% të të hyrave vjetore. Po ashtu edhe caqet e vendosura nga Ministria e Ekonomisë për vitin 2020 nuk ishin arritur në nivelin e parashikuar.*

Auditimi ka identifikuar se KOSTT kishte pasur kosto shtesë për blerjen e energjisë nga jo balancat e prodhueseve të burimeve të ripërtërishme që arrijnë deri në 10 milion euro për vitet 2022 deri në 2024. Për më tepër, përgjegjës kryesor për këto jo balanca ishte një grup prej tre prodhueseve që përbëjnë në total 80% të këtyre jo balancave. Gjithashtu, KOSTT nuk kishte arritur të siguronte garancionet financiare nga viti 2017 deri në 2024, mungesa e të cilave kishte çuar në vonesa deri në shtatë muaj në inkasimin e të hyrave për Fondin.

ZRRE nuk kishte arritur të monitorojë në mënyrë të rregullt Fondin e Burimeve të Ripërërishme të Energjisë. Për më tepër si pasojë e vendimit të vitit 2019 për kufizimin e përgjegjësisë së jo balancave të prodhueseve të energjisë, ishin shkaktuar kosto shtesë të jo balancave për Fondin në vlerë prej 4.6 milion euro për vitet 2022 deri në 2024

Gjithashtu, caqet për burimet e ripërtëritshme të energjisë të vendosura nga Ministria e Ekonomisë për t'u arritur deri në vitin 2020 nuk janë realizuar. Deri në vitin 2025, ishte përmbushur vetëm 40% e këtyre caqeve.

Për të përmirësuar proceset dhe për të siguruar menaxhim më të mirë të Fondit, ne kemi dhënë gjithsej 9 rekomandime, gjashtë për KOSTT-in, një për ZRrE-në dhe dy për Ministrinë e Ekonomisë.

1.2. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Zyra Kombëtare e Auditimit po i kushton rëndësi të veçantë edhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Këtë sezonë janë përfshirë projekte dhe sisteme të informacionit me ndikim në institucionet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Janë kryer katër (4) auditime në këtë fushë. Në këto raporte janë dhënë 48 rekomandime për organizatatat e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World

Dogana e Kosovës është agjencion për menaxhimin e të hyrave në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Të hyrat e mbledhura nga Dogana kontribuojnë rreth 60% të hyrave të gjithmbarshme që grumbullohen për buxhetin e Republikës së Kosovës. Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Doganën e Kosovës për të vlerësuar nëse sistemi ASYCUDA World mundëson zbatimin e proceseve elektronike doganore në mënyrë të saktë, të sigurt dhe të besueshme.

Mesazhi i auditimit: *Dogana e Kosovës në vazhdimësi ka bërë zhvillime në sistemin ASYCUDA World për të siguruar digjitalizimin e proceseve doganore dhe për të përmirësuar sigurinë dhe saktësinë e të dhënave dhe proceseve që realizohen përmes këtij sistemi dhe sigurinë e vetë sistemit. Megjithatë, ka ende mangësi në politikat e kontraktimit, kontrollet që zbatohen për mbrojtjen e sigurisë së informacionit nuk garantojnë mjaftueshëm integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit, nuk ka menaknizma të mjaftueshëm për vazhdimësinë e biznesit dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen në ASYCUDA nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem. Po ashtu, digjitalizimi mbetet një proces i vazhdueshëm, dhe sfidat si përshtatja e mëtejshme e kritereve të rrezikut, integrimi i plotë i sektorëve dhe ofrimi i mbështetjes teknologjike kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm për të arritur një nivel të plotë të digjitalizimit.*

Kontraktimi, në Doganën e Kosovës nuk përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat e palëve në proces për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit duke e lënë sigurinë e sistemit të informacionit të pa adresuar dhe të cenueshme.

Informacioni dhe siguria kibernetike, ka mangësi në kontrollet për sigurinë e informacionit në mungesë të një strukture të qartë të sigurisë së TI-së. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të punonjësve lidhur me sigurinë e informacionit, mungesë e procedurës për kontrollin e qasjes së përdorueseve dhe politika për sigurinë e informacionit e pa përditësuar.

Planet për Vazhdimësinë së Biznesit dhe Rikthimit nga Fatkeqësia, DK nuk ka politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit në organizatë në mungesë të planit të vazhdimësisë së biznesit, strukturës që do të mundësoj realizimin e planit dhe procedurave të shkruara doganore që realizohen përmes sistemit ASYCUDA.

Kontrollet e aplikacionit, DK nuk ka arritur të siguroj se të dhënat të cilat vendosen në sistem janë të sakta, sepse të dhënat për kalkulimin e koeficientit për përcaktimin e çmimit procesohen në formë manuale. Po ashtu, nuk siguron se janë të dhëna valide dhe të besueshme si dhe për shkak të formës së vendosjes së kritereve për vlerësimin e rrezikut në këtë sistem DK nuk arrin të ketë një pasqyrë të matshme të paraqitjes së rrezikut. Po ashtu, ky sistem nuk është i lehtë për përdoruesin, nuk ofron mundësi të thjeshta përdorimi, sidomos për modulet e tarifave dhe riskut, prandaj si pasojë ka raste që shfaqen gabime në sistem.

Platforma e shërbimeve online e-Kosova

Qeveria e Kosovës ka krijuar platformën “e-Kosova” si një nga zhvillimet për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe për të rritur efikasitetin e administratës. Aktualisht ofron rreth 230 shërbime publike në mënyrë elektronike.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit me fokusin e auditimit në shërbimet e kësaj platforme: "Shtesat për fëmijë", "Tatimi në pronë", "Subvencioni i librave" dhe moduli "Pagesat elektronike".

Mesazhi auditimit: *Platforma e-Kosova ka arritur hapa të rëndësishëm drejt digjitalizimit të shërbimeve publike, duke ofruar një mjet të rëndësishëm për lehtësimin e qasjes së qytetarëve dhe institucioneve në procese të ndryshme administrative, duke përmirësuar edhe transparencën dhe efikasitetin. Megjithatë, ende ka sfida në integrimin e sistemeve, sigurinë e informacionit, kontrollin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e biznesit.*

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit nuk ka vendosur standarde të mjaftueshme për menaxhimin e kontratave si dhe nuk garanton mjaftueshëm mjedis të sigurt të informacionit. Në raste emergjente ose fatkeqësi, AShI nuk është e përgatitur për të rikthyer shërbimet, duke rrezikuar vazhdimësinë e operacioneve shtetërore elektronike. Po ashtu mangësitë në kontrolle të aplikacionit funksionale dhe teknike në platformën e-Kosova kanë krijuar rreziqe për saktësinë e sigurinë e të dhënave si dhe integritetin e shërbimeve.

Kontraktimi, Kontrata nuk përfshin mjaftueshëm kërkesat dhe masat për sigurinë e informacionit, duke e lënë sigurinë e sistemit të informacionit të pa adresuar mjaftueshëm.

Blerja dhe zhvillimi, AShI trajton kërkesat emergjente për shërbime elektronike pa dokumentim dhe planifikim të duhur, subvencioni i librave u zhvillua pa kritere teknike të qarta duke sjellë shërbime joefikase dhe rrezik për keqmenaxhim të përfitimeve.

Siguria e informacionit dhe siguria kibernetike, AShI vazhdon të funksionojë me politika të sigurisë së informacionit të shfuqizuara dhe të pa përditësuara, duke lënë organizatën më të cenueshme ndaj sulmeve kibernetike. Megjithatë, janë zbatuar disa masa teknike mbrojtëse dhe mekanizma të avancuar për parandalimin e ndërhyrjeve.

Planet e Vazhdimësisë së Biznesit dhe Rikthimit nga Fatkeqësia, AShI nuk ka një politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthimin nga fatkeqësitë, pasi mungojnë procedurat dhe infrastruktura e nevojshme, përfshirë një qendër dytësore funksionale, kjo rrezikon funksionimin e sistemeve kritike shtetërore.

Kontrollet e aplikacionit, në platformën e-Kosova kanë mangësi si kontrolli i hyrjes, integrimi i sistemeve dhe siguria e informacionit duke krijuar mundësi për përfitime jashtë kritereve, veçanërisht në shërbimet "Shtesat për fëmijë" dhe "Subvencionimi i librave shkollorë". Platforma gjithashtu nuk i përmbush standardet e kërkuara për digjitalizim të plotë dhe ka probleme me sinkronizimin në kohë reale të të dhënave mes sistemeve duke rezultuar me aplikime të dyfishta dhe pagesa të përsëritura nga qytetarët.

Sistemi i Tatimit në Pronë

Sistemi i Tatimit në Pronë (SITP) luan një rol kyç në administrimin e tatimit në pronë dhe ofron një platformë të integruar të të dhënave të tatimit në pronë që përdoret në nivelin lokal të Republikës së

Kosovës për të ofruar këtë shërbim në formë elektronike. Përmes këtij sistemi janë mbi 607 milionë euro të regjistruara/faturuara deri në vitin 2025 për mbi 817 mijë objekte dhe mbi 2.2 milionë parcela të regjistruara. Sistemi ofron pagesa elektronike, duke e bërë më të qasshëm, efikas dhe transparent, si dhe është i ndërlidhur me platformën e-Kosova për ofrimin e faturave për individë, persona të tjerë dhe biznese.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse menaxhimi i sistemit të tatimit në pronë nga palët përgjegjëse është në funksion të sigurimit të të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme.

Mesazhi i auditimit: *Zhvillimi i këtij sistemi ka transformuar administrimin e tatimit në pronë duke e bërë më të menaxhueshëm si platformë të centralizuar me një bazë të të dhënave të vetme për të gjitha komunat. Megjithatë Sistemi i Tatimit në Pronë nuk garanton plotësisht ofrimin e të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Dobësitë në zhvillim dhe funksionim të sistemit, mungesa e procedurave të standardizuara për testim dhe aprovime, si dhe kontrollet e pamjaftueshme, kanë ndikuar negativisht në integritetin e të dhënave dhe menaxhimin efikas të tatimit. Kjo ka rritur rrezikun për pasaktësi në llogaritje, shpërndarje të gabuar të pagesave dhe vështirësi në identifikimin e saktë të tatimpaguesve.*

Blerja dhe zvillimi sistemit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk arrin të siguroj që zhvillimet që realizohen në sistemin e tatimit në pronë arrijnë saktësisht qëllimin e tyre, në mungesë të procedurave që sigurojnë kontrolle të brendshme funksionale lidhur me testimin e zhvillimit të ndryshimeve në sistem, aprovimit dhe refuzimit të zhvillimit të ndryshimeve dhe menaxhimit e trajtimit të kërkesave për zhvillim.

Kontrollet e aplikacionit, janë evidentuar mangësi në ndërlidhjen e sistemit me regjistrin e të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe ndërlidhjes me Sistemin e Anketimit, po ashtu mungesa e kontrolleve kompensuese në nivel komunal. Kjo ka shkaktuar të dhëna të pasakta për tatimpaguesit dhe pronat. Mangësitë në kontrollet e përpunimit kanë shkaktuar mos shpërndarjen e pagesës në mënyrë proporcionale dhe në borxhe të pasakta për qytetarin duke e dëmtuar me ndëshkime dhe interesa.

Sistemi i Tatimit në Pronë ka mangësi në regjistrimin e pagesave dhe nuk e regjistron datën e saktë të kryerjes së pagesës, nuk e pasqyron gjendjen reale të faturës nuk mundëson pasqyrim dhe zbatim të saktë të kërkesave ligjore dhe rregullative.

Po ashtu mangësitë në kontrollet e sigurisë së sistemit të tatimit në pronë e bëjnë më të cenueshëm ndaj keqpërdorimeve të sigurisë së informacionit në sistemin e tatimit në pronë.

Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Deponisë së Shënimeve dhe Implementimi i Inteligjencës së Biznesit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka zhvilluar projektin për integrimin e sistemeve ekzistuese të teknologjisë së informacionit, për ndërtimin e një platforme të përbashkët raportuese analitike (Business Intelligence). Si bazë për këtë sistem është paraparë krijimi i një Deponie të të

Dhënave (Data Warehouse), me qëllim unifikimin e të dhënave nga Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore, Thesari, Departamentet brenda ministrisë dhe institucione të tjera publike që administrojnë financa publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse sistemi Deponia e të Dhënave siguron të dhëna të sakta dhe të besueshme për vendimmarrje makroekonomike.

Mesazhi i auditimit: *MFPT ka bërë hapa në zhvillimin e sistemeve të TI-së për përmirësimin e raportimit dhe menaxhimit të të dhënave. Sistemi për integrimin e të dhënave Deponia e të Dhënave ka mundësuar grumbullimin e të dhënave nga sistemet e MFPT-së, ATK-së, Doganës, Buxhetit, Tatimit në Pronë duke grumbulluar informata në baza ditore, javore dhe mujore për të hyrat, shpenzimet dhe buxhetin në nivel vendi. Megjithatë, mungesa e proceseve të formalizuara, dokumentimit të plotë të proceseve dhe koordinimit ndërinstitucional ka rezultuar në dobësi në menaxhimin strategjik, testimin e seteve të reja dhe integritetin e të dhënave. Po ashtu përdorimi i mangët i sistemit, shfrytëzim i raporteve të dyfishta dhe vështirësi në qasjen në informacion në kohë reale, rrezikon efikasitetin e vendimmarrjes.*

Qeverisja e TI-së, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk ka formalizuar strategjinë për menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, duke vepruar pa një strategji të miratuar për TI dhe pa mekanizma për analizimin dhe prioritizimin e kërkesave për sisteme të reja.

Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm, MFPT nuk ka dokumentuar mënyrën si janë ndërlidhur të dhënat e reja në sistemin Deponia e të Dhënave. Gjithashtu, mungon një procedurë e shkruar për testimin dhe pranimin e seteve/të dhënave të reja. Testimet kryhen në mënyrë joformale dhe pa evidencë, duke rrezikuar gabime në funksionim dhe mungesë transparence.

Politikat e kontraktimit, MFPT ka pasur mangësi në aktivizimin e ditarit të aktiviteteve të përdoruesve në sistemin Deponia e të Dhënave, duke e mos praktikuar gjurmueshmërinë aktiviteteve të përdoruesve të sistemit siç është përcaktuar në kontratë.

Kontrollet e aplikacionit, mungesa e një procesi të automatizuar për verifikimin e transferimit të të dhënave në sistemin Deponia e të Dhënave, si dhe mungesa e dokumentimit të kontrolleve manuale nga ana e TI-së, rrit rrezikun për pasaktësi dhe mungesë të besueshmërisë së të dhënave. Përdoruesit detyrohen të krahasojnë të dhënat përmes raporteve të dërguara me e-mail. Po ashtu, mungesa e koordinimit dhe komunikimit formal për ndryshimet në kodet buxhetore çon në raporte jo të sakta e të plota.

Rekomandim për Qeverinë

T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës, dhe teknologjisë e informacionit si dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese.

1.3. Auditimet e Pajtueshmërisë

Zyra Kombëtare e auditimit ka në fokus shtrirjen e auditimeve të pajtueshmërisë, përmes të cilave, ofron informacion cilësor dhe siguri të arsyeshme mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do ti shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Tema: Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Për vitin 2024, ZKA në nivel lokal ka kryer tetë (8) auditime të pajtueshmërisë, në të cilat ka dhënë 54 rekomandime për Kuvendet Komunale dhe Kryetarët e Komunave, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e veprimeve për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e pronave me qira në përputhje me ligjin, duke siguruar që të gjitha procedurat të zbatohen për të minimizuar humbjet financiare dhe për të përmirësuar transparencën në administrimin e pronave publike.

Këto auditime përfshijnë procesin e dhënies dhe procesin e menaxhimit të kontratave aktive të pronave me qira për periudhën janar 2023 deri në dhjetor 2024, përfshirë edhe kontratat bazë të lidhura në vitet e mëparshme. Subjekt i këtij auditimi kanë qenë Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjilanit, Podujevës, Suharekës, Fushë Kosovës, dhe Vushtrrisë.

Rezultatet e auditimit të këtyre komunave tregojnë për mungesë të theksuar të transparencës, kontrollit dhe zbatimit të procedurave të rregullta në procesin e dhënies dhe menaxhimit të pronës komunale. Në disa raste mungojnë rregulloret përkatëse që do të rregullonin dhënien në shfrytëzim të pronës për afat të shkurtër, ndërsa në raste të tjera nuk është siguruar respektimi i rregulloreve ekzistuese, çka ka çuar në veprime jashtë kornizës ligjore dhe dëme të mundshme financiare.

Komunat nuk kanë zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat ligjore gjatë procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Në raste konkrete, qëllimi i shfrytëzimit të pronës është ndryshuar pa miratim nga Kuvendet Komunale, duke anashkaluar kompetencat vendimmarrëse të këtij organi; ndërsa në rast tjera, pronave i është vazhduar shfrytëzimi për periudhë afatgjatë në kundërshtim me dispozitat ligjore, përtej kufijve kohorë të lejuar për kategori të caktuara. Këto veprime tregojnë për mungesë të kontrollit institucional dhe rrezik për cenim të ligjshmërisë, transparencës dhe interesit publik në menaxhimin e pasurisë komunale.

Është evidentuar mungesa e procedurave formale për vazhdimin e kontratave të qirasë, mungesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe shkelje në lidhje me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të palë të treta pa miratim paraprak. Mungesa e një procesi të strukturuar të rishikimit të çmimeve të qirasë, si dhe lejimi i shfrytëzimit të pronave pa pagesë apo pas skadimit të kontratave, kanë ndikuar në dëmtimin e të hyrave publike dhe keq menaxhimin e pronave komunale. Gjatë auditimit janë evidentuar raste kur nuk është ofruar dokumentacioni bazë që dëshmon ligjshmërinë e shfrytëzimit të pronës komunale.

Po ashtu, është vërejtur mungesë e mbikëqyrjes dhe monitorimit efektiv, monitorimi i pronave të dhëna me qira, dhe mbledhja e të hyrave nga qiraja, janë evidentuar mangësi të theksuara në funksionin mbikëqyrës dhe kontrollues të Komunës lidhur me menaxhimin e kontratave të qirasë për pronën publike, mosndërmarrjen e veprimeve ligjore për mbledhjen e borxheve apo për adresimin e shkeljeve kontraktuale.

Rastet e trajtuara tregojnë për mosrealizim të përfitimeve të përcaktuara me kontratë, përdorim të pasurisë komunale pa kontrata valide, tejkalim të sipërfaqes së dhënë në shfrytëzim, si dhe mos përmbushje të kushteve dhe obligimeve ligjore nga ana e shfrytëzuesve. Mungesa e verifikimeve në terren, e ndjekjes së zbatimit të kushteve kontraktuale dhe e raportimit të rregullt institucional ka krijuar situata ku pronat komunale shfrytëzohet në mënyrë të paautorizuar dhe jashtë mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies.

Në shumicën e rasteve, mungesa e raportimit nga autoritetet ekzekutive/Kryetaret e Komunave nuk kanë raportuar në Kuvendet Komunale për realizimin e kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të shfrytëzimit të pronës publike ka kufizuar aftësinë e këtyre organeve për të ushtruar mbikëqyrje dhe për të marrë vendime të informuara dhe efektive. Këto dobësi përbëjnë rrezik për integritetin e procesit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Tema: Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit” në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së).

Auditimi përfshinë procesin e menaxhimit të kontratës ‹›Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së›› për periudhën Shtator 2021 deri në Qershor 2023 duke u bazuar në pagesat e realizuara. Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Kompania ka bërë menaxhimin e kontratës sipas kërkesave të përcaktuara me Rregullat për Prokurimin Publik dhe Rregulloret e KMDK-së, për menaxhimin e mbeturinave në deponitë sanitare dhe stacionet e transferit.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Kompania nuk ka arritur të bëjë menaxhimin e kontratës sipas kërkesave ligjore. Për më shumë, devijimi nga kushtet e kontratës është material për faktin se në tetë (8) pozicione lidhur me menaxhimin e kontratës, sasitë e parashikuara me kontratën kornizë ishin tejkaluar mbi limitin e lejuar ligjor prej 30% ndërkohë që 46 pozicione tjera nuk ishin realizuar fare. Pra, tejkalimet e sasive të kontraktuara për pozicione të caktuara ishin me një kosto shtesë prej 958,189€, mbi pragun e lejuar prej 30%.

Po ashtu, është vërejtur se realizimi i kontratës kornizë për Mirëmbajtjen e Deponive Sanitare dhe Stacioneve të Transferit kishte mungesë të dokumentimit dhe mospërputhje të konsiderueshme midis sasive të faturuara dhe atyre të dokumentuara për zhavorr dhe orët e punës së makinerive. Pjesë të konsiderueshme të punëve dhe furnizimeve të pranuara mungojnë në dokumentacion, duke rezultuar në vlera të faturuara të pajustifikuara.

Në 11 raste kemi vërejtur se raportet e pranimit ishin nënshkruar nga personeli i kompanisë mirëpo kompania nuk ka arritur të na ofroj dëshmi se nga kush janë themeluar ato komisione të pranimit.

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të kontratës - Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit janë dhënë katër (4) rekomandime.

Kapitulli IV

REKOMANDIMET E AUDITIMIT

Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve

Raportet e auditimit identifikojnë dobësitë në sistemet e qeverisjes, në veçanti ato financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si mekanizëm kyç për adresimin e këtyre dobësive dhe për forcimin e efikasitetit e efektivitetit të sistemeve në funksion të arritjes së objektivave institucionale. Megjithatë, analizat kanë treguar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit mbetet ipamjaftueshëm.

Për vitin 2023, Qeveria nuk kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Në nivelin e auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore ende nuk kanë vendosur një proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Edhe pse krahasuar me vitin 2022 numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale është zvogëluar, niveli i zbatimit të tyre mbetet i pamjaftueshëm. Vetëm 37% e rekomandimeve (duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike) janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa e mbetur është në proces zbatimi ose nuk është zbatuar ende.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në vazhdimin e dobësive dhe mangësive të kontrollit, duke çuar në përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është treguesi kryesor i ndikimit të auditimit dhe reflekton nëse menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsi. Përmes auditimeve individuale, ZKA vlerëson zbatimin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, duke evidentuar qartë fushat ku janë ndërmarrë masa përmirësuese dhe ato ku ende kërkohen veprime shtesë.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për RVF-BRK 2024 janë dhënë gjithsej 20 rekomandime për Qeverinë

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA-2023, ndërsa Tabela 41 dhe 42 paraqesin statistikat e rekomandimeve për organizatat individuale.

1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2023

Qeveria nuk ka dërguar në ZKA planin e veprimit për implementim të rekomandimeve. Derisa, në raportin vjetor financiar për vitin 2024 tek aneksi 24 është paraqitur plani për zbatimin e rekomandimeve të RVA.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Qeverisë dhe institucioneve tjera, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve.

Nga gjithsej 19 rekomandime të dhëna në RVA-në 2023, 16 nuk ishin zbatuar, 1 ishte zbatuar dhe dy (2) ishin në proces të zbatimit. Shtojca I, paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2023.

2. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2023

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë integrale e procesit të vazhdueshëm të auditimit. Ky vlerësim realizohet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimeve të rregullta, duke evidentuar se si dhe në çfarë mase janë zbatuar rekomandimet. Rezultatet e zbatimit për vitin paraprak pasqyrohen në raportet e auditimit të vitit pasues.

Tabelat e mëposhtme paraqesin të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të viteve 2023 dhe 2022, të kategorizuara sipas organizatave të audituara.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjen e zbatimit të tyre.

Tabela 40 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2023

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2023	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më më[21]	Rekomandimet për zbatim	Të zbatura		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	Nr	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	127	4	**123**	52	42%	11	9%	60	49%
Institucionet e pavarura	52	7	**45**	25	56%	7	15%	13	29%
Institucionet e nivelit lokal	369	15	**354**	130	37%	20	5%	204	58%
Ndërmarrjet Publike[22]	133	27	**106**	27	25%	8	8%	71	67%
Gjithsej rekomandimet	681	53	**628**	234	37%	46	7%	348	56%

Te NP, përveç rekomandimeve të vitit 2023 të prezantuara në tabelë, ZKA ka vlerësuar gjatë vitit 2024 edhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Telekomin sh.a të vitit 2020, që ka rezultuar që nga 12 rekomandimet e dhëna, 6 prej tyre ishin zbatuar dhe 6 të tjera nuk ishin zbatuar.

21 Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më rrjedhin si rezultat i fuzionimit të tyre apo ndryshimeve të akteve ligjore, përderisa te NP nuk janë vlerësuar 20 rekomandime nga viti paraprak përshkak që nuk ishte kryer auditim në tri NP.

22 Në RVA për vitin 2023 janë raportuar gjithsej 133 rekomandime. Ky numër përfshin edhe 20 rekomandime të dhëna për ndërmarrjet Hekurudhat e Kosovës Infrakos sh.a., KRM Pastrimi sh.a. dhe Ndërmarrja Publike Banesore sh.a., të cilat nuk kanë qenë objekt auditimi në vitin 2024, prandaj ato janë zbritur nga totali.

Tabela 41 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2022

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2022	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më[23]	Rekomandimet për zbatim	Të zbatura		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	Nr	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	166	11	**155**	76	49%	21	14%	58	37%
Institucionet e pavarura	53	1	**52**	31	60%	5	10%	16	31%
Institucionet e nivelit lokal	372[24]	12	**360**	140	39%	19	5%	201	56%
Ndërmarrjet Publike	152	15	**137**	79	58%	10	7%	48	35%
Gjithsej rekomandimet	743	39	**704**	326	46%	55	8%	325	46%

Siç paraqitet edhe në tabelat më sipër, numri total i rekomandimeve të dhëna ka shënuar një rënie nga 743 në vitin 2022 në 681 në vitin 2023. Megjithatë, përqindja e rekomandimeve të pazbatuara është rritur nga 46% në 56%, duke treguar se niveli i zbatimit të rekomandimeve vazhdon të jetë i pamjaftueshëm.

Vlen të theksohet se në raportet e auditimit të performancës për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 124 rekomandime.

ZKA zbaton një qasje të strukturuar për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e mëparshme të auditimeve të performancës. Sipas praktikës së saj, çdo vit realizohet një auditim përcjellës që mbulon raportet e publikuara gjashtë vite më parë, e cila siguron një pasqyrë të besueshme mbi progresin institucional dhe lehtëson krahasueshmërinë ndër vite.

Gjatë sezonit auditues 2024/2025, ZKA ka kryer auditimin përcjellës për raportet e vitit 2019, duke përfshirë 10 raporte të auditimit të performancës me gjithsej 199 rekomandime të dhëna për 36 subjekte të audituara. Nga këto rekomandime, vetëm 51 janë zbatuar plotësisht, që përfaqëson rreth 25% të totalit.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore hartojnë plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por nuk ndjekin një proces formal të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi progresin e tyre. Kjo tregon mungesë përgjegjësie për të siguruar zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe për të identifikuar e adresuar pengesat që e vonojnë këtë proces.

23 Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më – rrjedhin si rezultat i fuzionimit të tyre apo ndryshimeve të akteve ligjore

24 Në RVA për vitin 2022 janë raportuar 352 rekomandime të dhëna. Në këtë numër janë përfshirë edhe 20 rekomandime të dhëna në raportet e auditimit për vitin 2021, për komunat: Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, për arsye se në këto kumuna nuk është kryer auditimi për vitin 2022. Kështu që vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna është për 372 rekomandime.

Për të përmirësuar situatën, kërkohet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës, si dhe monitorim i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha organizatat buxhetore.

3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës për katër (4) raporte të auditimit të shqyrtuara në vitet paraprake për: Universitetin e Prishtinës, Telekomi i Kosovës, SHSKUK dhe RTK, ka dhënë 10 rekomandime. Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe ka konstatuar se katër (4) prej tyre janë zbatuar, siç është raportuar në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2023. Për gjashtë (6) rekomandimet e tjera, të cilat ishin të pazbatuara ose në proces, është bërë një vlerësim pasues gjatë auditimeve të vitit 2024, ku ka rezultuar se dy (2) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë ende në proces zbatimi dhe dy (2) të tjera nuk janë zbatuar.

Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për këto rekomandime të Kuvendit të Kosovës.

Përveç këtyre, Kuvendi i Kosovës kishte dhënë rekomandime edhe për raporte të auditimeve të performancës: "Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare", "Funksionimi i Sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga donatorët për vitin 2021", "Performanca financiare dhe operative e NP Trepça sha", "Menaxhimi i projektit Bashkimi i qytetit të Ferizajit", "Sistmi për Menaxhimin e Pagave"; Renovimi dhe rikonfigurimi i stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë"; "Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021" dhe "Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012 – 2021".

Në këtë sezon audites, ZKA nuk ka kryer auditim përcjellës të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës për auditimet e performancës, me qëllim të vlerësimit të nivelit të zbatimit të tyre. Megjithatë, ZKA planifikon që në të ardhmen të kryejë auditime përcjellëse më të gjera, të cilat do të përfshijnë më shumë raporte se sa të një sezoni të vetëm dhe të adresojnë edhe rekomandimet e dhëna nga KMFP dhe Kuvendi i Kosovës.

4. Ndikimi i auditimit

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë ofrojnë një siguri të pavarur dhe të arsyeshme lidhur me saktësinë e pasqyrave financiare si dhe pajtueshmërinë me kornizën ligjore.

Ndikimi i auditimit vlerësohet kryesisht përmes shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët. Kjo shërben si treguesi më i qartë për të vlerësuar nëse menaxhmenti i organizatës ka ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar politikat, proceset dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm në fushat ku janë identifikuar mangësi apo parregullsi. Auditorët përqendrohen në monitorimin e progresit, duke vlerësuar nëse çështjet e ngritura janë trajtuar në mënyrë të duhur dhe duke identifikuar përmirësimet që dëshmojnë angazhimin e menaxhmentit të entitetit të audituar.

Bazuar në rekomandimet e dhëna, këtë vit janë evidentuar përmirësime të rëndësishme në menaxhimin financiar dhe raportimin e pasurive. Bazuar në veprimet e ndërmarra, regjistrat e pasurisë janë më të saktë dhe më të plotë për vlerën rreth 177mil.€ (vlera e pasurive të regjistruar në nivel qendror ishte 125,603,346€, ndërsa në nivel lokal ishte 51,467,815€), si dhe paraqitja e saktë e pasqyrës së pranimeve dhe pagesave për rreth 167mil.€.

Këto rezultate tregojnë se zbatimi i rekomandimeve të auditimit kontribuon në përmirësimin e qeverisjes financiare dhe besueshmërisë së informacionit financiar.

Niveli Qendror

Procesi i auditimit ka ndikuar në rritjen e saktësisë së pasqyrave financiare përmes korrigjimeve materiale në regjistrimin e pasurive, pasqyrën e pranimeve dhe pagesave, si dhe përmirësimin në zbatimin e procedurave të kontrollit të brendshëm në disa organizata buxhetore, si:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka kryer vlerësimin dhe regjistrimin e 123 pronave të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK), duke korrigjuar pasqyrat financiare me vlera materiale;
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) kanë bërë korrigjime financiare për donacionet e kthyera në vlerë 5,308,000€, respektivisht korrigjimin e të hyrave të realizuara nga donatorët në vlerë 824,999€; dhe
- Shërbimi Spitalor Klinik, Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka korrigjuar gabime të mëdha në raportimin e pranimeve dhe pasurive, duke rregulluar pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave për 166,959,000€ dhe vlerën e pasurive në regjistra për 125,603,346€.

Niveli Lokal

Në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë në nivel lokal, ndikim pozitiv të auditimit më të theksuar kishte Komuna e Deçanit sa i përket regjistrit të pasurisë.

Komuna ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejtë përmirësimit të regjistrimit të pasurive, duke regjistruar tokat, objektet dhe parcelat në regjistrat kontabël të pasurive. Si rezultat, vlera e pasurive të regjistruara është rritur për 51,467,815€, nga 13,581,954 sa ishin në 2023 në 65,049,769€ në vitin 2024. Krahas regjistrimit, komuna kishte bërë edhe shpalosjen e saktë të tyre në PFV.

Përveç ndikimit në aspektin financiar, ZKA ka ofruar kontribut të vazhdueshëm edhe gjatë përgatitjes së draft-PFV-ve. Kjo është bërë përmes komunikimeve formale dhe takimeve direkt me përfaqësuesit e komunave, duke pasur parasysh sfidat që ata përballen në përpilimin e pasqyrave financiare.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi dhe udhëzimeve të ofruara nga ZKA, është arritur një rritje e ndjeshme në cilësinë e raportimit financiare, veçanërisht në përgatitjen dhe saktësinë e dy tabelave thelbësore - Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, dhe Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

SHTOJCAT

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2023

Legjenda:



I zbatuar | Pjeserisht i zbatuar | I Pazbatuar | Nuk është i aplikueshëm

	Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2023	Statusi
1	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të siguroj përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar për të përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë, përfshirë pasqyrat e shpalosjeve (anekseve).	I pazbatuar
		Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore	
2	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve.	I pazbatuar
3	Qeveria e Kosovës	Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.	I pazbatuar
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, Ministria në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Ministria duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.	Pjesërisht i zbatuar
		Analiza e buxhetit të shtetit	
5	Qeveria e Kosovës	Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollet në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe të montiroj nëse fondet e alokuara janë të mjaftueshme dhe janë shpenzuar për projektet për të cilat janë aprovuar me buxhet.	I pazbatuar
6	Qeveria e Kosovës	Të vendos mekanizma të kontrollit me qëllim që të parandalojë hyrjen në obligime kontraktuale pa buxhet të mjaftueshëm, duke analizuar mundësinë e ndërlidhjes së sistemit të SIMFK-së me e-prokurimin.	I zbatuar

7	Qeveria e Kosovës	Përmes ministrive përkatëse të ndërmerr veprimet të mëtejshme për punonjësit që nuk kanë vijueshmëri në punë, të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	I pazbatuar
8	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të siguroj kontrolle efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFPP-së dhe SNKSPve.	I pazbatuar
9	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të siguroj se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.	I pazbatuar
		Pasuritë	
10	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MFPT duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të kontrolleve të brendshme dhe të rrisë kompetencën e stafit përgjegjës në regjistrimin e pasurive në mënyrë që regjistrat e pasurive të prezantohen në mënyrë të drejtë. Po ashtu, Qeveria përmes MFPT-së (Thesarit) me rastin e transferimit të pasurive nga një Organizatë te tjetra, të aplikojë procedura të nevojshme që sigurojnë se pasuria është bartur dhe regjistruar tek përfituesi i saj.	Pjesërisht i zbatuar
11	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të sigurojë përdorimin e aplikacionit e-pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.	I pazbatuar
		Llogaritë e Arkëtueshme	
12	Qeveria e Kosovës	Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të sigurojnë një strategji të qëndrueshme dhe efektive të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme përmes rivlerësimit të mekanizmave aktual për inkasimin e tyre. Po ashtu, duhet siguruar raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme si dhe analizuar strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe.	I pazbatuar
		Detyrimet e Papaguara dhe ato Kontigjente	
13	Qeveria e Kosovës	MFPT duhet të vendos kontrolle përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.	I pazbatuar
14	Qeveria e Kosovës	Që përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.	I pazbatuar

		Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore	
15	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive, shpronësimet, vonesat në pagesa dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime shtesë nga proceset eventuale gjyqësore.	I pazbatuar
16	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.	I pazbatuar
		Ndërmarrjet Publike	
17	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Përmes RVA-së rekomandojmë Qeverinë dhe Komisionet përkatëse të Aksionareve që ti forcojnë masat llogaridhënëse ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit që të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike dhe pragmatike me qëllim të eliminimet të gabimeve që kanë ndikuar në opinionet dhe konkluzionet e modifikuar. Po ashtu duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2024 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Të gjitha çështjet dhe rekomandimet që duhet të adresohen në mënyrë specifike janë të prezantuara në raportet individuale.	I pazbatuar
		Sistemi i auditimit të brendshëm	
18	Qeveria e Kosovës	Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore.	I pazbatuar
19	Qeveria e Kosovës	Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së. Po ashtu, të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.	I pazbatuar

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit

	Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna nga Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike	Progresi në zbatimin e rekomandimeve
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të UP-së për vitin 2021	
1	UP	Rektorati i Universitetit të Prishtinës ti angazhojë të gjitha kapacitetet ligjore, nese ka mungesë të angazhojë ekspert të jashtëm ose ta angazhojë Avokatin e Popullit në mënyrë që të bëjë përfaqësim kualitativ ligjor në seancat gjygjësore në lidhje me çështjen e Kishës Ortodokse Serbe e ndërtuar në Kampusin e UP-së.	I pazbatuar
2	UP	Rektori duhet ti intensifikojë punët dhe të kërkojë raportim 6 mujor nga komisioni i formuar, nëse është nevoja të themelohet edhe komision i ri ndërinstitucionalë në menyrë që të definohet pronësia e pronave të UP-së me Komunën e Prishtinës, kufijtë kadastral, kalimi i atyre pronave në pronësi të UP-së, si dhe regjistrimi në gjeoportalin shtetëror.	Pjesërisht i zbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së-së për vitin 2022	
1	RTK	Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim me Bordin e RTK-së, t'i analizojë mundësitë, që në një afat sa më të shpejtë, RTK-ja ta ketë një objekt të përhershëm, që i plotëson kushtet e funksionimit të televizionit publik.	Pjesërisht i zbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Telekomit për vitin 2021	
1	Telekomi i Kosovës	Bordi i Drejtorëve të bëjë plan strategjik 2- vjeçar, për përmirësim të performancës financiare, për zhvillim strategjik të kompanisë, për zbatim të planeve dhe arritje të rezultatit pozitiv financiar.	I zbatuar
2	Telekomi i Kosovës	Qeveria të vazhdojë mbështetjen financiare për Telekomin, në harmoni me planin strategjik dhe nga Bordi të kërkohen raporte financiare 6- mujore, për rezultate konkrete financiare.	I zbatuar

		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për për vitin 2021	
1	SHKSUK	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë kontrolle të shtuara, sa i përket përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave vjetore financiare. Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë që zyrtari kryesor financiar të ketë përgatitjen profesionale, njohuritë dhe trajnimet e nevojshme, për të kuptuar dhe zbatuar drejt kërkesat e raportimit financiar. Pasqyrat vjetore financiare duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të mirëfilltë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Drejtorëve.	I pazbatuar

Shtojca III: Llojet e opinioneve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit

Tabela nr. 42 - Opinionet e auditimit të nivelit qendror për tri vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinioni i auditimit		
		2024	2023	2022
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
2	Zyra e Presidentit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
3	Zyra e Kryeministrit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
4	Ministria e Financave, Punës the Transfereve	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
6	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
7	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
8	Ministria e Shëndetësisë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
9	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
10	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
11	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
12	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
13	Ministria e Ekonomisë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
14	Ministria e Punëve të Brendshme	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
15	Ministria e Drejtësisë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
16	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
17	Ministria e Mbrojtjes	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
18	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
19	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar I Kosovës	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
20	Fondi i Sigurimit Shëndetësor	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
21	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
22	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
24	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
25	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar

26	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
27	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
28	Universiteti i Prishtinës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
29	Gjykata Kushtetuese	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
30	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
31	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
32	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
33	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
34	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
35	Agjencia për Informim dhe Privatësi	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
36	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
37	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
38	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
39	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
40	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
41	Komisioni i Pavarur për Media	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
42	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
43	Institucioni i Avokatit të Popullit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
44	Akademia e Drejtësisë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
45	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
46	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
47	Radio Televizioni i Kosovës	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
48	Fondet në Mirëbesim	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
49	Dogana e Kosovës[25]	-	-	Pamodifikuar
50	Administrata Tatimore e Kosovës	-	-	Pamodifikuar
51	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	-	-	Pamodifikuar
52	Agjencia për Menaxhimin e Kompleksеve Memoriale	-		Pamodifikuar
53	Agjencia Për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar[26]	Kualifikuar	-	-

25 Në vitin 2023 dhe 2024, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë audituar në kuadër të MFPT-së; Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe AMKMK në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

26 Agjencia Për Mbrojtjen e Informacionit Të Klasifikuar është organizatë buxhetore e themeluar në vitin 2014

Tabela nr. 43 – Opinionet e auditimit të nivelit lokal për tri vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinioni i auditimit		
		2024	2023	2022
1	Gllogoc	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
2	Fushë Kosovë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
3	Lipjan	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
4	Obiliq	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
5	Podujevë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
6	Prishtinë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
7	Shtime	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
8	Graçanicë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
9	Dragash	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
10	Prizren	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
11	Rahovec	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
12	Suharekë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
13	Malishevë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
14	Mamushë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
15	Deçan	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
16	Gjakovë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
17	Istog	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
18	Klinë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
19	Pejë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
20	Junik	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
21	Mitrovicë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
22	Skenderaj	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Vushtrri	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
24	Gjilan	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
25	Kaçanik	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
26	Kamenicë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
27	Novo Bërd	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
28	Shtërpcë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
29	Ferizaj	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
30	Viti	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
31	Partesh	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
32	Hani i Elezit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
33	Kllokot	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar

34	Ranillug	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
35	Zubin Potok	Kualifikuar	Kualifikuar	/
36	Zveçan	Kualifikuar	Kualifikuar	/
37	Mitrovica Veriore	Kualifikuar	Kualifikuar	/
38	Leposaviq	Kualifikuar	Kualifikuar	/

Tabela 44 - Opinionet e auditimit të ndërmarrjeve publike për tri vite

Nr	Subjektet e audituara	NP e Nivelit	Opinioni i auditimit		
			2024	2023	2022
1	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
2	Trepça sh.a	Qendror	Kundërt	Kundërt	Mohim
3	KOSTT sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
4	NPH “Ibër - Lepenc” sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
5	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
6	KRU “Prishtina” sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
7	KRU. “Hidrodrini” SH.A.	Qendror	Kundërt	Kundërt	Kualifikuar
8	KRM “ Uniteti” sh.a - Mitrovicë	Lokale	Kundërt	Kundërt	Kundërt
9	Ndërmarrja Publike “Termokos” sh.a	Lokale	Kundërt	I Kundërt	Kundërt

Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

a. Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;
b. Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
c. Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

Konkluzionet e auditimit

- **Konkluzioni i Pamodifikuar -** Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit;
- **Konkluzioni i Kualifikuar -** Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit, përveç ndonjë çështjeje të caktuar e cila përshkruhet te baza për konkluzion të pajtueshmërisë;
- **Konkluzioni i kundërt -** Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara të auditimit; dhe

- **Mohimi i konkluzionit -** Paraqet gjendjen kur auditori për shkak të pamundësisë për marrjen e dëshmive të duhura dhe pa pajtueshmërive të përhapura në shumë fusha, nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion lidhur me pajtueshmërinë.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'Theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shtojca V: Letër Konfirmimi

Pas dorëzimit të draft raportit, Qeverisë përkatësisht Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrisë së Ekonomisë iu ka dhënë e drejta ligjore për dorëzimin e komenteve apo të Letërkonfirmimit që pajtohet me përmbajtjen e draft raportit.

Ndonëse ZKA ka dhënë mundësinë shtesë të afatit, deri në kohën e finalizimit/publikimit të raportit, nuk kemi pranuar komente apo Letërkofirmim.

Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënim	2024 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2023 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2022 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
PRANIMET				
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	203,380	184,864	159,942
Tatimi në të ardhura personale	3	280,782	255,941	215,560
Tatimi në pronë	4	32,977	46,085	34,554
Tatime tjera direkte	5	29	3,403	3,773
		517,168	490,294	413,829
Tatimet Indiekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	1,504,924	1,365,580	1,220,007
Detyrimi doganor	7	172,069	156,214	132,663
Akciza	8	618,287	554,989	517,264
Tatime tjera indirekte	9	1,834	101	313
		2,297,114	2,076,882	1,870,248
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-74,131	-61,277	-67,069
		-74,131	-61,277	-67,069
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa,ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	197,787	148,074	149,311
Taksa,ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	66,239	62,511	55,596
Taksa koncesionare	13	33,037	25,980	18,404
Renta minerare	14	27,455	26,722	29,857
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	3,045	3,594	3,365
Të hyrat nga dividenta dhe ndarja e fitimit	16	10,376	-	-
		337,939	266,881	256,532
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	17	124,723	96,745	98,198
Pranimet për shërbimin e nënhuazimeve	18	6,577	8,216	8,149
Huamarrja e brendëshme shtetërore	19	-7,993	-141,805	5,854
		123,306	-36,845	112,201
Grantet dhe ndihmat				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	20	9,928	13,823	9,738
Grantet e BE-së për energjinë	21	-	67,500	-
Grantet për mbështetje buxhetore	22	1	-	10,250
		9,929	81,323	19,988
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	23	4,793	4,547	5,548
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	24	11,486	37,877	11,387
Të hyrat e dedikuara	25	6,485	5,958	5,888
Gjithsej Pranimet		**3,234,089**	**2,865,640**	**2,628,552**
PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe shtesa	26	843,599	767,305	653,436
Mallëra dhe shërbime	27	432,514	397,978	337,414
Shërbime komunale	28	29,250	28,779	25,952
		1,305,363	1,194,062	1,016,802
Transferet				
Subvencione dhe transfere	29	1,114,605	1,079,450	1,065,195
Shpenzimet kapitale				
Prona,impiantet, pajisjet,transferet	30	654,626	560,868	422,579
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit	31	99,747	89,163	83,322
Kredidhënia për ndërmarrjet publike	32	15,000	1,947	35,724
Kthimet e fondeve dhe depozitave	33	6,238	508	1,386
Gjithsej Pagesat[1]		**3,195,579**	**2,925,998**	**2,625,008**
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		38,509	-60,358	3,544
Para të gatshme në fillim të vitit	**34**	385,375	445,734	442,189
Para të gatshme në fund të vitit	**34**	**423,884**	**385,375**	**445,734**

[1] Përfshihen shpenzimet nga vendimet gjyqësore dhe përmbarimore në shumë prej 125.42 milionë euro, detajet sipas kategoreve në shënimet 26 deri 30

7

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënim	2024 Realizimi A '000 €	2024 Buxheti përfundimtar B '000 €	2024 Buxheti fillestar C '000 €	2024 Ndryshimet buxhetore D=B-A '000 €	2023 Realizimi A '000 €	2022 Realizimi A '000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME							
Tatimet direkte		517,168	534,544	534,544	17,376	490,294	413,829
Tatimet indirekte		2,297,114	2,249,847	2,249,847	-47,267	2,076,882	1,870,248
Kthimet tatimore		-74,131	-79,273	-79,273	-5,142	-61,277	-67,069
Të hyrat jo-tatimore		337,939	292,880	292,880	-45,059	266,881	256,532
Grantet dhe ndihmat[2]		9,929	30,000	30,000	20,071	81,323	19,988
Huamarrja		123,306	391,452	391,452	268,145	-36,845	112,201
Pranimet tjera [3]		22,764	17,023	17,023	-5,740	48,382	22,823
Gjithsej Pranimet		**3,234,089**	**3,436,472**	**3,436,472**	**202,384**	**2,865,640**	**2,628,552**
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe shtesa		843,034	844,744	805,390	1,709	766,557	652,641
Mallra dhe shërbime		429,198	491,132	484,773	61,934	394,950	333,374
Shpenzime komunale		29,249	33,047	34,186	3,797	28,778	25,950
Subvencione dhe transfere		1,112,492	1,162,405	1,062,316	49,912	1,078,206	1,064,068
Shpenzime kapitale		647,014	840,896	859,176	193,882	554,433	419,253
Rezerva		-	2,651	10,173	2,651	-	-
Interesi		42,215	46,309	46,309	4,094	42,215	35,039
Të tjera[4]		92,376	199,110	189,840	106,733	60,859	94,684
Gjithsej Pagesat	35	**3,195,579**	**3,620,293**	**3,492,163**	**424,713**	**2,925,998**	**2,625,008**
Rritja/Zbritja e parasë së gatshme		**38,509**	**(183,821)**	**(55,691)**	**(222,330)**	**(60,358)**	**3,544**

[2] Te planifikimi buxhetor përfshihen grantet e përcaktuara të donatorëve (12 milionë euro) si dhe grantet për mbështetje buxhetore (18 milionë euro, përkatësisht 7.5 milionë euro, si grante nga BE për energjinë), si fonde të planifikuara për pranim në vitin 2024

[3] Përfshihen, të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, financimi i njëhershëm nga AKP dhe pranimet nga depozitat.

[4] Përfshihen buxheti dhe pagesat si: pagesat e kryegjësë, non-huazimeve, granteve te përcaktuara të donatorëve, diskonti i letrave me vlerë, pagesat për kapitalizim dhe blerje të aksioneve, pagesat për antarësim në IFN, dhe kthimet nga fondet e depozitave (neto).

Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënim	2024 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2023 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2022 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
Pasuritë financiare - paraja e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	36	395,911	345,232	419,664
Kuotat në IFN	37	9,832	8,395	8,210
Fondi në mirëbesim për zhvillim	38	3,837	3,566	3,256
Paratë e gatshme në transit	39	7,223	22,894	10,845
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	40	4,849	3,899	2,527
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	41	2,231	1,389	1,233
Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme		**423,884**	**385,375**	**445,734**
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	42	7,675	17,472	15,505
Të hyrat vetanake - niveli qendror	43	2,000	3,027	2,584
Të hyrat vetanake - niveli lokal	44	57,515	81,387	90,005
Fondi në mirëbesim për zhvillim	45	3,782	3,510	7,974
Të hyrat e dedikuara	46	4,253	3,431	2,285
Kontigjenca e BE-së për Energji	47	-	22,740	-
Të tjera	48	33,832	29,060	24,807
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	49	6,953	6,226	16,177
		116,010	166,854	159,337
Të pashpërndara		**307,874**	**218,522**	**286,396**
Gjithsej Bilanci i Fondeve	34	**423,884**	**385,375**	**445,734**

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës